

## **TKURRJA E HAPËSIRËS PUBLIKE**

Qeverisja dhe Liria e Shprehjes në Kosovë

Prishtinë  
24 maj 2010

PËRMBLEDHJE	3
HYRJE	6
FALENDERIME	8
GJENDJA E HAPËSIRËS PUBLIKE	9
Uzarpimi i sferës publike	9
Partitë politike	14
Kufizimi i raportimit	17
Nënshtrimi i shërbimit publik	23
Zgjedhje të cenuara	28
Varësia nga të huajt	31
EKONOMIA POLITIKE DHE STANDARDI I JETESËS	39
Pengje të sektorit publik	41
Problemet me prokurimin publik	43
Molepsja e ambientit të biznesit	47
Pasojat	53
PËRFUNDIMI	55
Lista e Akronimeve	58

## PËRMBLEDHJE

Shoqëria kosovare është e trembur, ndonëse aktualisht mund të thuhet se ajo është më shumë e dorëzuar sesa e frikësuar. Sfera publike është kthyer në një hapësirë të ndaluar, në vend që të shërbejë si arenë për një qytetari aktive dhe të shpenguar që ndihmon në arritjen e së mirës të përbashkët duke e drejtuar dhe duke marrë pjesë në vendimmarrjen e qeverisë. Mungon një kulturë e gjallërishme asociimi. Ndjenja e qytetarisë, e gëzimit dhe e ushtrimit të të drejtave dhe ndjenja e pronësisë mbi sferën publike është pak e zhvilluar. Prania e mbikëqyrjes ndërkombëtare e zëvendëson vetëm pjesërisht aftësinë minimale të shoqërisë kosovare për t'i kërkuar llogari institucioneve të saj.

Sponsorët dhe mbikëqyrësit e Kosovës shpesh i kanë dhënë përparësi një stabiliteti afatshkurtër të tipit “mungesa e lajmeve është lajm i mirë” në vend që të marrin hapa drejt zhvillimeve të shëndetshme, por që do të hasnin në përplasje. Stabiliteti i Kosovës përbën një “gjendje të ngrirë”, pra jo një pasqyrim të realitetit në terren, por një investim stërmadh të vullnetit politik për të ruajtur stabilitetin. Edhe vetë prezenca ndërkombëtare zhvillon një debat të kufizuar, duke ushtruar një formë shtypjeje qytetëruese dhe duke nxitur krijimin e asaj që filozofi Žižek e ka quajtur kombi i “dekafeinuar”.

Arkitektura zyrtare e institucioneve që supozohet të ketë një shtet modern evropian është pothuajse e kompletuar, e megjithatë elementët e saj përbërëse po deformohen si rezultat i faktorëve të brendshëm. Dominimi i partisë kryesore në qeveri, gjatë dy vjetëve të para të ekzistencës së Kosovës, u përdor për të dobësuar institucionet, bordet dhe mediat që supozohen të luajnë rol për të mbajtur qeverinë të përgjegjshme dhe për të monitoruar respektimin e procedurave dhe ligjeve prej pushtetit ekzekutiv. Kuvendi nuk i kërkon llogari qeverisë. Kushtetuta e Kosovës përpiqet ta ruajë sektorin dhe sferën publike nga uzurpimi prej interesave politike përmes vendosjes së institucioneve kosovare nën një formë karantine

me anë të bordeve të pavarura, të përbëra nga pjesëtarë të paanshëm dhe profesionistë. Megjithatë, qeveria është bërë shumë e aftë në nënshtrimin e tyre, duke ruajtur njëkohësisht, në aspektin formal, fasadën e tyre të pavarësisë.

Oreksi i qeverisë për një kontroll më të rreptë dhe për mikromenaxhimin e axhendës së lajmeve është shtuar. Ajo ka pasur përplasje me gazetarë të pavarur. Qeveria ka arritur të marrë një kontroll më të madh mbi transmetuesin publik RTK dhe reklamën qeveritare devijohen prej shtypit kritik drejt gazetave me numër të vogël lexuesish, por që drejtohen nga ithtarë të qeverisë. Qeveria përpiqet t'i çarmatosë kritikët e saj, për shembull, duke blerë gazetarët investigativë. Redaktorëve u bëhen telefonata dhe u dërgohen mesazhe të drejtpërdrejta. Përdoren edhe kërcënimet. Ka pasur pretendime nga ana e krerëve qeveritarë se gazetarët janë vënë nën mbikëqyrje.

Marrëdhëniet mes qeverisë dhe medias e OJQ-ve liberale janë përkeqësuar. Një tabloid i mbështetur nga qeveria ka ndërmarrë fushatë abuzimesh dhe kërcënimesh të shfrenuara. Idetë e kësaj gazete kanë ndikuar tek qasja zyrtare e qeverisë kundrejt kritikëve të saj. Në mars 2010 ajo filloi t'i akuzonte OJQ-të dhe gazetarët kritikë ndaj saj se ishin “kundër-shtetëror”. Qeveria propozoi një shtrëngim të mëtejshëm të ligjeve mbi OJQ-të.

Shërbimi publik në një shtet të sapo krijuar duhet të jetë një hapësirë që lejon idealizmin. Ai duhet të jetë pika e takimit në të cilën njerëzit mund të ushtrojnë profesionalizmin e tyre për të mirën e përbashkët. Por, rrjetet klient-patron si dhe praktikën arbitrare të punësimit dhe pushimit nga puna po e dëmtojnë idealizmin e etosit të sektorit publik. Profesionalizmi në shërbimin publik nuk po arrin të konsolidohet. Servilizmi, konformizmi dhe heshtja janë cilësitë që po fitojnë terren. Madje zyrtarët e aftë edhe janë sulmuar prej qarqeve politike. Ekspertiza, identiteti dhe krenaria profesionale janë në nivele shumë të ulëta. Forcimi i profesionalizmit do të jetë i një rëndësie kyçe për suksesin e shtetit.

Arena politike kosovare duhet të lejojë hapësirë për një përballje të lirë idesh dhe për përfaqësimin e kontingjentit të madh të rinjve. Por, partitë e konsoliduara veprojnë më shumë si “biznese private”, duke penguar hyrjen e njerëzve të rinj në skenën politike. 90% e spektrit politik të shqiptarëve të Kosovës e përcakton veten si “qendër e djathtë”, ndonëse në realitet ideologjia politike ka ende një rol të dobët, për të mos thënë “që nuk luan asnjë lloj roli”.

Aktualisht, funksioni i partive politike kosovare është të kanalizojnë pushtetin dhe patronazhin mbi burimet e shtetit drejt udhëheqjeve politike, të cilat janë vështirë për t'i thirrur në përgjegjësi apo për t'i hequr. Ato i mbizotërojnë institucionet publike dhe shtetërore. Këto institucione duhen çliruar dhe duhen rimarrë për të mirën e publikut. Suksesi politik në Kosovë varet shumë nga kontrolli mbi paratë, rrjetet e mbështetësve militantë dhe nga influenca mbi administratën.

Zgjedhjet e fundit lokale nuk i shpëtuan plotësisht presioneve që kanë nënshtruar një pjesë kaq të madhe të arenës publike. Votuesit, personeli i qendrave të votimit dhe vëzhguesit u intimiduan nga grupe militantësh të partive politike. Në raundin e votimeve në dhjetor, partitë filluan të akuzonin njëra tjetrën aty për aty se po përdornin militantë. Njëra prej tyre e pranoi se kishte përdorur huliganë për të “mbrojtur” votat e saj. Në nivelin e vendvotimeve, qendrave të votimit dhe të numërimit komunal, shpesh presioni normativ mbi personelin ishte i pamjaftueshëm për t'i ndihmuar që ta kryenin profesionalisht detyrën e tyre. Drejtorët e shkollave, të emëruar politikisht, të cilët menaxhonin qendrat e votimit, përbënin hallkën e dobët të procesit. KQZ demonstroi se nuk ishte e aftë të përcaktonte rezultatet në asnjë komunë ku rezultati ishte i përafërt.

Vendet ish komuniste që kanë pasur suksesin më të madh në tranzicionin nga ekonomitë e komanduara e të centralizuara kanë tërhequr shumë investime të huaja dhe kanë lejuar që të shfaqen një shumëllojshmëri kompanish; nga ana tjetër, presioni për reforma legale dhe administrative është mbajtur gjallë nga ky elektorat i shumëllojshëm dhe në rritje. Një shoqëri e fortë civile zakonisht i ka rrënjët në një

shoqëri komerciale, që është e interesuar në arritjen e ndryshimit, dhe në mbajtjen e një tensioni të lehtë, por të shëndetshëm me botën e politikës. Por, në Kosovë kjo nuk është duke ndodhur.

Në fakt, ekonomia kosovare dominohet nga një numër i vogël kompanish publike dhe private të gërshtuara me elitën politike, ndërkohë që pronësia mbi asetet kyçe duket sikur nuk po diversifikohet, por po përqendrohet edhe më tej. Politikanët po pozicionohen për të vjelë përfitimet dhe për të çimentuar ndikimin e tyre, çka shënon ekspansionin gradual të pushtetit politik në fushën e ekonomisë. Në vend që të sigurojnë një hapje më të madhe ndaj botës së jashtme për qytetarët e tyre, klasa politike kosovare duket sikur i është përshtatur tejet mirë gjendjes së gjysmë-izolimit të shtetit të ri dhe jetesës nga përvetësimi i një pjese të pasurisë së pakët të atyre qytetarëve të mbajtur rob.

Ndërkohë, papunësia vlerësohet në 40 – 48% dhe papunësia tek të rinjtë kap 74%, por është duke u rritur më tej. Nevojitet një rritje ekonomike e qëndrueshme prej së paku 7% në vit për 10-15 vjetët e ardhshme vetëm për ta përgjysmuar papunësinë deri në rreth 20-25%. Deri më tani, rritja ekonomike e projektuar aktualisht, prej 4%, vjen si pasojë e një rritjeje të papërballueshme të shpenzimeve kapitale nga ana e qeverisë dhe jo nga dinamizmi i sektorit privat.

Megjithatë, duket sikur qeveria nuk e konsideron politikbërjen efikase ekonomike si një çështje mbijetese politike. Përkundrazi, pushteti i shtetit përdoret për të grabitur burimet e pasurisë. Përkushtimi i elitës politike ndaj promovimit të konkurrencës së plotë të tregut është gjysmak. Elita nuk do që të humbasë kontrollin e saj mbi levat e patronazhit, që ka në dispozicion në një ekonomi më të manipuluar dhe duket se ka besim që metodat aktuale mund ta rikthejnë atë në pushtet në zgjedhjet e ardhshme.

Në vitin 2009, shumë bizneseve dhe Odës Ekonomike të Kosovës iu desh të investojnë për të luftuar nismat grabitqare nga ana e qeverisë, në vend që t'i kanalizojnë kohën dhe përpjekjet e veta drejt zhvillimit. Këto nisma synonin të krijonin

monopole duke u fshehur pas fasadës së kontrollit të cilësisë. Duket sikur qeveria e ka tejkaluar propozimin për krijimin e një monopoli të importit të mishit, të cilin më pas e tërhoqi, me anë të kontrolleve joformale dhe taksimit të jashtëligjshëm mbi disa produkte mishi – duke i konvertuar kështu ato që fillimisht ishin importe zyrtare në importe të parregulluara me ligj. Tani qeveria e ka pranuar se ekziston nevoja për një reformë tërësore të qasjes së saj ndaj licencimit: “Na duhet të krijojmë mundësi dhe jo pengesa për bizneset.”

Bujaria e sektorit publik përdoret për të rekrutuar dhe për të shpërblyer mbështetësit. Drejtimi i kompanive publike, që gjithnjë ka qenë problematik, është bërë ndjeshëm më arbitrar gjatë dy vjetëve të fundit. “Kompanitë politike” të favorizuara nga qeveria janë në ngritje në disa sektorë – disa prej tyre më parë kanë qenë firma të vogla apo të sapoformuara, të ardhurat e të cilave janë stërritur brenda natës duke arritur me dhjetëra miliona euro, si pasojë e kontratave nga sektori publik. Por, kjo e stagnon rritjen e bizneseve profesionale dhe konkurruese, duke reduktuar aftësinë e tyre për të ndërtuar një punësim të qëndrueshëm.

Në një kohë kur shpenzimet kapitale qeveritare janë trefishuar gjatë dy viteve të fundit, menaxhimi i prokurimeve publike është bërë më arbitrar. Shumë profesionistë të prokurimeve janë zëvendësuar, sidomos në vitin 2009, me njerëz më pak të kualifikuar apo fare të pakualifikuar, të cilët janë më të varur nga patronët e tyre politikë. Burimet e brendshme pohojnë se në prokurimet publike çdo gjë manipulohet, që nga përzgjedhja e fituesit, ndryshimi i kriterëve të kontratës e deri tek shtimi i anekseve të kontratës. Shumë shpesh kompania që shpallet fituese e tenderit është një ndër ato që bëjnë ofertën më të shtrenjtë. Firmat e zakonshme kanë frikë të konkurrojnë me firmat e “përzgjedhura” duke u tërhequr nga tendera premtues për të shmangur problemet.

Prezenca e mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe ambasadat perëndimore zëvendësojnë deri diku fuqinë korrigjuese të opinionit publik dhe të shoqërisë civile mbi qeverinë. Sidoqoftë, ndërmjetësimi i diplomatëve e ka mbajtur

shoqërinë civile të dobët dhe në varësi, ndërkohë që ndërhyrjet e tyre janë më selektive se ç’do të mund të kishin qenë ndërhyrjet e aktorëve vendas dhe përputhen me prioritetet e interesat e tyre, që nuk janë gjithnjë të njëjta me ato të Kosovës.

EULEX ka mbajtur për vete monopolin e organizimit të hetimeve mbi korrupsionin në nivele të larta, krimin e organizuar dhe krimet e luftës. Në një kohë kur Raporti i Progresit të BE-së i tetorit 2009 thekson alarmin e Brukselit për korrupsionin qeveritar dhe krimin e organizuar, veprimi ose mosveprimi i EULEX-it është bërë një përcaktues i drejtimit që do të marrë Kosova. Disa e shohin ndërhyrjen “kirurgjikale” mbi trupin e politikës kosovare, në formën e ngritjes së padive për korrupsion kundër zyrtarëve të lartë, si një mundësi që krijon hapësirë për rritjen e lëvizjeve të reja politike, sepse forma aktuale e stabilitetit të Kosovës është e një tipi të brishtë, frymëndalës dhe kufizues.

## HYRJJE

Kosova, shteti më i ri në botë, ndodhet e kapur mes projekteve ultra-demokratike të qeverisjes, të dekretuara nga organizmat ndërkombëtare, dhe trashëgimisë së saj të mbushur me konflikte dhe të karakterizuar nga mungesa e zhvillimit. Situata ndërlikohet edhe më tej nga natyra e kontestuar e pavarësisë si dhe nga ndërhyrjet e mbikëqyrësve të saj: në procesin e shtetformimit Kosova po i përmbahet një formule të konceptuar nga OKB-ja, por që gjithsesi nuk gëzon mbështetjen e kësaj organizate, çka e lë atë të varur nga një koalicion shtetesh perëndimore, të cilët e kishin llogaritur sponsorizimin e pavarësisë së Kosovës si një mënyrë për të parandaluar konfliktet në kufijtë e Bashkimit Europian (BE) dhe të NATO-s, në një kohë që BE dhe NATO edhe pse nuk i besojnë krejtësisht vendit që kanë marrë nën kujdestari, përballen me rrezikun moral të mbrojtjes së tij në arenën ndërkombëtare.

Çfarë lloj ADN-je shtetërore po formohet nga ky kombinim i çuditshëm, ku në njërin anë policia e Bashkimit Europian kontrollon hetimet mbi krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe ambasadori i SHBA është një lloj mëkëmbësi mbretëror i pashpallur, kurse në anën tjetër një gazetë e mbështetur nga qeveria mund të lëshojë kërcënime me vdekje ndaj një gazetari gati pa i hyrë gjemb në këmbë? A është Kosova një demokraci në konsolidim e sipër, apo mos vallë Kosova është veç shuma e orekseve të klasës së saj politike, të dinamikave sociale dhe ekonomike, dhe të llogarive pragmatike e të ditëpasditshme të mbikëqyrësve të saj ndërkombëtarë që e shtyjnë atë në një drejtim tjetër?

Ky raport synon të shqyrtojë qeverisjen në Kosovë duke e parë atë në prizmin e lirisë së shprehjes. A po zgjerohen proceset institucionale, sociale dhe ekonomike apo mos vallë mundësitë e tyre po vijnë duke u tkurrur? A janë qytetarët në përgjithësi, dhe jo vetëm ata që ushtrojnë profesionin e gazetarit, të lirë të shprehin atë që u dikton ndërgjegjja dhe gjykimi i tyre – qofshin këta në sektorin privat apo shtetëror, qofshin burokratë apo sipërmarrëse? Sepse janë pikërisht profesionistët kosovarë ata që do të përcaktojnë mundësitë e shtetit të Kosovës për të mbijetuar.

Duke qenë se lufta dhe spastrimi etnik e shndërruan Kosovën në një vend nën kujdestarinë e ndërkombëtarëve që prej 1999, shpesh ky territor ende vazhdon të shihet si një gjëegjëzë ndarjesh ndëretnike; në fakt plani shtet-ndërtues i Ahtisaarit dominohet nga aranzhime kushtetuese të projektuara për të mbrojtur serbët dhe minoritetet e tjera. Megjithatë, në këtë raport ne kemi zgjedhur të përqendrohemi në përvojën e shumicës të 90 për qindësh të Kosovës që janë shqiptarë etnikë. Kjo nuk bëhet për të sugjeruar se problemet ndëretnike apo territoriale kanë përfunduar, por sepse vëmendja që i është kushtuar ndarjes së njëmendtë mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë shumë shpesh ka pasur si efekt të saj anësor neglizhimin e shqyrtimit të proceseve sociale, ekonomike dhe politike që përjetohe brenda kufijve etnikë apo gjuhësorë. Në fakt, janë pikërisht këto procese që zënë vendin kryesor në jetët e njerëzve; ndërsa konfliktet dhe bashkëpunimi ndëretnik mund të thuhet se janë efekte anësore të kësaj.

Duke qenë se Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (NRDNJ) është një rrjet rajonal OJQ-sh nga Kosova, Serbia, Kroacia, Bosnja-Herzegovina dhe Mali i Zi, dhe duke qenë se është në natyrën e raportimit mbi të drejtat e njeriut që të fokusohet tek problemet, ne mendojmë se mund ta ndihmojmë lexuesin të orientohet nëse deklarojmë që prej fillimit se NRDNJ e mirëpret, e njeh dhe e mbështet pavarësinë e Kosovës: një themel ky i nevojshëm mbi të cilin mund të ndërtohet demokracia dhe liritë e popullit të saj. Këtë nuk mund ta bënte administrata e OKB-së dhe as Serbia nuk ka treguar ndonjë dëshirë të sinqertë për ta bërë; edhe nëse Serbia do ta kishte bërë këtë, historia e tmerrshme e sundimit të Kosovës nga ana e saj në vitet 1990 e ka mbyllur këtë mundësi. Aktualisht e vetmja rrugë që ka Kosova për të konsoliduar të drejtën e shprehjes së lirë kalon përmes përmirësimit të institucioneve dhe ekonomisë së shtetit që u lind në shkurt të 2008, dhe njohjes e pranimit të tij sa më të gjerë.

Një pjesë e këtyre njohjeve varen ende nga vendimi i natyrës këshilluese që pritet këtë vit nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë mbi legjitimitetin e deklaramit të pavarësisë nga ana e Kosovës. Pritshmëria e këtij vendimi e ka ngrirë

shqyrtimin e cilësisë së qeverisjes në Kosovë. Po bëhet presion për të shtyrë për më vonë zbulimet që s'janë të mirëpritura dhe këto presione po ndihen nga qeveria e Kosovës, sponsorët e saj dhe shoqëria civile. NRDNJ dëshiron ta bëjë të qartë se ajo e kundërshton këtë logjikë të 'heshtjes'. Mbajtja e problemeve të mbyllura brendapërbrenda Kosovës duke lejuar që proceset që mund të jenë të dëmshme të vazhdojnë të shtohen pa hasur në kundërshtim, është çmim shumë i lartë për të paguar.

## FALENDERIME

Raporti u mundësua nga donacioni i Civil Rights Defenders, ish Komiteti i Helsinkit suedez të cilit Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (NRDNJ) i shpreh mirënjohjen e saj.

Hulumtimi për këtë raport u bë nga Alex Anderson, Besa Luci dhe Hillen Francke. Raporti u shkrua nga Alex Anderson dhe u redaktua nga Marcus Tanner. Dizajni është bërë nga Dren Maliqi, ndërsa përkthimi në gjuhën shqipe nga Maklen Misha. Projekti u mbikëqyr nga Sarah Maliqi e NRDNJ dhe Marie Manson e Peter Mossop i Civil Rights Defenders.

Një ndihmë e mëtejshme ka ardhur nga BIRN Kosova, ndihmë kjo që përfshinte qasjen tek hulumtimet e saj për programin televiziv *Jeta në Kosovë*. Mia Marzouk dha një ndihmë të mëtejshme në lidhje me zgjedhjet në Kosovë, ndërkohë që Lawrence Marzouk hulumtoi faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimeve Publike për ne. Ne ju shprehim mirënjohjen tonë të gjithë atyre që na kanë dhënë intervista për realizimin e këtij raporti.

Alex Anderson është shkrimtar i pavarur. Që nga vjeshta 2003 e deri në vjeshtën 2008 ai ka qenë drejtor i Grupit Ndërkombëtar të Krizave për Kosovën dhe trembëdhjetë raportet e organizatës që u shkruan gjatë kësaj kohe ndihmuan në krijimin e konsensusit dhe të një kornize për pavarësinë e kushtëzuar të territorit të Kosovës. Përpara kësaj detyre ai ka qenë hulumtues për Human Rights Watch i vendosur në Tbilisi dhe përgjegjës për Kaukazin jugor, si dhe hulumtues për Amnesty International për Europën qendrore e lindore dhe Rusinë.

Besa Luci është hulumtuese e lartë me Nismën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut. Që nga vera e 2009 ajo ka punuar po ashtu si hulumtuese në fushën e politikave në institutin kërkimor Klubi për Politikë të Jashtme të vendosur në Prishtinë. Ajo është edhe redaktore e botimit shqip të revistës "Foreign Policy" të vendosur në Uashington. Më parë, ajo ka marrë një master në gazetari nga Graduate

School of Journalism, Universiteti i Misurit, SHBA.

Aktualisht Hillen Francke po përfundon masterin në Marrëdhënie Ndërkombëtare në School of International and Public Affairs (SIPA) të Universitetit të Kolumbias. Ajo ka diplomuar në London School of Economics dhe ka punuar në Kosovë me NRDNJ dhe me Misionin e OSBE në Kosovë.

Marcus Tanner është një redaktor i botimit online të Balkan Insight, shkrimtar dhe kolumnist i pavarur për The Independent dhe autor i disa librave mbi historinë e Europës.



## **GJENDJA E HAPËSIRËS PUBLIKE**

Shoqëria kosovare është e intimiduar, ndonëse aktualisht mund të thuhet se ajo është më shumë e dorëzuar sesa e frikësuar. Sfera publike në vend që të shërbejë si arenë për një qytetari aktive dhe të lirë që ndihmon në arritjen e së mirës të përbashkët duke udhëhequr dhe duke marrë pjesë në vendimmarrjen e qeverisë, është kthyer në një hapësirë të ndaluar, në një pronë të të pushtetshmeve, ku individët që nuk gëzojnë një mbështetje të fortë duhet të tregohen të kujdesshëm.

### **Uzurpimi i sferës publike**

Dëbimi i forcave ushtarake dhe i administratës serbe në 1999 e zhduku rrezikun dhe frikën ekzistencialiste tek shumica 80 përqindëshe shqiptare, çka qe një parakusht për shfaqjen e atij territori publik që ndërmjetëson mes individëve dhe qeverisë. Por, pas kthimit masiv të shumicës së zhvendosur duke filluar që prej verës së 1999, një pjesë e madhe e këtij territori u zu shpejt nga:

- a) Një “qeveri e përkohshme” e formuar – pa pjesëmarrjen e forcës më të madhe politike në Kosovë, që ishte Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK – nga udhëheqja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK, e cila i vuri anëtarët e saj në kontroll të ndërmarrjeve publike. Periudha e qeverisjes së saj, që pas bisedimeve me OKB në fillim të vitit 2000 u kthye në një strukturë administrative të përbashkët, e cila u kundërshtua në mënyrë masive nga një votë popullore për LDK në tetor të po atij viti, u karakterizua nga intimidimi dhe frika, veprimtaritë e paligjshme, vrasjet e shqiptarëve, serbëve dhe romëve, si dhe uzurpimet masive dhe arbitrare të pronave. Vrasjet misterioze të figurave publike vazhduan përtej kësaj periudhe deri në mesin e viteve 2000, siç vazhdoi operacionin e saj edhe struktura e

sigurisë së UÇK-së, SHIK-u dhe ashtu siç vazhdoi dhe ndikimi i këtyre qarqeve mbi ndërmarrjet publike, bizneset dhe pronat.<sup>1</sup>

- b) Administrimi ndërkombëtar: Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK e rimori pushtetin nga qeveria e përkohshme në vitin 2000 dhe më pas filloi ta transferonte atë gradualisht tek një administratë e përkohshme, e zgjedhur me votë, por nën varësinë e UNMIK-ut, ndërsa vetë UNMIK-u i përgjigjej Nju Jorkut dhe jo elektoratit kosovar. Por, injektimi i vlerave demokratike u minua nga vetë ky mision: nga paaftësia për të nxitur zhvillimin ekonomik të Kosovës, nga qeverisja jo demokratike dhe paaftësia për t’i hapur rrugë vetëqeverisjes në mungesë të një ndryshimi të politikës nga ana e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kjo e bëri OKB-në të pandjeshme ndaj proceseve të përditshme të angazhimit të qytetarëve si dhe ndaj opinionit publik. Ky mision u mjaftua duke reaguuar ndaj shpërthimeve të dhunës apo kërcënimeve për shpërthime të dhunës të cilat shpesh orkestroheshin apo lejoheshin të ndodhnin nga udhëheqësit kosovarë: proceset penale kundër këtyre të fundit shpesh ndaleshin nga frika e trazirave dhe mund të thuhet se trazirat e marsit 2004 ishin stimulimi thelbësor që çuan tek dhënia e pavarësisë së mbikëqyrrur në fillim të 2008.<sup>2</sup>

Të dyja këto marrje të pushtetit në periudhën e pasluftës kanë lënë trashëgiminë e tyre, duke dobësuar sferën publike të shtetit të ri me pavarësi të kushtëzuar, i cili në çdo rast ruan një gjurmë të fortë të hamendësimeve në lidhje me marrëdhëniet mes qytetarit dhe qeverisë që ka trashëguar nga epoka e komunizmit. Izolimi i Kosovës në vitet 1990 dhe LDK, lëvizja dhe partia që u krijua më vonë e që zuri pjesën më të madhe të peizazhit politik të shqiptarëve që nga 1990 e deri në 2007,

<sup>1</sup> Shih Nicholas Wood, “Kosovo Gripped by Racketeers”, BBC, 5 April 2000. <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/699175.stm> dhe raportin për Ballkanin të Grupit Ndërkombëtar i Krizave Nr. 88 “Çka ndodhi me UÇK?” [“What Happened to the KLA?”], 3 mars 2000.

<sup>2</sup> Shih Raportin për Evropën Nr. 144 të Grupit Ndërkombëtar i Krizave “Kolapsi në Kosovë” [“Collapse in Kosovo”], 22 prill 2004.

kontribuan drejt krijimit të kësaj situate. Shprehitë e respektimit të udhëheqësve dhe të përparësisë që i ipet autoritetit e jo argumenteve (një shoqëri që: “beson por nuk mendon”<sup>3</sup>) zhduken me ngadalë.<sup>4</sup>

Po ashtu, të dyja këto marrje të pushtetit, kanë vazhduar të jetojnë në një formë më të zbehtë në strukturën e shtetit të ri: ndonëse OKB-ja është lënë mënjanë, ambasadat e SHBA-së dhe të pjesës tjetër të Kuintit.<sup>5</sup> Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, ICR, themeluar sipas Planit të Ahtisaari-t,<sup>6</sup> dhe BE (kryesisht përmes misionit të saj të sundimit të ligjit, EULEX me një personel prej 2000 vetësh, i cili zyrtarisht ka fuqinë të ndërhyjë dhe të zëvendësojë, dhe po ashtu përmes Zyrës së Ndërlidhjes së Komisionit Europian dhe Përfaqësuesit Special të BE-së, i cili shërben po ashtu si ICR) ushtrojnë pushtet në mënyrë formale dhe joformale.

Qeveria, që deri në fund të 2007 kontrollohej nga ish komandanti i UÇK-së Ramush Haradinaj, që prej janarit 2008 është udhëhequr nga rivali i tij dhe ish kreu i “qeverisë së përkohshme” Hashim Thaçi, administrata e të cilit mund të shihet si një rikthim i kufizuar i qeverisë së parë të përkohshme të 1999, por që të paktën këtë herë është e pajisur me një mandat popullor.

Në Kosovë qeveria e rrethon vetveten me shenja “ndalohet hyrja”: automjete të mëdha e të fuqishme të zeza me xhama të errët dhe grupe truprojash private të armatosura. Debatet në kuvend janë shpesh të ashpra. Retorika e politikanëve kryesorë kosovarë shkon nga një gjuhë e drunjtë, abstrakte, hipokrite dhe me

pretendime, e deri tek përdorimi i shpeshtë i shprehjeve kërcënuese dhe të dhunshme.<sup>7</sup>

Partitë opozitare në Kosovë nuk arrijnë të sfidojnë në mënyrë të mjaftueshme qeverinë, të krijojnë debat dhe të shtrojnë çështje për diskutim.<sup>8</sup> Si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin e komunave, partitë që nuk janë në pushtet shpesh tregohen ambivalente; marrëveshjet në prapaskenë shpesh parandalojnë debatimin publik të çështjeve. Në komunën e Ferizajit, pas kalimit në opozitë në fund të 2007, Lidhja Demokratike e Dardanisë, LDD, flirtoi me administratën e Partisë Demokratike të Kosovës, PDK, në 2008, duke e thyer heshtjen në këshillin komunal vetëm me “pyetje sugjeruese” mbi çështje kyçe në 2009.<sup>9</sup> Ndonëse kuvendi supozohet të garantojë përgjegjshmërinë e qeverisë, në vjeshtën e 2009 Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, ICR, Pieter Feith sugjeroi se është qeveria ajo që kontrollon kuvendin.<sup>10</sup> Anëtarët e kuvendit nuk guxojnë t'i besojnë sistemit të emailit të kuvendit. “Pjesa më e madhe... janë të frikësuar, ndihen të pambrojtur”, duke pasur frikë në mënyrë të veçantë nga ish komandantët e UÇK-së në qeveri.<sup>11</sup> Një ministër kërcënoi në mënyrë të drejtpërdrejtë kryetarin e një komisioni parlamentar në mënyrë që të mos lejonte që komisioni ta merrte në pyetje.<sup>12</sup> Propozimet për debate parlamentare mbi çështjet e nxehta të ditës ose nuk arrijnë ndonjë rezultat ose bëhen pas shumë negociatash dhe vonesash.<sup>13</sup>

Në fakt, një pjesë e madhe e hapësirës së debatit politik sekuestrohet nga armiqësia e thellë mes

<sup>3</sup> Intervistë, analisti Halil Matoshi, 4 nëntor 2009

<sup>4</sup> Intervistë, Nexhmedin Spahiu, drejtor i TV Mitrovicës, 10 mars 2010. “Në traditën tonë njeriu me autoritet ulet pranë vatrës. Argumentet e tij janë të vlefshme pavarësisht nëse janë logjike apo jo. Nëse ulesh afër derës, mund të jesh i zgjuar sa Isak Njutoni por prapëseprapë je askushi”.

<sup>5</sup> Pesë anëtarët perëndimorë – SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Franca, Italia – të ish Grupit të Kontaktit i cili përfshinte Rusinë dhe bashkëpunonte për të zgjidhur konfliktin në Ballkanin Perëndimor.

<sup>6</sup> Plani i Ahtisaarit përbëhet nga një raport që propozon që Kosova të ketë status të pavarur, fillimisht të mbikëqyruar nga trupat ndërkombëtare, si dhe një Propozim të Përgjithshëm për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, që detajon aranzhimet e brendshme të territorit. <http://www.unosek.org/unosek/en/statusproposal.html>

<sup>7</sup> Mund të citohen shumë nga debatet parlamentare të Kosovës. Shih debatin e 4 marsit 2010, për shembull, Faton Ismajli, “Fyerjet parlamentare”, *Express*, 5 mars 2010.

<sup>8</sup> Shih Drilon Zogaj, “Opozitë që vetëm komenton: Oponencën ndaj Qeverisë po e ushtrojnë deputetët e pavarur dhe kryetari i kryeqytetit”, *Zëri*, 15 maj 2010.

<sup>9</sup> Intervistë, Afrim Demiri, korrespondent i *Kohës Ditore* në Ferizaj, 12 dhjetor 2009.

<sup>10</sup> Fjala përpara Parlamentit Europian, 1 shtator 2009, dhe në konferencën e Klubit për Politikë të Jashtme mbi Raportin e Progresit të BE-së, 16 tetor 2009.

<sup>11</sup> Intervistë, deputet i parlamentit, 26 shkurt 2010.

<sup>12</sup> Ibid.

<sup>13</sup> Për shembull, paraqitja e Kryeministrit Thaçi në Kuvend që të përgjigjet në lidhje me gjetjet e ashpra e Raportit të Progresit të BE-së për 2009, të publikuar në mes të tetorit, është prolonguar deri në fund të nëntorit 2009 – pas raundit të parë të zgjedhjeve lokale – edhe pse partia në opozitë, LDD ka dorëzuar kërkesën për këtë me 22 tetor 2009. Lumturie Blakaj, “Interpelancën e Thaçit po e prolongon qëllimisht Kryesia”, *Zëri*, 6 nëntor 2009 dhe Zijadin Gashi, “Bojkot, nese nuk raporton Thaçi”, *Zëri*, 11 nëntor 2009.

Kryeministrit dhe kryetarit të PDK, Thaçi me kryetarin opozitar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, AAK, dhe ish kryeministrin Haradinaj. Kjo armiqësi nganjëherë është kaq e nxehtë sa duket sikur mund të shndërrohet në përplasje fizike mes të dy kampeve. Pas një vjedhjeje në shtëpinë e tij në qershor 2008, Thaçi e njoftoi AAK-në si “sulmuesit e natës” dhe në një deklaratë për shtyp tha se qeveria e tij ishte e përkushtuar ndaj “luftës kundër së keqes”.<sup>14</sup> Në qershor 2009, disa politikanë të PDK-së e akuzuan AAK-në për një sulm kundër ndërtesës së qeverisë, që në fakt ishte vepër e veteranëve të UÇK-së, ku u përdorën dy granata, disa bomba Molotov dhe pati të shtëna me armë zjarri.<sup>15</sup> Një muaj më parë, Haradinaj dhe zëvendës ministri i transportit dhe telekomunikacionit i PDK, Adem Grabovci shkëmbyen publikisht akuza të hollësishme për mitmarrje dhe përfshirje në kriminalitet.<sup>16</sup> Komentit zyrtar i PDK-së ishte: “Kërcënimet me vdekje dhe shantazhimi nuk janë pjesë e demokracisë. Votat nuk mund të fitohen me plumba.”<sup>17</sup>

Në fakt, dimensionit paraushtarak i të dy partive të dalura nga UÇK-ja ua ka rritur atyre ndikimin politik në koalicionet qeverisëse me LDK. Përpara se votat e saj të përgjysmoheshin në zgjedhjet e nëntorit 2007, LDK nuk e kishte mbajtur kurrë postin e kryeministrit, pavarësisht se kishte fituar 45% të votës popullore, duke ia lënë atë gjithnjë njëherë prej partive të UÇK-së. Haradinaj i kontrolloi levat e pushtetit nga 2004 deri në 2007 pavarësisht se partia e tij, AAK, kishte fituar vetëm 10% të votave. Tanimë PDK e kontrollojnë qeverinë me 33% të votave në një mënyrë që LDK nuk arriti ta bënte kurrë me 45% të votave. Kjo e

fundit tashmë është kthyer në një partner pasiv të PDK-së në qeveri.

Dominimi i PDK gjatë dy viteve të para të shtetit të Kosovës u përdor për të dobësuar institucionet, bordet dhe median që supozohen që me pavarësinë, profesionalizmin dhe paanshmërinë e tyre mund të luajnë rol për të mbajtur qeverinë të përgjegjshme dhe për të monitoruar respektimin e procedurave dhe ligjeve prej pushtetit ekzekutiv në shtetin e ri. Bordet e ndërmarrjeve publike u mbushën me “njerëz që janë të gatshëm të zbatojnë politikën e ministrit apo qeverisë,” pranoi ministri i transportit dhe telekomunikacionit Fatmir Limaj.<sup>18</sup> Është duke u zhvilluar një përpjekje e qëndrueshme e qeverisë që ka për synim nënshkrimin e sferës publike, duke mbajtur formën e jashtme të institucioneve, por duke i shndërruar ato nga rojtare të ligjit dhe të së mirës së përbashkët në përçues të vullnetit të Kryeministrit dhe të rrethit të tij. “Rojtarët e shtetit ndihen si pronarët e shtetit.”<sup>19</sup> Këto institucione shihen si instrumente me të cilat mund të thellohet dhe zgjatet qëndrimi në pushtet. Në nivelin qendror, udhëheqja e PDK-së padyshim që ka frikë se nëse nuk i kontrollon këto hapësira publike tani kur ka mundësi, këtë mund ta bëjnë më vonë kundërshtarët e saj, duke qenë se partitë opozitare sillen në mënyrë të ngjashme në komunitat që i kontrollojnë.

Për shumë individë, trashëgimia e sundimit të huaj dhe e përdorimit të makinerisë së shtetit kundër tyre krijon konfuzion në lidhje me faktin nëse duhet ta mbështesin shtetin apo jo. Ka konfuzion mbi faktin nëse funksioni i shtetit është të zgjerojë apo të tkurrë hapësirën e lirisë së njerëzve. Agjencia Kundër Korrupsionit zbuloi se njerëzit kanë vështirësi me konceptin se informimi në agjenci përbën një akt patriotizmi dhe jo një akt tradhtie,<sup>20</sup> ndërsa ndërmarrësit ekonomikë që kanë fituar eksperiencën e viteve 1990 “bëjmë edhe vetë me hile duke mashtruar shtetin.”<sup>21</sup> Konfuzioni shtohet nga perceptimet se vetë qeveria vjedh aq shumë sa nuk duket me vend ta konsiderosh atë si

<sup>14</sup> Hajduti duket se ishte i paarmatosur dhe mund të mos e ketë ditur se në shtëpinë e kujt ishte futur. Megjithatë ai është akuzuar për tentativë vrasje ndaj kryeministrit i cili në atë kohë ishte jashtë shtetit. Shih: Kastriot Jahaj, “Prokuroria nuk ofron dëshmi se Fazli Sejdiu kishte armë”, *Koha Ditore*, 3 mars 2010

<sup>15</sup> Kastriot Jahaj, “Veteranët në ‘luftë’ – Qeveria do t’i ndëshkojë”, *Koha Ditore*, 17 korrik 2009

<sup>16</sup> Komentet e vëzhguesve të zhgënjyer përfshinin: “Partitë politike duhet të jenë promotorët e demokratizimit të shoqërisë, ndërkohë që këto dy parti (PDK – AAK) janë kthyer në gjeneratorë të një gjuhe dhune dhe kërcënimesh në jetën publike.” Ilir Deda, drejtor i institutit kërkimor KIPRED, televizioni RTK, 21 qershor 2009; “Përplasjet verbale mes kryetarit të AAK Ramush Haradinaj dhe zëvendës ministrit për telekomunikacionin Adem Grabovci përbëjnë në shtypje verbale për shoqërinë kosovare,” Halil Matoshi, *Koha Ditore*, 24 qershor 2009;

<sup>17</sup> Prononcim për shtyp, 18 qershor 2009.

<sup>18</sup> Intervistë me Arbana Xharra “Qeveria duhet të ketë njerëzit e saj në bordet e ndërmarrjeve publike”, *Koha Ditore*, 25 prill 2008.

<sup>19</sup> Intervistë, biznesmen Erolld Belegu, 18 dhjetor 2009.

<sup>20</sup> Intervistë, Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, 15 dhjetor 2009.

<sup>21</sup> Intervistë, biznesmen Erolld Belegu, 18 dhjetor 2009.

“shteti ynë”.<sup>22</sup> Nëse nuk je i pushtetshëm, përpjekjet për të ruajtur legjitimitetin e shtetit janë një punë pa bërëqet sepse kjo do të përdoret kundër teje. Ky ishte përfundimi i kandidatit për kryetar komune për Pejën i partisë së vogël Ora, pasi ai kundërshtoi zgjerimin e hotelit Metohija të qytetit nga kompania e fuqishme Dukagjini pa një leje ndërtimi. Partia AAK që kontrollonte komunën përhap mesazhin se shtëpitë e gjithkujt ishin në rrezik shembjeje nëse fitonte kandidati i Ora-s.<sup>23</sup>

Të mbeturat e frikës, mungesa e shprehive të pjesëmarrjes civile dhe skepticizmi mbi rezultatet e kësaj pjesëmarrjeje pengojnë qytetarinë aktive.<sup>24</sup> Stresi post-traumatik i shumë përhapur që prej konfliktit të 1998–99 me Serbinë mund të ketë kontribuar drejt kësaj situatë.<sup>25</sup> Natyra e udhëheqjes kombëtare kosovare i bën njerëzit të hezitojnë: refleksi i qeverisë aktuale është të shtypë çdo kritikë, dhe sjellja e saj në mënyrë të zbehtë të sjell ndër mend paraardhësen e saj të përkohshme të 1999. Ngjashëm, një seri vrasjesh në Kosovën perëndimore ka bërë që shumë njerëz të kenë frikë nga ish eminenca gri e qeverisë, Haradinaj. Njerëzit janë të vetëdijshëm në mënyrë të vagullt mbi praninë e rrjeteve jo zyrtare të sigurisë. Ndonëse shqiptarët, serbët dhe minoritetet e tjera kanë filluar t’ i lënë pas numrin e madh të vrasjeve të pazgjdhura të periudhës së pasluftës, trashëgimia shoqërore e tyre mbetet. Rrëfimi i një ish ushtari të SHIK-ut në nëntor 2009, sipas të cilit ai kishte marrë pjesë në rrahje dhe vrasje e përjetësoi rikthimin e 1999-it në në skenë. Paria e ish UÇK-së e lidhur me PDK-në nxitoi t’ i mohonte pretendimet e tij.<sup>26</sup>

<sup>22</sup> Ibid

<sup>23</sup> Intervistë, Gazmend Muhaxheri, 15 dhjetor 2009.

<sup>24</sup> Koment i sociologut Ardian Gola, televizioni Klan Kosova, 15 shtator 2009.

<sup>25</sup> Shih J. Ahern et al, “Gjinia, përkrahja shoqërore dhe stresi post-traumatik në Kosovën e pas luftës” [“Gender, social support and posttraumatic stress in postwar Kosovo”], nëntor 2004, <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/15505520>

<sup>26</sup> Nazim Bllaca një ish mësues gjeografie regjistroi një rrëfim 30 minutësh në DVD i cili iu paraqit parlamentit dhe medias nga dy deputetë të LDD. Zëvendës ministri i brendshëm, Fatmir Xhelili ishte ndër personat të cilët ai i akuzonte se kishin urdhëruar vrasje një dekadë më parë. Me 29 nëntor 2009 ai dha një konferencë për shtyp të improvizuar në një rrugë jashtë parlamentit ku sërisht pranoi se kishte kryer vrasje dhe u arrestua një ditë më pas. Gjatë dy javëve që pasuan, qeveria dhe mediat që e mbështesin sugjeruan se Bllaca ishte i çmendur, një shantazhues, gënjeshhtar dhe se rrëfimi i ishte kërkuar nga Serbia.

Efekti neto i kësaj situatë është se pjesa më e madhe e qytetarëve ende mendojnë se është më e sigurt të heshtësh, të mos përzihesh me këto punë, dhe t’i rri larg aksionit publik. Një banor i një blloku apartamentesh në qendër të Prishtinës u përpoq të merrte nënshkrimet e fqinjëve të tij për të kundërshtuar zënien dhe komercializimin e zonës së tyre të parkimit nga një veteran i UÇK-së që shërbente në polici, por u kërcënua.<sup>27</sup> Nga ngjarje si kjo njerëzit arrijnë në përfundim se mungon drejtësia natyrore dhe se shteti do të keqpërdor mekanizmat zyrtarë të ankimit.<sup>28</sup> Qytetarët u japin në mënyrë vullnetare informacion autoriteteve hetimore kur shohin precedentë që u japin atyre “lejen” për ta bërë këtë; arrestimet e doktorëve dhe policëve në 2008 nxitën një mori denoncimesh në Agjencinë Kundër Korrupsionit.<sup>29</sup> Kur një grup punonjësish të sektorit publik gjejnë guximin të dalin në grevë, këtij aksioni i bashkohen edhe të tjerët, duke perceptuar se ky aksion simultan ofron siguri.<sup>30</sup>

Disa segmente të shoqërisë së Kosovës janë të pambrojtura nga shantazhet. Lufta e 1998 – 99 u luftua kryesisht në zonat rurale; popullsia urbane ishte më pasive dhe pësoi dëme më të vogla. Mbi popullsinë urbane, apo popullsitë “qytetare” deret një hije e zbehtë dyshimi se u sollën si kuislingë,<sup>31</sup> megjithëse kjo popullsi i sheh nga lart poshtë bashkatdhetarët e tyre nga zonat rurale dhe të ardhurit e rinj në zonat urbane. Në dekadat e mëparshme jetët e qytetarëve ishin të ndërthurua me Serbinë dhe me serbët. Dhjetëra mijëra shqiptarë të Kosovës ende marrin dhe përdorin pasaporta serbe, shumë prej tyre ende kanë lidhje me serbët. Klasa e biznesmenëve dominohet akoma nga importuesit dhe ofruesit e shërbimeve

<sup>27</sup> Një incident në të cilin ky banor është arrestuar padrejtësisht në lidhje me parkim para banesës mund të mos ndërlihet me këtë. Intervistë, përfaqësues i OJQ-së ndërkombëtare, nëntor 2009.

<sup>28</sup> Intervistë, këshilltar ndërkombëtar i një institucioni mbikëqyrës shtetëror, 18 dhjetor 2009.

<sup>29</sup> Intervistë Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, 15 dhjetor 2009.

<sup>30</sup> Në fund të janarit dhe fillim të shkurtit 2010 policia, punonjësit e shëndetësisë, nëpunësit civilë, administratorët e gjykatave, rojat e burgjeve dhe madje edhe shoferët e taksive dolën në protesta.

<sup>31</sup> Kosova rurale dhe urbane kanë ofruar dy ikona të luftës për pavarësi që janë diametralisht të kundërta: Adem Jashari i cili u vra bashkë me disa dhjetëra anëtarë të familjes së tij dhe të fqinjëve duke ofruar një rezistencë të armatosur të pashpresë, dhe Ibrahim Rugova rezistenca e të cilit ishte aq pasive dhe i cili i mbijetoi luftës duke i ofruar Millosheviçit një fitore propagandistike në një shfaqje të përbashkët publike në kulmin e fushatës së spastrimit etnik.

që bënë kompromise me regjimin serb në vitet 1990. Klasa e gjyqtarëve ende përmban shumë syresh që gjykojnë shqiptarë për krime politike në vitet 1980. Të gjithë këta dhe shumë njerëz nga profesione të tjera që bashkëpunuan me shërbimet e sigurimit serb në vitet 1990 mund të kontrollohen. SHIK ka zënë pozicionin e rojës së portës së shantazheve.<sup>32</sup> Për më tepër dosjet mbi të kaluarën e njerëzve, provat e homoseksualitetit dhe regjistrimet e marrëdhënieve me prostitutat apo serbët janë disa instrumente të tjera që raportohen.<sup>33</sup>

Shkalla deri në të cilën njerëzit mund të marrin pjesë në sferën publike paraqet dallime gjeografike: Prishtina ka përqendrimin më të lartë të medias, të mendimtarëve liberalë dhe prezencën më të madhe ndërkombëtare. Prishtina dhe qytetet e tjera të mëdha kanë shpërndarje gazetash, një zgjedhje më të madhe kanalesh televizive dhe kabllore dhe, ç'është më e rëndësishmja, një furnizim të rregullt me energji elektrike. Nëse shohim njërin tregues, në Prishtinë lesbiket dhe homoseksualët përbëjnë një komunitet diskret,<sup>34</sup> në një nga qytetet e mëdha provinciale "ka dy njerëz që i njohin të gjithë... por ata nuk kanë probleme," por në një qytet të vogël si Kaçaniku homoseksualët "do të vriteshin".<sup>35</sup>

Në provincë pushteti mund të ushtrohet në mënyrë më rrugaçerore<sup>36</sup> dhe abuzimet janë më flagrante.<sup>37</sup> Atje lidhjet familjare janë më të ngushta, çka ushtron një presion më të madh frenues mbi lirinë e shprehjes.<sup>38</sup> Gazetat që mbulonin gjykimin për

<sup>32</sup> Një dorëzim zbulues i dosjeve për njerëzit e LDK që iu dha policisë nga PDK në fillim të vitit 2005.

<sup>33</sup> Intervistë: Halil Matoshi, analist, *Koha Ditore*, 4 nëntor 2009; Faik Ispahu, *Internews*, 10 mars 2010.

<sup>34</sup> Megjithatë, janë shumë të paktë ata që ndihen të sigurt të zbulojnë identitetin e tyre. Një dokumentar i 2008 mbi problemet e komunitetit homoseksual të Kosovës i fshihte identitetet e pjesëmarrësve.

<sup>35</sup> Intervistë, Drejtor i OJQ-së, tetor 2009. Organizmat e zbatimit të ligjit nuk kanë klasifikuar asnjë vrasje të viteve të fundit si homofobike, por megjithatë një aktiviste lesbike deklaroi se dinte për tre të tilla në katër vjetët e fundit: dy në Prishtinë dhe një në Ferizaj. *Korrespondencë*, 20 maj 2010.

<sup>36</sup> Disa kryetarë komune duket sikur arrijnë të shpëtojnë edhe pse rrahin njerëz të cilët më pas nuk ankohen në polici. *Ibid.*

<sup>37</sup> Hulmuesit për një seri debatesh komunale të shfaqura në televizion zbuluan se gjatë udhëtimeve ditore nga kryeqyteti ata mund të mblidhnin informacione të mjaftueshme mbi abuzimet në pjesën më të madhe të komunave. Intervistë, Jeta Abazi, *Jeta në Kosovë*, 2009.

<sup>38</sup> Kryetari i degës së LDD për Skënderajin tha për kryetarin e komunës Lushatak: "Nuk është se kam frikë. Ai e di që unë jam hapur kundër tij, unë jam kryetari i degës së partisë këtu. Ai është në

pastrim parash që lidhej me fondin për mbrojtjen ligjore të kryetarit të AAK Haradinaj, u zhdukën nga shitja në Pejë e qeverisur nga AAK.<sup>39</sup> Policia bashkëpunoi në një fushatë sulmesh kundër personelit të studiove të TV Mitrovicës kur ky televizion u rihap pas ishte detyruar të mbyllej për një vit në 2007.<sup>40</sup> Pak OJQ lokale guxojnë të armiqësojnë autoritetet komunale.<sup>41</sup> Disa organizata donatore në mënyrë të pavullnetshme bëhen bashkëpunëtore në konsolidimin e një konformizmi të tillë, duke e bërë marrëveshjen e bashkëpunimit me kryetarin e komunës një parakusht për dhënien e financimeve.<sup>42</sup> Pjesa më e madhe e mediave lokale qëndrojnë në zonën e komfortit dhe janë pasive, pjesërisht për shkak të faktit se ato varen nga reklamat e komunës dhe të ndërmarrjeve lokale, dhe se gjatë tenderave për kontratat e shërbimeve priren të fitojnë më servilet.<sup>43</sup> Pasi drejtori i televizionit të Prizrenit, TV Besa e pushoi nga puna një gazetar për shkak se i kishte bërë pyetje të vështira zëdhënësit të kryeministrit,<sup>44</sup> ai u justifikua duke thënë se nuk është detyra e medias lokale të sfidojë qeverinë qendrore.<sup>45</sup> *Gazeta Koha Ditore* e cila ka një rrjet korrespondentësh komunalë, i përforcon këta korrespondentë në komunat e vështira si Viti, Skënderaj apo Malishevë duke dërguar reporterë

---

anën tjetër por konflikti me dhëndrin e dikujt të çon në konflikt me vjehrrën e dikujt dhe përfundon në konflikt me gruan", *Jeta në Kosovë*, RTK, 28 maj 2009. INPO citon si një rast tipik një tjetër komunë të vogël në Kosovën qendrore ku "të gjithë ata që janë në pushtet janë farefis, asgjë nuk diskutohet dhe gjithçka mbahet në heshtje", intervistë, Albulena Sadiku, 30 tetor 2009.

<sup>39</sup> *Korrespondencë* nga rrjeti i monitorimit të komunave i BIRN, 29 janar 2010.

<sup>40</sup> Intervista, Nexhmedin Spahiu, Drejtor TV Mitrovica, 10 mars 2010, dy punonjës të studios, 28 prill 2010. Shih deklaratën e Komisionit të Pavarur të Medias, 13 shkurt 2009.

<sup>41</sup> OJQ-ja Gjilanase KCIC erdhi bashkë me vëllain e kryetarit të komunës në një takim që kishte kërkuar Institutit GAP në lidhje me pesë problemet kryesore të komunës. Intervistë, Agron Demi, Institutit GAP, 30 tetor 2009.

<sup>42</sup> *Ibid.*

<sup>43</sup> Intervistë, Albulena Sadiku, INPO, 30 tetor 2009 dhe Afrim Demiri, korrespondenti për Ferizajin i *Kohës Ditore*, 12 dhjetor 2009.

<sup>44</sup> Gazetari Jeton Llapashtica tha se më pas drejtori i stacionit televiziv i kishte thënë: "Nuk duhet t' ia kishe bërë atë pyetje sepse e provokove shumë. Ne nuk duhet t' ia ngacmojmë njerëzit e qeverisë. Ata na japin reklama". Lawrence Marzouk, "Programi i BIRN nxit përplasje lidhur me lirinë e shprehjes", ["BIRN Show Triggers Row on Freedom of Speech in Kosovo"], *Balkan Insight*, 11 qershor 2009.

<sup>45</sup> Drejtori i Besa TV, Muhamer Fusha, i intervistuar në *Jeta në Kosovë*, RTK, 28 maj 2009. "Ai tha se ishte detyra e medias kombëtare të merrej me çështjet e mëdha dhe argumentoi se Llapashtica ishte pushuar për shkak të performancës së tij, ndonëse shtoi se "të jesh kritik nuk është në interesin më të mirë të një televizioni lokal." *Ibid.*

nga Prishtina për të ndihmuar në raste të storieve kontroverse.<sup>46</sup>

Sami Lushtaku, kryetari i komunës së Skënderajt me një fizikë imponuese, e mishëron këtë ndarje. Opozitës, grupeve të shoqërisë civile dhe medias u duhet të ecin në majë të gishtave;<sup>47</sup> atij ligji i aplikohet me shumë kufizime.<sup>48</sup> Nën *Pax Lushtaka* të Skënderajt ai fiton 90 për qind të votave. Shifrat e kriminalitetit janë të ulëta dhe ai ka arritur të marrë financime qeveritare masive për infrastrukturën në këtë komunë dëshpërimisht të varfër. Megjithatë, duket sikur ai i shpërndan në mënyrë arbitrare këto fonde.<sup>49</sup> Shkollat e Skënderajt shënojnë rezultate aq të larta sa të bëjnë të dyshosh në testet kombëtare të prezantuara tri vjet më parë,<sup>50</sup> si pasojë e të cilave një numër i shpërpjesëtuar i nxënësve të Skënderajt arrijnë të sigurojnë vende në Universitetin e Prishtinës. Ekipi i një televizioni të Prishtinës që investigoi çështjet e komunës u dëbua me armë në fillim të 2009. Transmetimi i raportit tejet kritik në maj 2009 shkaktoi një reagim, ku përfshiheshin fyerje degraduese dhe kërcënime nga shoqëria e Skënderajt dhe tabloide të lidhura me PDK.<sup>51</sup> Disa shihnin tone shpërfillëse në prezantimin e programit televiziv: “A thua se vijnë nga Parisi dhe jo nga Prishtina,”<sup>52</sup> fluksi i të ardhurave që Lushtaku i ka sjellë Skënderajt të stër-varfëruar i ka lejuar pjesës më të madhe të banorëve të

<sup>46</sup> Intervistë, Agron Demi, Instituti GAP, 30 tetor 2009

<sup>47</sup> Kjo dinamikë ishte e dukshme në debatin mbi zgjedhjet lokale Skenderaj në *Jeta në Kosovë*, RTK. Një aktivist i LDD u rrah dhe u shtrua në spital gjatë ditës së votimit, 13 nëntor 2009; policia nuk ndërmoi asnjë masë. Lëvizja radikale *Vetëvendosje* nuk mund të organizohet në komunat e Drenasit dhe të Skënderajt në rajonin e Drenicës si pasojë e presionit nga strukturat lokale të pushtetit (PDK). Intervistë Glauk Konjufca, aktivist i *Vetëvendosje*, 12 maj 2010.

<sup>48</sup> Kur u dënua me katër muaj burg në maj 2008 pasi kishte ngacmuar dhe kërcënuar një gjykatës në 2006, kritikant kundër tij dhe kërkesat që ai të dorëhiqej nga posti i kryetarit të komunës ishin të kufizuara. Ai u lejuar të shkonte vullnetarisht në burg, çka qeveria e vlerësoi si një “akt kurajoz vetësakrifikimi”, Kastriot Jahaj, “Sami Lushtaku në burg për kërcënim të gjykatësit”, *Koha Ditore*, 9 maj 2008. Pati dhe raste të tjera kur ai u gjet se kishte armë pa leje, por këto nuk u çuan më tej.

<sup>49</sup> Qytetarët e intervistuar në raportin nga terreni i *Jeta në Kosovë* sugjeronte se disa kontrata për ndërtimin e rrugës ishin dhënë përpara së të bëhej tenderi ose ishin tenderuar në mënyrë të përsëritur. Transmetimi në RTK, 28 maj 2009.

<sup>50</sup> Berat Buzhala, kryeredaktor i gazetës *Express* e sfidoi ministrin e arsimit Enver Hoxhaj të pranonte se kishte pasur hile masive në Skënderaj. Debat në Klan Kosova, 4 mars 2010.

<sup>51</sup> Gazeta *Infopress* e ofroi platformën për këtë fushatë, 1-17 qershor 2009.

<sup>52</sup> Intervistë, gazetari i *Express* Jeton Musliu (i cili është nga Skënderaj), 8 mars 2010.

“marrin frymë lirisht”<sup>53</sup>, faktor ky që i tejkalon shqetësimet metropolitane për lirinë.

Sidoqoftë, gjendja e aktivizmit qytetar nuk është universalisht e zyrtë. Pavarësisht mungesës së rezultateve, numri i ankesave të bëra nga qytetarët tek Agjencia Kundër Korrupsionit pësoi 35% rritje në 2009.<sup>54</sup> Mediat liberale dhe OJQ-të liberale e kanë shprehur zëshëm padurimin e tyre që EULEX-i të padisë ministra të korruptuar.<sup>55</sup> por është e paqartë nëse kjo pasqyron një frymë të përhapur më gjerë. Ndërmarrësit e rinj në Pejë organizuan një protestë kundër trupave të zbatimit të ligjit për dështimin e këtyre të fundit për të mbrojtur klubet dhe kafenetë e tyre nga incidentet me armë zjarri;<sup>56</sup> importuesit e mishit ndërmorën një fushatë efektive për të rrëzuar një direktivë të çuditshme qeveritare që do ta kishte kthyer importin e ushqimeve në Kosovë në monopolin e një kompanie të huaj.<sup>57</sup> Mes listës së pafund të zyrtë të ndërmarrjeve publike dhe bordeve mbikëqyrëse që kanë rënë nën kontroll politik dhe të bizneseve private që ose intimidohen që të heshtin mbi abuzimet e qeverisë, ose bëhen bashkëpunëtorë në këto abuzime, organizata si Oda Ekonomike e Kosovës kanë ruajtur një kryesi të besueshme dhe profesionale. Harxhimi i durimit në sektorin e shëndetësisë ka ringjallur sindikatat, çka ka rezultuar në një bashkim të sindikatave në udhëheqjen e kryesive aktiviste të zgjedhura rishtazi në mars 2010; kjo mund të shtrihet edhe më tej. Mediat që nuk kanë rënë nën kontrollin e qeverisë dhe madje edhe seksione të atyre mediave që janë nën kontrollin e qeverisë, po bëhen më të guximshme; në disa kanale televizive dhe në media të reja si Facebook-u debati është gjallëruar.

## Partitë politike

<sup>53</sup> Ibid.

<sup>54</sup> Nebih Maxhuni, “Rritje 35 per qind”, *Express*, 12 mars 2010.

<sup>55</sup> OJQ-të Klubi për Politikë të Jashtme dhe KIPRED koordinuan dy letra të hapura që u firmosën nga një duzinë OJQ-shë kosovare dhe që kërkonin një mbështetje më të plotë për përpjekjet për të zbatuar sundimin e ligjit nga Zëvendës Sekretari Amerikan i Shtetit, James Steinberg që po vizitonte Kosovën në prill 2010 si dhe nga Përfaqësuesja e Lartë e BE Catherine Ashton në shkurt 2010.

<sup>56</sup> Intervistë, Kujtim Kërveshi, analist ligjor (nga Peja), 25 shkurt 2010.

<sup>57</sup> Shkëlzen Dakaj, “Industria kosovare e mishit proteston kundër instalimit të monopolit në treg”, *Zëri*, 4 korrik 2009.

Arena politike në Kosovë do të duhej të krijonte kushte për një konkurrencë të lirë të ideve dhe për përfaqësimin e kontingjentit të madh të të rinjve, pa ndonjë barrierë ndaj formimit dhe suksesit të mjeteve politike. Por, partitë ekzistuese ngjajnë më shumë me grupe interesi klienteliste, të kontrolluara në mënyrë hierarkike nga kryesi të papërgjegjshme ndaj tyre, që u mungojnë forumet e debatit dhe linjat e komunikimit horizontal dhe të afta për të penguar hyrjen e njerëzve të rinj në skenën politike. Interesat e ndërthurura të kryesive të tyre për para dhe pushtet dhe nevoja për të ushqyer rrjete klientësh, okupojnë hapësirën politike, duke i nxjerrë jashtë loje idetë. “Partitë tona janë që të gjitha biznese private. PDK është më e madhja dhe ka shumë aksionarë...blerja e LDK është ende e kontestuar... Të tjerat kanë vetëm nga një aksioner.”<sup>58</sup>

LDK, LDD, AKR dhe AAK e kanë quajtur veten forca të “qendrës së djathtë” edhe pse nuk kanë fare politika që do t’i përcaktonin ato si të tilla. Për sa i përket PDK-së, pasi e kishte projektuar atë fillimisht si një forcë social demokrate<sup>59</sup> të lidhur me Partinë Laburiste Britanike dhe me Internacionalen Socialiste,<sup>60</sup> për një kohë të shkurtër kryeministri Thaci refuzoi të pranonte ndonjë lloj përcaktimi politik.<sup>61</sup> Partia e tij flirtoi me mundësinë e bashkimit me turmën e “qendrës së djathtë” (90% e spektrit politik të shqiptarëve të Kosovës është nominalisht në këtë pozicion)<sup>62</sup> dhe Thaçi shkoi deri në atë pikë sa në një debat parlamentar në maj 2010 e quajti veten të djathtë.<sup>63</sup> Zanafilla e atraktivitetit të LDD-së i ka rrënjët tek presidenti i ndjerë Rugova, ndërsa fushata e Aleancës për Kosovën e Re, AKR, përqendrohet tek arritjet dhe premtimet që ofron kompania e ndërtimit Mabetex e kryetarit të partisë së tyre. Mes partive të vogla, “Liberalët” e Gjergj Dedajt i mëshojnë shumë afërsisë së tyre me

<sup>58</sup> Intervistë, Agron Bajrami, kryeredaktor, *Koha Ditore*, 13 maj 2010

<sup>59</sup> Intervista, Hashim Thaçi, kryetari i PDK-së, 2005 & 2006.

<sup>60</sup> Zëdhënësi i kryeministrit Thaçi, Memli Krasniqi i shastisi zyrtarët e Laburistëve Britanikë që po i vizitonin duke u thënë atyre se PDK e shihte veten si një parti e qendrës së djathtë. Intervistë me Scarlett McCWire, nëntor 2008.

<sup>61</sup> Intervistë në televizionin Klan Kosova, 18 shkurt 2010. Ai tha se elektorati do t’i gjykonte partitë nisur nga sukcesi që ato kanë në qeverisje dhe shprehu skepticizëm në lidhje me pretendimin e AAK se përfaqëson të djathtën.

<sup>62</sup> Drilon Zogaj, “PDK ia mësyn djathtas”, *Zëri*, 31 mars 2010.

<sup>63</sup> Vatra Qehaja, “Opozita akuzon Qeverinë për korrupsion në ndërmarrjet publike”, *Koha Ditore*, 14 maj 2010

Ndërkombëtarene Liberale, por në realitet tregojnë shumë pak prirje liberale, ndërkohë që edhe partia tanimë e falimentuar Ora, e themeluar si një lëvizje qytetare liberale nga publicisti Veton Surroi, harroi po ashtu të gjente një profil të sajën politik, kurse Lëvizja Popullore e Kosovës, partia mbarë shqiptare, LPK, e rishpiku vetveten si Parti Socialiste jo dhe aq si pasojë e bindjeve sesa për të shfrytëzuar një boshllëk të perceptuar në tregun politik.<sup>64</sup>

Në të vërtetë të gjitha këto parti kanë mbështetës që mbulojnë të gjithë spektrin politik, nga e majta ekstreme e deri tek e djathta ekstreme. Këto parti burojnë nga themelet e tyre si fraksione të lëvizjes kombëtare shqiptare, kështu që ideologjia politike ka një rol të dobët, ose “asnjë lloj roli”.<sup>65</sup>

Pavarësisht disa fragmentimeve të peizazhit politik, klasa politike kosovare mbetet ajo e viteve 1990. Në vend të dasisë e majtë – e djathtë, partitë e shqiptarëve të Kosovës ende identifikohen me themelet e tyre përkatëse prej partish të “luftës” (PDK, AAK) apo “qytetare” (LDK, AKR, LDD, ORA që tashmë është shpërbërë), çka i referohet përçarjes që ekzistonte mes tyre në vitet 1990 në lidhje me mënyrën për t’i rezistuar shtypjes serbe.

Kjo dasi është zbutur gjatë dekadës së fundit, duke qenë se që prej 2004, partitë me iniciativën e tyre kanë formuar koalicione që i tejkalojnë këto kufij dhe armiqësia më e dukshme tashmë është transferuar tek përplasja mes PDK dhe AAK, që gjenden të dyja në kampin e “luftës”. Pavarësisht, dominimit të rinisë dhe sfidave teknike të ndërtimit të shtetit, personeli i forcave politike kosovare nuk ka pësuar ndonjë novacion të madh. Për shembull, në 2009 të katër kandidatët për kryetar komune në Klinë, për një mandat që do të vazhdonte deri në 2014, ishin ish luftëtarë të UÇK-së që ishin “jashtë kohës”.<sup>66</sup> Në nivelin kombëtar, LDK dominohet dhe paralizohet nga politikanë të moshuar e që kanë shërbyer aty për shumë kohë, ndërkohë që kryetarët e partive të “luftës” që sillen si komandanta dhe e kanë

<sup>64</sup> Shega A' Mula, “E majta e re, Partia Socialiste e Kosovës” [The New Leftists, Kosovo’s Socialist Party], *Balkan Insight*, 7 qershor 2009. Shih: <http://www.balkaninsight.com/en/main/news/19987/>

<sup>65</sup> Intervistë, Hajredin Kuçi, zëvendës kryeministër, 20 maj 2010.

<sup>66</sup> Analisti Petrit Selimi, përmbledhja e debatit zgjedhor, televizioni Klan Kosova, 23 tetor 2009.

vështirë të reformohen janë ende mjaft të rinj që i bënë ata të kenë dekada të tëra jete politike para vetit.

Suksesi politik në Kosovë varet shumë nga pasja në dispozicion e parave, nga rrjetet e mbështetësve militantë dhe ndikimi në administratën e zgjedhjeve. Bizneset private preferojnë të mbështesin partitë ekzistuese, që kanë influencë, çka shpesh ndodh për shkak se këto biznese kanë frikë nga pasojat që mund t'u vinë nëse nuk e ofrojnë këtë mbështetje. Pavarësisht premtimit të qeverisë se një projektligj mbi financimin e partive politike i hartuar në maj 2009 do të miratohej përpara zgjedhjeve lokale të nëntorit dhe dhjetorit 2009, kjo nuk ndodhi dhe zgjedhjet u zhvilluan pa ndonjë mbikëqyrje apo kontroll të tillë, ndërkohë që një projektligj i amenduar që po shqyrtohet tani do të minimizonte gjobat për shkeljet e rregullave të financimit.<sup>67</sup> S'ka dyshim se u shpenzuan (ose mbeten për t'u paguar) miliona euro për spote elektorale, mitingje e fishekzjarrë dhe ndoshta edhe për të blerë vota apo zyrtarë. Marrëdhëniet reciprokisht korruptuese të partive ekzistuese me bizneset u thelluan edhe më tej, ashtu siç u thellua dhe ndjesia se nëse partitë nuk duan të zhduken ato duhet të akumulojnë kontroll politik dhe administrativ për ta përdorur atë si një mjet presioni për financime.

Partitë e vogla ose partitë e futura rishtazi në skenën politike nuk kanë mjete të tilla dhe votat e tyre mund të bëhen fërtele në mënyrë administrative – komisionarët e tyre në qendrat e votimit mund të frikësohen apo të blihen, vëzhguesit mund të dislokohen gjatë apo të zëvendësohen nga njerëz të tjerë, kurse ata që i mbështesin mund të zbulojnë papritur se qendrat e tyre të votimit janë zhvendosur gjatë. “Përse duhet t'ia jap votën një partie që nuk mund të mbrojë votat e saj?” thonë disa.<sup>68</sup> Këto parti nuk kanë qasje në fondet publike që i japin vetes partitë që janë të përfaqësuara në kuvend dhe për më tepër atyre u duhet të kalojnë një prag prej 5% për të fituar ndonjë mandat. Të jesh i popullarizuar nuk mjafton: pavarësisht se vlerësohej në mënyrë të vazhdueshme si një nga politikanët e preferuar

<sup>67</sup> Fadil Sertolli, “Qeveria ‘amniston’ partitë”, *Zëri*, 12 mars 2010.

<sup>68</sup> Intervistë, Gazmend Muhaxheri, kandidat për partinë tanimë të shpërndarë Ora, 15 dhjetor 2009.

të kosovarëve, Partia Socialdemokrate, PSD, e ish kryeministrit Agim Çeku nuk la ndonjë përshtypje në rezultatet e zgjedhjeve lokale të 2009. Po ashtu, as popullariteti i Presidentit Sejdiu nuk e shpëtoi LDK-në nga rënia e saj e ndjeshme në 2007; rënie që zgjedhjet e 2009 nuk mundën ta përmbysin.

Thaçi, që personalisht gëzon me pak popullaritet, ka pasur shumë sukses.<sup>69</sup> Pasi humbi në katër palë zgjedhje, PDK-ja e tij arriti të triumfojë në 2007 dhe 2009, jo si pasojë e rritjes së mbështetjes për të, por si pasojë e përçarjes së votës së LDK-së. Qëndrueshmëria, vendosmëria dhe aftësia organizative e PDK-së arritën të fitonin mbi një ringjallje jetëshkurtër të LDK-së në disa komuna kyçe ku pati përsëritje të zgjedhjeve në fillim të 2010. Pati nga ata që ngritën akuza se PDK, duke pasur në dispozicion të saj SHIK-un, arriti t'i rafinonte metodat për të fituar një avantazh elektoral duke i shpëtuar kontrollit të vëzhguesve ndërkombëtarë dhe të kundërshtarëve.<sup>70</sup> Pati të tjerë që arritën në përfundimin se LDK nuk ishte një forcë më parimore, por thjesht një forcë më pak e organizuar.<sup>71</sup>

Problemi që formëson qasjen e Thaçit ndaj qeverisjes është sesi të zgjasë qëndrimin e PDK-së në pushtet pavarësisht paaftësisë së saj kronike për ta zgjeruar bazën e saj elektorale përtej 200 000 votave në një elektoral aktiv prej më se 700 000 votuesish,<sup>72</sup> nëse shumica “civile” e Kosovës dhe partitë e tjera në të ardhmen vendosin të bëjnë aleanca të mundshme me njëra tjetrën dhe jo me partinë e tij. Akademikët urbanë që u sollën në parti për t'i dhënë PDK-së një imazh më

<sup>69</sup> Index Kosova - sondazh i opinionit publik, qershor 2009. Shih:

<http://www.indexkosova.com/fly/?page=6&lang=2&item=62>

<sup>70</sup> Intervista: redaktor i televizionit Klan Kosova, tetor 2009; kandidati humbës për kryetar komune në balotazhin e dhjetorit 2009, 10 mars 2010.

<sup>71</sup> Intervistë, Valmir Ismaili, OJQ Demokracia në Veprim, 18 mars 2010.

<sup>72</sup> Në zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009, 189 000 votues votuan për kandidatët e PDK për kuvendet komunale. Në zgjedhjet parlamentare të 2007 që patën një pjesëmarrje më të ulët, për PDK votuan 196 207 votues, çka përbënte një rënie në krahasim me 199 112 votat që mori në zgjedhjet parlamentare të 2004 dhe 202 622 votat që mori në 2001. Zyrtarët e PDK e kanë treguar se janë të vetëdijshëm për kufizimet e rrepta të mbështetjes për partinë e tyre – një prej tyre i tha Jeta Xharras së RTK se “për mbështetësit tanë” nuk ndryshon gjë nëse ajo organizonte debate televizive mbi zgjedhjet lokale të nëntorit të 2009, intervistë tetor 2009. Kundërshtarët e akuzuan PDK-në se ishte e interesuar në një pjesëmarrje të ulët, çka do të rriste peshën e bazës prej 190 000 – 200 000 votuesish: Blerim Shala, “Raporti i harruar dhe zgjedhjet e degraduara”, *Koha Ditore*, 27 tetor 2009.



intelektual kanë dështuar të ndryshojnë kulturën që ekziston brenda partisë dhe kanë hasur në vështirësi. Profesori i filozofisë Astrit Salihu, i priu një fushate të kushtueshme dhe të vrazhdë për postin e kryetarit të komunës të Prishtinës, por arriti të marrë vetëm një rezultat poshtërues prej 10% në votimet e nëntorit 2009, duke dështuar madje të marrë edhe votën e shumë mbështetësve tradicionalë të PDK-së. Studiuesi i shkencave politike, Enver Hoxhaj, që u bë ministër i arsimit ka përfunduar duke shërbyer si fasadë për manipulime të pambrojtshme tenderash publikë prej miliona eurosh.<sup>73</sup>

Përgjigja e PDK-së ndaj kësaj dileme ka konsistuar pjesërisht në përpjekjen e kryesisë së saj për të dominuar institucionet, për të kontrolluar RTK-në, për të investuar në media që janë miqësore ndaj PDK-së dhe në komentatorë mediatikë besnikë – çka LDK dështoi ta bënte gjatë periudhës kur ajo ishte partia kryesore<sup>74</sup>. Një tjetër strategji e kryesisë së partisë ishte që ta vendoste vetveten në majë të pemës së ekonomisë së Kosovës, të grumbullonte para dhe influencë dhe madje të merrte kontrollin mbi kompanitë dhe forcën punëtore për të siguruar mbështetjen në të ardhmen. Përgjigja u gjet pjesërisht tek intimidimi dhe nënshtrimi: qoftë kur kjo i aplikohet SHIK-ut, i cili ndonëse zyrtarisht është shpërndarë përfaqësohet tanimë në qeveri, apo të fortëve në provincë që drejtojnë komunat e drejtuara nga PDK, si Skënderaj, Kaçanik e Viti, dhe figurave të rëndësishme të qeverisë qendrore apo vartësve të tyre.

Lidhja e kryesisë së PDK-së me SHIK-un, një strukturë e fuqishme dhe e pakontrollueshme sigurie që dyshohet për një seri vrasjesh politike në të kaluarën,<sup>75</sup> është tejet kontroverze. Disa

<sup>73</sup> Synimi i Ministrisë së Arsimit për të dhënë një kontratë për pajisjen me kompjuterë dhe internet të shkollave të Kosovës, me një vlerë prej 24 milion eurosh më shumë se ç'ishte e nevojshme, u zbulua nga një seri artikujsh të Besnik Krasniqit, *Koha Ditore*, 16-19 dhjetor 2009. As përgjigjet me shkrim të ministrisë dhe as vetë ministri Hoxhaj, në një takim me NRDNJ në 19 dhjetor 2009, nuk iu përgjigjën në mënyrë adekuate fakteve dhe analizës së botuar në gazetë. Në një takim të mëvonshëm ministri tha thjesht që të gjithë artikujt ishin "gënjeshtër".

<sup>74</sup> "Cilido punjonjës i medias i cili ka xhip të zi, shtëpi të re të madhe dhe i cili shkon në pushime të shtrejta jasht shtetit nuk ka gjasa të jetë i pavarur dhe pa paragjykime", Intervistë, redaktor, maj 2010.

<sup>75</sup> Nga 1998 deri në 2002, periudha e armiqësisë maksimale mes forcave politike "civile" dhe të "luftës" u vranë disa figura të rëndësishme të LDK-së. EULEX filloi një hetim të gjerë të aktiviteve

thonë se ky fakt e dallon PDK-në nga partitë e tjera.<sup>76</sup> Një organizatë sigurie rivale që ishte prapa LDK-së për një kohë në mesin e viteve 2000 është shpërbërë.<sup>77</sup> Gjatë dekadës së fundit SHIK-u ka përgjuar dhe infiltruar institucionet dhe bizneset e Kosovës duke marrë financime nga burime jozyrtare. Vetëm PDK e sheh veprimtarinë e SHIK-ut si legjitime, për shkak të statusit që kishte në qeverinë e përkohshme – edhe pse ajo qeveri asnjëherë nuk mori një mandat popullor dhe u shpërbë në vitin 2000, duke e lënë SHIK-un më pas pa ndonjë lidhje apo mbikëqyrje institucionale – dhe për shkak të faktit që UNMIK-u nuk e mbylli atë.<sup>78</sup> Ndonëse SHIK-u lajmëroi se do të shkrihej disa muaj pasi PDK mori pushtetin në fillim të vitit 2008, personeli i tij u caktua përmes institucioneve kyçe dhe përmes qeverisë në nivele zëvendësministrash (ndërkohë që zhvillimi i agjencisë zyrtare të inteligjencës së Kosovës ka mbetur i paralizuar<sup>79</sup>). Këta, dhe shefat e lartë të SHIK-ut – që zyrtarisht kanë mbetur jashtë qeverisë – kanë një influencë shumë të madhe.

## Kufizimi i raportimit

Dekada e drejtimit nga UNMIK-u e ristrukturoi në mënyrë të qenësishme median kosovare, duke krijuar hapësira për projektimin e vlerave liberale, por duke e vënë atë njëkohësisht nën presion për të marrë përsipër përgjegjësinë për ruajtjen e stabilitetit shoqëror. U themeluan tri stacione televizive kombëtare: RTK e mbështetur nga Unioni i Transmetuesve Europianë, EBU, që zëvendësoi transmetuesin shtetëror RTP, që ishte

---

të kësaj strukture pas rrëfimit të nëntorit 2009 të Nazim Bllacës mbi disa vrasje të kryera në rolin e tij të pretenduar si pjesëtar i një skuadre ekzekutimesh të SHIK-ut. Një ish zyrtar i rangut të mesëm i SHIK-ut sugjeroi se organizata kishte kryer disa prej vrasjeve të periudhës së 1998 – 2002, ku përfshiheshin vrasjet e Rexhep Lucit, Xhemajl Mustafës dhe Bekim Kastratit, intervistë, shkurt 2010.

<sup>76</sup> Në një polemikë, publicisti dhe ish politikani Veton Surroi argumentoi se binjakëzimi PDK-SHIK e bën të parën të jetë vartëse e të dytës, duke penguar maturimin e saj në një forcë politike evropiane dhe duke e bërë kontrollin e bizneseve, privatizimit, medias dhe lidhjet me krimin e organizuar *raison d'être* të kryesisë së saj. Seria e artikujve: "E ardhmja e paqartë evropiane e Kosovës", *Koha Ditore*, 13-20 janar 2010, kryesisht: "Shteti i SHIK-ut" dhe "PDK-ja pa SHIK-un, LDK pa Rugoven", 16 - 17 janar 2010.

<sup>77</sup> Shih Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Raporti për Evropën Nr. 163, *Kosova pas Haradinajt*, 26 maj 2005.

<sup>78</sup> Zija Miftari, "SHIK legal vetëm për PDK-në", *Koha Ditore*, 17 qershor 2008.

<sup>79</sup> Shih: Arben Atashi, "Sejdiu e Thaçi 'e harrojnë' shërbimin sekret shtetëror", *Koha Ditore*, 22 qershor 2009.

marrë nën kontroll nga Millosheviçi në 1990, ndërkohë që grupet mediatike KTV dhe RTV21 që preferoheshin nga USAID-i u shfaqën gjatë viteve '90 si grupe mediatike që mbështeteshin nga donatorët.

Gazetat me prirje liberale, *Koha Ditore*, *Kosova Sot*, *Zëri*, *Express* u bënë gazetatat kryesore edhe pse me një tirazh total ditor prej vetëm 30 000 kopjesh penetrimi i tyre mbeti i ulët. Kishte po ashtu edhe gazeta partiake, jo liberale dhe partizane si *Bota Sot* (pro-LDK) dhe *Epoka e Re* (pro-PDK). Sidoqoftë, në vitin 2000 UNMIK-u e ndaloi gazetën *Dita* të lidhur me PDK, pasi denoncimi i një serbi nga ana e saj çoi në vrasjen e tij, dhe kërcënimet me vdekje të lëshuara nga agjencia *Kosovapress* e UÇK-së kundër pronarit të KTV dhe *Koha Ditore* Veton Surroi në vjeshtën e 1999 u bënë të papranueshme dhe nuk u përsëritën më në kohën e UNMIK-ut.

Por, UNMIKU nuk u ofroi shumë mbrojtje gazetarëve. Dy gazetarë të *Bota Sot* u vranë në 2001 dhe 2005 – këto vrasje mbeten të pazgjidhura. Hetimi i UNMIK-ut dhe Shërbimit Policor të Kosovës, SHPK, në lidhje me plagosjen me armë të gazetarës investigative të *Kohës Ditore* Fatmire Tërdevci dhe kërcënimet e mëtejshme, qe i papërfillshëm. Për më tepër, UNMIK-u as nuk i sfidoi tabutë që e bënin UÇK-në të paprekshme dhe deri vonë bëri që zërat e vërtetë të serbëve të mos merrnin mbulim televiziv. Ai ia delegoi një pjesë të madhe të fajit për pogromin e marsit 2004 mbulimit historik të medias, duke instaluar që prej atij momenti në median kosovare (sidomos tek RTK) ndjenjën e kryerjes së “mëkatit fillestar”, çka i influencoi ato kështu që në radhë të parë të merrnin parasysh rrezikun që çdo storie apo mbulim mediatik mund të krijonte trazira të ngjashme.

Mjaft më vonë, duke filluar përafërsisht që prej 2006, debati në televizion u bë më i gjallë, më i lirë dhe përfshinte një përfaqësim më të madh të serbëve. Kujdestarët që shqetësoheshin vetëm për stabilitetin dhe që e shihnin Kosovën si njëdimensionale mbetën prapa mediave dhe publikut të tyre që po pjekeshin – reklamata televizive të KFOR-it filluan të bëhen të bezdisshme, zyra/ambasada e SHBA u përpoq të censuronte disa nga programet më të

respektueshme të RTK-së.<sup>80</sup> Teksa Kosova përparonte drejt pavarësisë së saj të kontestuar, që prej zgjedhjeve të 2007, presionet mbi median dhe kritikët e tjerë për të marrë parasysh efektin që do të kishte mbulimi i tyre tek imazhi ndërkombëtar i shtetit të ri e të brishtë iu shtuan shqetësimeve mbi stabilitetin shoqëror. Këto presione nuk reshtën pas pavarësisë, por vetëm sa filluan të përsëriten në forma të tjera: aktualisht paraqiten si një domosdoshmëri për të mos kompromentuar imazhin e vendit deri sa Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të ketë dhënë opinionin e saj këshillues në lidhje me legjitimitetin e deklarimit të pavarësisë nga Kosovës: çka pritet të ndodhë në gjysmën e dytë të 2010.

Sidoqoftë në arenën mediatike ka pasur ndryshime: kanali kombëtar kabllor i ri dhe energjik Klan Kosova favorizonte PDK-në,<sup>81</sup> siç bënte dhe gazeta *Express* (pronë e kompanisë së telekomunikacionit IPKO) dhe një tabloid militant pro-PDK – *Infopress* – të sillte ndërmend *Ditën* duke botuar lista të serbëve që pretendonte se

<sup>80</sup> Në tetor 2008 u përpoq të ndalonte një debat në komunën e Deçanit që organizohej nga programi javor, i prodhuar në mënyrë të pavarur, *Jeta në Kosovë*; një ndër programet në një seri që mbulonte qeverisjen lokale në të gjitha komunat: ambasada nuk i kishte bërë detyrat e shtëpisë në lidhje me *Jeta në Kosovë* dhe i frikësohej gabimisht faktit se mos debati do të kanalizonte ndjenjat armiqësore drejt manastirit serb në Deçan. Muajin që pasoi ajo kërkoi që aktivisti radikal Albin Kurti, i paditur sepse kishte udhëhequr një protestë në të cilën policët rumunë të UNMIK-ut vranë dy prej demonstruesve të tij, të largoheshin nga paneli i *Jeta në Kosovë* që po debatonte në lidhje me “planin gjashtë pikësh” për qeverisjen në kompromis me Beogradin në zonat e banuara nga serbët, çka ishte pritur keq nga shqiptarët e Kosovës. Të dy debatet u shfaqën ashtu siç ishte planifikuar.

<sup>81</sup> Programi i kanalit karakterizohet me shumë debate mbi çështje aktuale, të cilët kanë tendencë të dominohen nga komentatorët pro PDK të cilët janë panelist të rregullt. Drejtori i Klan Kosovës, Baton Haxhiu e mohon këtë (dhe ka inicuar një seri të artikujsh fyes në *Express* duke e sulmuar autorin e këtij raporti, gjithashtu ai ka dorëzuar padinë në Gjykatën Ekonomike të Prishtinës për dëm të 285.000 eurove të shkaktuar kështu nga raporti i NRDNJ-së, padi kjo të cilën gjykata e hedh poshtë) dhe citoi një mosmarrëveshje gjatë fushatës për zgjedhje lokale në 2009 kur PDK përkohësisht bojkotoi debatet e televizionit dhe tërhoqi reklamata. Intervistë, 27 maj 2010. Mirëpo, vet redaktorët e Haxhiut e pranojnë pro PDK anëshmërinë e debateve. Njëri i tha NRDNJ-së që debatet komentuese të të mbrëmjes gjate fushatës për zgjedhje lokale kanë anuar rëndë në favor të PDK-së. Intervistë, dhjetor 2009. Një redaktor tjetër i Klan Kosovës, në mënyrë të besueshme është raportuar të ketë thënë me 27 maj që favorizimi pro-PDK në debatet e televizionit është aq i qartë sa që “po shihet prej aeroplanit”. Intervistë, 27 maj 2010. Megjithatë, programi i lajmeve të Klan Kosovës nuk duket i njëanshëm, duken të liruara nga tabutë dhe kanë sjell qasje të freskët, duke i paraqitur fushat e jetës në Kosovë të cilat nuk janë mbuluar mirë më herët p.sh. dhuna e tifozëve në lojat e futbollit dhe basketbollit. Raportet e tyre në mitingjet e organizuara nga të gjitha partitë në fushatat për zgjedhjet e fundit lokale ishin vëzhguar me intezitet, satirike dhe zbavitëse, duke ofruar në mënyrë efektive një pamje “përhapshme”.

kishin qenë pjesëtarë të njësisve paramilitare. Pronari i *Zërit* iu bashkua AAK-së dhe ia shiti gazetën një biznesmeni i cili e rigjallëroi, duke marrë në punë gazetarë të mirë dhe të paktën deri më tani, duke mos ndërhyrë në punën e tyre. Televizioni Rrokum u bë një stacion popullor me komente të drejtpërdrejta nga qytetarët, me analiza të ashpra, dhe me deklamimet e pronarit të tij kundër gazetarëve të tjerë,<sup>82</sup> duke fituar kështu mospëlqimin e kryeministrit Thaçi<sup>83</sup> dhe në prill 2009 ky stacion u hoq nga rrjeti kabllor i IPKO-s.<sup>84</sup>

RTK ende ka shikueshmërinë më të lartë dhe qeveria e re, që prej krijimit të saj në janar 2008 ushtroi presion për të fituar një mbulim të privilegjuar. Në prill 2009, bordi i RTK-së, një mbetje nga koha e UNMIK-ut që përfshinte anëtarë ndërkombëtarë, reagoi ndaj kësaj tendence drejt një raportimi të hapur pro-qeveritar në mbulimin e lajmeve duke pushuar redaktorin e lajmeve që ishte vendosur në fund të 2008. Presioni mbi menaxhimin dhe bordin e RTK-së erdhi duke u shtuar.<sup>85</sup> Qeveria mbikëqyri emërimin e një bordi të ri, të përbërë krejtësisht nga vendas. Redaktori i lajmeve, Mentor Shala që ishte pushuar nga puna u rikthye në shtator 2009 dhe reporterët që nuk ishin të të njëjtit mendim u larguan nga dhoma e lajmeve. Drejtori i RTK-së kërkoi ndihmë nga zyra e ICR, por dha dorëheqje pasi memorandumi i brendshëm i takimit të tyre iu dha shtypit.<sup>86</sup> Teksa afroheshin zgjedhjet lokale të

nëntorit 2009, baza e financimit të pavarur të RTK-së u gjymtua: në rastin e parë, Gjykata Kushtetuese vendosi që mbledhja e taksës së televizionit përmes faturave të rrymës ishte antikushtetuese, ndërsa Komisioni i Pavarur i Medias i ndaloi RTK-së që të transmetonte reklama në kohën e mbrëmjes me shikueshmërinë më të madhe. Kuvendi u ofrua si shpëtimtar, duke e rifitur financimin e RTK-së në buxhetin e shtetit. Unioni i Transmetuesve Europianë, EBU, protestoi tek kryeministri për sulmin kundër pavarësisë së RTK-së.<sup>87</sup> Megjithatë, në janar 2010, si pasojë e udhëzimeve politike thuajse të hapura bordi i ri emëroi si drejtor të RTK-së menaxherin që mbikëqyri censurimin e RTK-së gjatë 2009<sup>88</sup> dhe Mentor Shalën në pozitën e zëvendës drejtorit të dytë.

Shpërndarja partiake e reklamave qeveritare dhe të atyre të sektorit publik ka filluar të ketë një impakt tek mediat private. Këto reklama përbëjnë burimin më të madh të të ardhurave për shumicën e stacioneve televizive dhe gazetave (duke qenë se numri i lexuesve është aq i ulët). Për disa muaj, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, PTK, që është pronë publike, e përjashtoi Grupin Koha: KTV dhe *Koha Ditore*, nga reklamat e saj fitimprurëse pasi kjo e fundit kritikoi praktikën e PTK-së në 2009. Gazeta të tjera si *Zëri*, *Lajm* dhe *Express* mbahen me subvencionet e bizneseve që i kanë në pronësi. Ndonëse *Kosova Sot* vjen e dyta me një distancë jo shumë të madhe, *Koha Ditore* mbetet gazeta më e lexuar,<sup>89</sup> por reklamat qeveritare mbahen larg kësaj gazete kritike ndaj veprimeve të qeverisë dhe u jepen gazetave me

<sup>82</sup> Disa prej këtyre shkojnë shumë larg asaj çka është e pranueshme: në mars 2010, në një telefonatë në lidhje me shtëpinë e madhe që po ndërton kryeministri Thaçi në lagjen Ajvalia të Prishtinës (një gazetë ka vlerësuar që madhësia e saj është 2000 m<sup>2</sup>, ndërkohë Kryeministri ka deklaruar që është “vetëm 800m<sup>2</sup>”) një shikues propozoi që Thaçi dhe njerëzit e tij duheshin vlarë: prezantuesit e programit e lanë të kalonte këtë dhe nuk u distancuan prej kësaj. Monologët televizivë të pronarit të Rrokum-it Migjen Kelmendi shpesh degjenerojnë në fyerje degraduese për gazetarët që nuk i pëlqejnë atij.

<sup>83</sup> Kryeministri Thaçi e kaloi kohën në një koktej të organizuar nga Fondacioni Vëllezërit Rockefeller në Universitetin Amerikan të Kosovës duke paralajmëruar pronarin e Rrokum Migjen Kelmendi, duke i kërkuar që të hiqte dorë nga telefonatat nga publiku. Vëzhgim i NRDNJ dhe intervistë, Migjen Kelmendi, tetor 2008.

<sup>84</sup> Në 1 prill 2009, duke shkelur kontratën. Rrokum shfaqet ende nga operatori kabllor rival Kujtesa.

<sup>85</sup> Intervista, RTK menaxhmenti, anëtar i bordit, shtator 2009. U dërguan kërcënime anonime me mesazhe telefonike dhe një vëzhgues komentoi për menaxherët e RTK: “Nuk kam parë kurrë njerëz kaq të frikësuar; edhe në kohën e Millosheviçit u ruajt një farë dinjiteti, kurse këta ishin si fëmijë që u kanë bërë titur”.

<sup>86</sup> Petrit Çollaku, “Hetim mbi rrjedhjen që detyroi shkuarjen e drejtorit të televizionit”, [“Probe into Leak That Forced Out Kosovo TV Chief”], *Balkan Insight*, 1 tetor 2009.

<sup>87</sup> Letra e Drejtorit të Përgjithshëm të EBU e 26 tetorit 2009 e akuzonte kryeministrin Thaçi se po e transformonte RTK “në një krah mediatik të partisë në pushtet”. Shih:

[http://www.ebu.ch/en/union/news/2009/tcm\\_6-66520.php](http://www.ebu.ch/en/union/news/2009/tcm_6-66520.php). Thaçi u përgjigj se ky ishte një “skenar i ekzagjeruar”. Petrit Çollaku, “Thaçi thotë që nuk ka presion politik në RTK” [“Thaçi Says No Political Pressure on RTK”], *Balkan Insight*, 30 tetor 2009. Shih: <http://www.balkaninsight.com/en/main/news/23312/>.

<sup>88</sup> Gjatë 2009, Sylejman Shaqiri ndaloi raportimin e një konference për shtyp të dhënë nga kreu i AAK Ramush Haradinaj në lidhje me aktivitetet e vëllait të kryeministrit Thaçi në shoqatën e kompanive të sigurimit dhe i urdhëroi reporterët që mbuluan emërimin e Enver Hasanit si President të Gjykatës Kushtetuese të mos përmendnin një rast në të cilin Hasani akuzohet të ketë dërguar një mesazh me fjalë të ndyra një akademiku. Intervistë, gazetar i RTK, shkurt 2010. Në tetor 2009 Shaqiri u përpoq të ndalonte debatet zgjedhore komunale të *Jeta në Kosovë* duke i paraprirë dëshirave të qeverisë.

<sup>89</sup> Sipas raportit të OSBE “Qarkullimi dhe Politizimi i Medias së Shtypur në Kosovë”, mars 2010, *Koha Ditore* tërheq 38% të lexuesve shqiptarë në Kosovë dhe *Infopress* 4%.

lexues të paktë, por që janë në pronësi të mbështetësve të qeverisë: *Infopress* dhe *Tribuna Shqiptare*.<sup>90</sup> Pavarësisht angazhimit aktiv të *Koha Ditore* dhe deri në njëfarë mase të *Zërit* në hetimin e korrupsionit, Agjencia Anti Korrupsion zbuloi se numri i artikujve mbi korrupsionin në tërësi ka rënë nga 165 në 2008 në rreth gjysmën e kësaj në 2009 dhe sipas mendimit të kësaj agjencie kjo erdhi si pasojë e ndikimit të pronarëve dhe reklamuesve.<sup>91</sup>

Me besimin që mori nga arritja e pavarësisë, me mbështetjen e fortë amerikane, dominimin e skenës politike nga PDK, me programin energjik të ndërtimit të shkollave dhe rrugëve, në 2008 qeveria i kishte punët fjollë dhe i kishte çarmatosur kritikët e saj potencialë.<sup>92</sup> Në 2009, teksa evidenca e mashtrimeve dhe korrupsionit filloi të shtohet dhe rrymat e pakënaqësive filluan të bëhen më të forta, qeveria filloi të kishte më shumë oreks për një kontroll më të madh dhe për të ndikuar axhendën e lajmeve. Ndikimi tek RTK i garantoj kryeministrit një mbulim prioritar në programet e përditshme të lajmeve.<sup>93</sup> Kosova paraqitet sikur ka një perspektivë të 'kopshtit me lule' në lidhje me hyrjen në BE: raportimet e kritikave të ashpra mbi qeverisjen në Kosovë që përmbante Raporti i Progresit i BE-së i tetorit 2009 u kufizuan. Që kur korespondenti i RTK-së në Bruksel dha një vlerësim të sinqertë për sa u përket konstatimeve të BE-së në një lidhje të drejtëpërdrejtë, raportimet e saja televizive janë bërë më të rralla dhe regjistruhen paraprakisht.

Këto masa shtrënguese u përplasën me bastionet e gazetarisë dhe shoqërisë civile që po tregojnë një guxim dhe vendosmëri të re në bërjen e hetimeve, kritikave dhe sqarimeve.<sup>94</sup> Përplasja më famëkeqe

<sup>90</sup> Një studim i zhvilluar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) mes 30 majit dhe 25 qershorit 2009 llogariti totalin e faqeve të reklamave nga institucionet publike në disa gazeta të përditshme. *Koha Ditore* kishte 72 faqe, *Infopress* 293 faqe.

<sup>91</sup> Intervistë, Hasan Preteni, Drejtori Agjencisë Kundër Korrupsionit, 15 dhjetor 2009.

<sup>92</sup> Kur ishte në opozitë PDK u përpoq të mbështeste kauzën e medias: "Kështu, në një fare mënyre, media u ndje sikur edhe ajo po vinte në pushtet në 2007. Si pasojë e kësaj, qeveria nuk po përballlet me ndonjë rezistencë", tha redaktori i lajmeve i KTV Adriatik Kelmendi, intervistë 26 qershor 2009.

<sup>93</sup> Intervistë, ish redaktor i lajmeve të RTK, 9 shkurt 2010.

<sup>94</sup> Një pjesë e kësaj përplasjeje ishte e dukshme brenda vetë RTK-së në prag të rivotimit për zgjedhjet lokale në 12 dhjetor 2009, programi i debateve i prodhuar në mënyrë të pavarur, *Jeta në Kosovë* diskutoi mbi pavarësinë e RTK-së. Dhoma e lajmeve pro-qeveritare i parapriu

mes masave të shtrëngimit të kontrollit dhe gazetarëve që përpiqen t'i rrëzojnë këto kufij ndodhi kur *Jeta në Kosovë* transmetoi një emision special prej dy orësh në lidhje me problemet me lirinë e shprehjes në fund të majit 2009. Deri në qershor, *Infopress* ndërmori një fushatë të vazhdueshme abuzimesh që përmbanin akuza se producentët e programit ishin agjentë serbë, duke bërë thirrje për dhunë kundër tyre, që kulmuan në atë që dukej si kërcënim me vdekje.<sup>95</sup> Pas 12 ditësh të kësaj fushate, presioni ndërkombëtar e detyroi gazetën dhe qeverinë që të tërhiqeshin,<sup>96</sup> por fushata shënoi një nivel të ri intimidimi.

Ajo dëmtoi po ashtu edhe imazhin ndërkombëtar të Kosovës dhe qeverisë së saj, duke mobilizuar organizatat e të drejtave të njeriut, duke u bërë shkas për një artikull në *The Economist*, dhe duke e futur çështjen e lirisë së shprehjes në axhendën e Grupit Ndërkombëtar Drejtues (organi prej 25 vendesh që mbikëqyr ICR).

Në përgjithësi qeveria ka preferuar që t'i çarmatosë kritikët e saj pa bërë zhurmë. Përdoret praktika e "policit të mirë dhe policit të keq" sipas së cilës disa aktorë nga kampi qeveritar u ofrojnë kritikëve mbrojtje nga zemërimi i figurave apo grupeve të tjerë qeveritarë dhe i nxisin kritikët që t'i ndihmojnë në këto përpjekje duke "ndejtur urtë".<sup>97</sup> Ministrinë dhe ndërmarrjet publike ofrojnë

---

dhe e pasoi këtë debat me një raport ku argumentonte se mbulimi i zgjedhjeve nga ana e RTK kishte qenë rreptësisht i balancuar. Programuesit e RTK-së, që s'ishin dakord me këtë, e pasuan buletinin e fundit të lajmeve me tri ritransmetime të njëpasnjëshme të debatit përgjatë gjithë natës.

<sup>95</sup> "Jeta ia bëri vetes që të mos ketë jetë të gjatë", Rizah Hajdari, "Katër tradhütë e Jetës", *Infopress*, 4 qershor 2009. Një prokuror refuzoi të vepronte kundër gazetës duke argumentuar se kjo frazë dhe disa thirrje të tjera që të "dënonin" Xharrën ishin të paqarta. Po ashtu, në nëntor 2009, kërcënimin me vdekje që u bëri një gjykatës dy gazetarëve të *Koha Ditore* që kishin sugjeruar se ai ishte i korruptuar, nuk u konsiderua si shumë serioz dhe çështja iu kalua në gjykatë për kundërvajtje në Prishtinë.

<sup>96</sup> Në 10 qershor 2009 qeveria lëshoi një deklaratë për shtyp që thoshte në terma të përgjithshme se respektonte lirinë e medias. Më pas, *Infopress* pretendoi se fraza: "Jeta ia bëri vetes që të mos ketë jetë të gjatë" nuk ishte një kërcënim me vdekje. Fushata e *Infopress* ndaloi pasi një zëvendës-ministër i shqetësuar i PDK-së arriti më në fund të bindte ambasadën amerikane që t'i ndihmonte; kjo sollti një ndërhyrje tek redaktori Rexhep Hoti nga ana e ish kreut të SHIK-ut Kadri Veseli, pas të cilës zëvendës-ministri dhe Veseli shkuan personalisht tek zyrat e gazetës natën vonë për të mbikëqyrur heqjen e sulmeve të ditës tjetër.

<sup>97</sup> Intervistë, Ilir Deda, drejtor i institutit kërkimor KIPRED, 16 prill 2010.

vende pune për të blerë gazetarët investigativë;<sup>98</sup> dy ish punonjës të lartë të institutit kërkimor KIPRED u shpërblyen me poste ambasadorësh. Ushtrohen presione edhe kundër palëve të treta: burimet e informacionit të gazetarëve intimidohen ose të afërmit e tyre kërcënohen me humbjen e vendit të punës.<sup>99</sup> Gjatë intervistave të bëra për këtë raport u përmendën kërcënime anonime, qoftë me telefonata, mesazhe telefonike apo, në rastin e një kritiku, në formën e vrimave të plumbave në makinën e tij.<sup>100</sup> U përmendën po ashtu kërcënime të drejtpërdrejta ose intimidime nga zyrtarët, këshilltarët politikë të ministrave apo dhe nga vetë ministrat. Nëse këto kërcënime nuk janë të regjistruara, apo nuk kanë dëshmitarë të tjerë, zakonisht është fjala e gazetarit kundër fjalës së zyrtarëve, por një numër i madh gazetarësh raportojnë eksperiencën të ngjashme dhe flasin për kërcënime si:

“A e di se çfarë ke shkruar? A e di që ke fëmijë? A e di se çfarë mund të të ndodhë?”<sup>101</sup>

“Nëse përpiqesh të raportosh kështu në të ardhmen ke kujdes sepse unë kam më shumë pushtet se ti. Mund të bëj një dosje për ty që të thotë se t’i ke shkelur rregullat. Mund të botoj gjëra kundër teje në gazeta. Pastaj e shohim sesi do të merresh me opinionin publik”. Gazetari u përgjigj “Nëse ke argumente”, por zyrtari i tha “Nuk është punë argumentesh, është punë pushteti.”<sup>102</sup>

“Ne e dimë saktësisht sesi e ke marrë këtë informacion; kemi regjistrime të bisedave

të tua; të kemi vëzhguar dhe e dimë se po bën punën e një agjencie të inteligjencës. Mos mendo se mund të na hetosh ne dhe se ne nuk mund të të hetojmë ty.”<sup>103</sup>

Kryeministri ka shkuar edhe më larg se paraardhësit e tij në përpjekjet për të mikromenaxhuar mbulimin e tij mediatic, duke u bërë telefonata e duke u dërguar mesazhe redaktorëve – duke përmendur emrat e gazetarëve që do të donte që të merrnin në punë apo të pushonin nga puna,<sup>104</sup> dhe provoi të intimidon një institut kërkimor ndërkombëtar. Ai iu drejtua një redaktori në këtë mënyrë: “Ti je përgjegjës për të gjitha storiet idiote e të zeza për mua? ...Mos harro që jam më i fortë se ti.”<sup>105</sup> Disa shohin kërcënimet e Kryeministrit në tetor 2008 ndaj drejtorit për Kosovën të Grupit Ndërkombëtar i Krizave që e kryente mandatin, duke kërkuar nga ai të linte vendin ose të përballej me pasoja, si një përpjekje për të penguar organizatën nga raportimi i mëtejshëm mbi “punët e brendshme” të Kosovës.<sup>106</sup> Megjithatë, hulumtimet e tyre vazhduan.<sup>107</sup>

Duke bërë që ta kenë frikë, dhe pasi zbuloi se mund të dilte pa i hyrë gjemb në këmbë nga fushatat e abuzimeve dhe kërcënimeve të shfrenuara, *Infopress* është bërë më e rëndësishme – ajo ka marrë vetëm një gjobë prej 1000 eurosh ndërkohë që ka vazhduar të marrë pjesën më të madhe të reklamave të qeverisë dhe në prill 2010 PDK i dha redaktuesit të saj Rexhep Hoti një vend

<sup>98</sup> Intervista: Salie Gajtani Osmankaq, gazetarë *Koha Ditore*, 22 dhjetor 2009, Fatos Halili, gazetar BIRN, dhjetor 2009. Hulumtuesit për debatin e *Jeta në Kosovë* mbi privatizimin e aeroportit zbuluan se shumë të afërm të gazetarëve janë punësuar tashmë aty: intervistë, Jeta Xharra, 26 prill 2010.

<sup>99</sup> Intervistë, Salie Gajtani Osmankaq, op. Cit. Një zyrtar nga një instituti kërkimor ekonomik i Kosovës i kërkoi asaj që të mos e kontaktonte më shefin e saj, sepse ai kishte humbur disa kontrata nga që kishte folur me të më parë; një zyrtar i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave e takoi atë dhe burrin e saj në rrugë pasi ajo kishte botuar një artikull mbi parregullsitë në buxhet dhe i tha për burrin: “Nëse vazhdon ke për t’i bërë atij më shumë dëm sesa vetes”. Burri i saj është ekonomist që ka punuar në projekte qeveritare të financuara nga agjenci multilaterale. Që prej asaj kohe ai e ka pasur të pamundur të gjejë punë.

<sup>100</sup> Intervistë, 18 nëntor 2009.

<sup>101</sup> Intervistë, gazetar i *Lajm*, 16 qershor 2009.

<sup>102</sup> Intervistë, gazetar i KTV, 9 qershor 2009.

<sup>103</sup> Intervistë, gazetar i BIRN, prill 2010.

<sup>104</sup> Intervistë, RTK menaxhmenti dhe gazetarët e RTK-së, tetor 2009, shkurt dhe prill 2010.

<sup>105</sup> Intervistë, gazetar i RTK, 9 shkurt 2010.

<sup>106</sup> Në një takim ku morën pjesë tre pjesëtarë të stafit të Grupit i Krizave, që kishte për qëllim të prezantonte drejtorin e ri në 10 tetor 2008. Ish drejtori, për periudhën nga 2003 në 2008, Alex Anderson është autori i këtij raporti. Kryeministri e kërcënoi se do t’ia bënte jetën shumë të parehatshme nëse qëndronte dhe madje se do ta fuste në burg për krime të paspecifikuara. Kur iu kërkua llogari, Thaçi bëri një kërkim falje të kufizuar që ia kishin sugjeruar diplomatët e Kuintit në Prishtinë, e cila nuk përmendte abuzimet dhe kërcënimet që ai kishte përdorur apo kujt ia kishte drejtuar ato. Për këtë arsye, Grupi Ndërkombëtar i Krizave ia adresoi kryeministrit shqetësimet e tij për sigurinë e Andersonit si dhe mbrojtjen që i ofronin atij, dhe u dërgoi një kopje të letrës ministrave të jashtëm të Kuintit, udhëheqësve institucionale të BE dhe NATO, duke e përforcuar edhe më tej mesazhin me vizitën e një drejtuesi të lartë të Grupit në Prishtinë në mars të 2010.

<sup>107</sup> Shih Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Raporti për Evropën Nr.204, “Sundimi i ligjit në Kosovën e pavarur”, 19 maj 2010. apo: [www.crisisgroup.org](http://www.crisisgroup.org).

në kuvend.<sup>108</sup> Sulmet e saj kundër *Jeta në Kosovë* nuk u urdhëruan detyrimisht nga kryesia e PDK-së, por ato ishin padyshim një karakteristikë e shpirtit ndërmarrës të botuesit të saj, i cili shfrytëzoi hapësirat dhe rivalitetet mes aktorëve kryesorë të PDK dhe emocionet që ngjallte në favor të UÇK-së dhe Drenicës, bastionit të PDK-së, duke pretenduar se programi po shpifte kundër tyre. Sidoqoftë, idetë që hodhi në treg *Infopress* me fushatën e saj, sipas së cilave ajo po luftonte kundër mercenarëve të pabesë në emër të një gazetarie kombëtare dhe të vlerave të pastra, pasi u hodhën në qarkullim bënë një progres të shpejtë në muajt në vijim duke kaluar nga skajet radikale drejt influencimit të qasjes zyrtare të qeverisë ndaj kritikëve të saj.<sup>109</sup>

Në qershor 2009 RTK më së pari i dha kohë televizive kolumnistit të *Infopress* Qani Mehmedi për të dënuar “median e UNMIK-ut” kozmopolitane dhe të financuar nga donatorët dhe propozoi që të lejoheshin vetëm mediat me financim kombëtar,<sup>110</sup> e më pas, në dhjetor 2009, shfaqti botuesin e *Infopress* Rexhep Hoti i cili e shtoi dhe më shumë dozën e akuzave duke i përshkruar mediat liberale si të krijuara nga të huajt dhe “pro-Jugosllave”. Ai i akuzoi ato se po e frynin në mënyrë të vullnetshme skandalin e Bllacës për të krijuar tensione, se ishin bashkëpunëtore të Beogradit në sulmet kundër udhëheqësve të UÇK-së dhe se po e vinin në vështirësi Kosovën përballë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.<sup>111</sup> Një pjesë e retorikës së qeverisë dhe të PDK-së për rastin e Bllacës i afrohej këtij këndvështrimi. Në mars 2010, qeveria dhe ekspertët që ajo i kishte aleatë po i quanin OJQ-të dhe gazetarët që kritikonin për korruptcion si “anti-shtetëror” dhe se po dëmtonin vendin e tyre në forumet ndërkombëtare.<sup>112</sup>

<sup>108</sup> I pyetur mbi qëndrimin e PDK-së dhe qeverisë ndaj *Infopress-it*, Zëvendës Kryeministri Hajredin Kuçi e kufizoi vetën duke deklaruar që çështja e *Infopress-it* nuk është diskutuar asnjëherë në ndonjë takim të kryesisë të PDK-së dhe që opinionet e *Infopress-it* nuk paraqesin opinionet e qeverisë. Intervistë, 20 maj 2010.

<sup>109</sup> Qani Mehmedi, “Kosovës i duhet gazetaria e Kosovës”, *Infopress*, 8 qershor 2009, dhe në programin e RTK-së *PaRrolla*, qershor 2009.

<sup>110</sup> *Ibid.*

<sup>111</sup> Intervistë në *Pro et Contra*, RTK, 2 dhjetor 2009. Ai sulmoi po ashtu dhe “bashkëpunëtorët” që bashkëpunuan me Gjykatën e Hagës.

<sup>112</sup> Zëdhënësi i Kryeministrit Memli Krasniqi dhe analisti Mufail Limani, *Zona e Debatit*, debat mbi lirinë e medias, televizioni Klan Kosova, mars 2010. Prej kritikëve të denoncuar vetëm Ilir Deda, drejtues i OJQ-së KIPRED është i vendosur në Kosovë. Fyerjet e qeverisë pasuan përshkrimin e qeverisë nga ana e tij si ‘një

Sidoqoftë zëvendës kryeministri Kuçi kërkoi ndjesë për këtë retorikë<sup>113</sup> dhe raportohet se një pjesëtar i stafit të kryeministrit ishte ngritur kundër përdorimit të saj në diskutimet e brendshme,<sup>114</sup> çka tregon se në qeveri nuk kishte një prirje monolite për një përshkallëzim të tillë dhe për një prishje totale të marrëdhënieve me shoqërinë civile.

Sidoqoftë, përkundrajt një atmosfere të përgjithshme keqtrajtimesh të gazetarëve nga zyrtarët<sup>115</sup> marrëdhëniet mes qeverisë dhe medias liberale dhe OJQ-ve kanë vazhduar të përkeqësohen.<sup>116</sup> Shtatëmbëdhjetë OJQ u bashkuan për të dënuar retorikën e “linçimit” nga ana e qeverisë.<sup>117</sup> Administrata Tatimore u dërgua për të bërë auditin e një numri të madh prej tyre.<sup>118</sup> Në prill 2010 Ministria e Administrimit Publik propozoi një ashpërsim të ri të ligjit mbi OJQ-të, duke përfshirë në të kriteret sipas të cilave shteti mund të çregjistrojë OJQ-të, mund t’u administrojë asetet dhe ta kufizojë punën e tyre vetëm në aktivitete që i sjellin përfitime publikut,

---

ndërmarrje e përbashkët kriminale” në *The Economist*, “Korrupsioni në Kosovë: koha për të hecur përpara”, [“Corruption in Kosovo: time to go straight”], 18 mars 2010.

[http://www.economist.com/world/europe/displayStory.cfm?story\\_id=15731392&source=hptextfeature](http://www.economist.com/world/europe/displayStory.cfm?story_id=15731392&source=hptextfeature). Memli Krasniqi arsyetoi që komentet e tij janë keq interpretuar nga media dhe OJQ-të. Shih Memli Krasniqi, “Hipokrizia e misionareve [a]politike”, *Koha Ditore*, 24 prill 2010.

<sup>113</sup> Në *Jeta në Kosovë*, RTK, 1 prill 2010.

<sup>114</sup> Një sociolog që punon në Zyrën e Kryeministrit thuhet se ka mbrojtur të drejtën e Dedës për të mos qenë dakord, duke cituar për habinë e kolegëve të tij rastin e Noam Chomsky në SHBA. Intervistë, Ilir Deda, Drejtor KIPRED-it, 16 prill 2010.

<sup>115</sup> Në 3 maj 2010 një roje sigurie e qeverisë sulmoi një gazetar të *Koha Ditore* i cili po priste në ndërtesën e qeverisë, duke e kërcënuar se do ta “çonte në bodrum.” “Dhuna ndaj gazetarëve”, *Koha Ditore*, 8 mars 2010. Me 6 qershor 2008 një roje e sigurisë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës kapi një kameraman të *Jeta në Kosovë* që po filmonte jashtë ndërtesës, e futi brenda dhe e rrahu. Kamera vazhdoi të filmonte gjatë tërë incidentit i cili u shfaq në lajmet e RTK-së. Në të dyja rastet përgjigja e Policisë së Kosovës ishte e ngjashme.

Gazetari i *Koha Ditore* u kërcënuar se do të arrestohej nëse ngrinte padi. Hetimi i policisë nuk rezultoi në padi kundër rojës së KGJK, por e klasifikoi ekipin e *Jeta në Kosovë* si të dyshuar për krimin e filmimit pa leje jashtë ndërtesës në të cilën u fut dhe u rrah kameramani i tyre.

<sup>116</sup> Një episod indikativ ishte bojkoti i gazetarëve ndaj zëdhënësit të kryeministrit, Memli Krasniqi pas mbledhjes së qeverisë në 22 prill 2010. Ata po protestonin për refuzimet e vazhdueshme të kryeministrit për t’iu përgjigjur pyetjeve të tyre.

<sup>117</sup> “Retorika linçuese e Qeverisë, kërcënim për demokracinë”, e paraqitur në një konferencë për shtyp në 2 prill 2010. Shih: <http://www.levizjafol.org/arkiva/28311010194616.html>

<sup>118</sup> Intervistë, Ilir Deda, Drejtor, KIPRED, 16 prill 2010.

për të cilat propozohet një përkufizim aq i limituar sa të jetë i pamundur për tu realizuar.<sup>119</sup>

## Nënshtrimi i shërbimit publik

Në një shtet të sapokrijuar shërbimi publik duhet të jetë një fushë që lejon një dozë idealizimi. Duhet të jetë një pikëtakim në të cilën njerëzit mund të ushtrojnë profesionalizmin e tyre për të mirën publike. Sa më e lartë të jetë shkalla në të cilën ndodhin këto, aq më e përshtatshme është klima për punonjësit individualë të shërbimit civil dhe publik që ata të veprojnë me ndërgjegjen dhe aftësitë e tyre më të mira, duke krijuar një rreth virtuoz drejt një vlerësimi më të madh për veten, një komunikimi më të lirë dhe një konsideratë më të lartë për shtetin.

Sidoqoftë, në Kosovë për shkak të mungesës së zhvillimit të sektorit privat, shërbimi civil dhe krahu i punës së ndërmarrjeve publike, që janë të dyja të tejfryra, dhe madje edhe vetë kuvendet komunale të zgjedhura me votë shihen si skema sigurimi, një strehë që garanton më së paku një rrogë sa për mbijetesë dhe, për disa, edhe një mundësi për të nxjerrë ndonjë fitim. Një hierarki që kërkon t'i shmanget përgjegjësisë, koaleshenca mes rrjeteve të klientëve dhe patronëve si dhe punësimet e pushimet nga puna arbitrare e dobësojnë këtë ideal të etosit të sektorit publik.

Njerëzit kanë filluar të kenë frikë se mund të humbasin vendin e tyre të punës nëse nuk janë anëtarë të njëjës prej partive që qeverisin në nivel qendror apo lokal.<sup>120</sup> Prandaj, “servilizmi” “konformizmi” dhe “heshtja” janë cilësitë që tanimë po fitojnë terren në shërbimin civil dhe në qeveri.<sup>121</sup> Në ministri “mjafton të pushohet nga puna një njeri” që të gjithë të tjerët të vihen në rresht.<sup>122</sup> Udhëheqësit qeveritarë e përcaktojnë

<sup>119</sup> E debatuar në një tryezë të rrumbullakët ministore me përfaqësues të OJQ-ve, Villa Germa, Prishtinë, 15 prill 2010. Shih “Komentet mbi ndryshimet e planifikuara të ligjit mbi OJQ-të”, [“Comments on the planned amendments of the NGO law”] European Center for Not-for-Profit Law, prill 2010.

<sup>120</sup> Intervistë, analisti Halil Matoshi, *Koha Ditore*, 4 nëntor 2009. Shih po ashtu Arben Atashi “Fshesa e PDK-së spastron stafin civil nëpër institucione”, *Koha Ditore*, 2 prill 2008.

<sup>121</sup> Analisti Behlul Beqaj, i intervistuar në Rrokum TV, mesi i tetorit 2009.

<sup>122</sup> Intervistë, Gjyljeta Mushkolaj, gjykatësja e Gjykatës Kushtetuese, 28 janar 2010.

tonin duke intimiduar në mënyrë të drejtpërdrejtë zyrtarët e lartë, përfshirë këtu policinë dhe deputetët.<sup>123</sup>

Nuk ka një provim për shërbimin civil, komiteti i emërimeve për postet e larta publike është anashkaluar,<sup>124</sup> Keshilli i Pavarur i Mbikëqyrjes nuk arrin të sigurojë që të zbatohen vendimet e tij në lidhje me qindra raste pushimesh të padrejta nga puna<sup>125</sup> dhe pozicionet më të larta në ministri zihen nga të emëruarit politikë të cilët shkojnë e vijnë me ndryshimin e çdo administrate. Çdo ministër sjell me vete katër deri në gjashtë këshilltarë të tillë politikë,<sup>126</sup> që janë pjesë e një procesi të depërtimit të ministrive nga grupe joformale në të cilat një trupë shoferësh, asistentësh të shoferëve, truprojash dhe këshilltarësh akumulojnë influencë dhe veprojnë si ndërmjetës për punët e dyshimta.<sup>127</sup> Në disa raste, një personel i tillë sillet nga udhëheqja e partisë për të mbikëqyrur ministrin.<sup>128</sup> Kalimi i ligjeve që kontrollojnë qeverinë, administratën publike dhe shërbimin civil është shtyrë për më vonë.<sup>129</sup>

Profesionalizmi nuk është në gjendje të konsolidohet në shërbimin civil. Në vend që të përfaqësojnë diçka dhe të kuptojnë se ata janë nëpunësit më të lartë civilë, sekretarët e përhershëm të ministrave nuk kanë “një bazë të

<sup>123</sup> Intervistë: kreu i komisionit parlamentar, shkurt 2010, burim kompetent nga Policia e Kosovës, 3 dhjetor 2010. Ky i fundit nuk donte të komentonte mbi detajet e një takimi të mesit të 2008 mes krerëve të policisë dhe kryeministrit, por konfirmoi se: “Shkoi keq” dhe se Thaçi iu drejtua atyre në një mënyrë që të linte me gojë hapur duke qenë se vinte nga kryeministri.

<sup>124</sup> Faton Ismajli, “KELP-i – organ më i dështuar i Qeverisë”, *Koha Ditore*, 4 maj 2008.

<sup>125</sup> Si parlamenti ashtu dhe qeveria ia hodhën përgjegjësinë njëra tjetrës për zbatimin e vendimeve të Bordit të Pavarur të Mbikëqyrjes. Shih: <http://www.ks-gov.net/kpmk/>

<sup>126</sup> Intervistë, Mark Poston, ish kreu i DFID në Kosovë, 11 shkurt 2010.

<sup>127</sup> Intervistë, Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, 15 dhjetor 2009.

<sup>128</sup> Intervista: përfaqësues i një OJQ-je ndërkombëtare, 14 dhjetor 2009; kreu i agjencisë mbikëqyrëse qeveritare, 16 prill 2010.

<sup>129</sup> E theksuar nga Venera Hajrullahu, drejtoreshë e OJQ-së KCSF, në prezantimin e saj për konferencën e 15 tetorit 2009 të Klubit për Politikë të jashtme në Prishtinë mbi “Raportin e Progresit 2009 mbi Kosovën nën Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB 1244/99” të BE-së. Shqetësimet që ngrihen në raport përfshirë vijat e paqarta të ndarjes mes emërimeve politike dhe publike; mungesën e vazhdimësisë në administratë dhe shmangien e institucioneve nga mandatet e tyre. Shih:

[http://ec.europa.eu/enlargement/press\\_corner/key-documents/reports\\_oct\\_2009\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/press_corner/key-documents/reports_oct_2009_en.htm). Më në fund, parlamenti i miratoi dy ligje për rregullimin e shërbimit civil në 13 maj 2010.

përbashkët profesionale” dhe “shpesh janë të trembur dhe përdoren si vegla për interesa të tjera”.<sup>130</sup> Ekziston madje edhe “seleksionimi i keq” i zyrtarëve: “Kompetenca nuk është prioriteti më i lartë... sidomos në pozicionet e mesme dhe të larta. Përkundrazi, zyrtarët që janë kompetentë sulmohen nga qarqet politike”.<sup>131</sup>

Shembulli që jep udhëheqja e vendit krijon një çorientim etik i cili pastaj filtron më poshtë: “Kosova nuk po prodhon modele”.<sup>132</sup> Në vend të kësaj, figura të damkosura nga lidhjet me kriminalitetin zënë pozicione të larta në partitë politike, në kuvend dhe në qeverisjen lokale. Pavarësisht bastisjeve të policisë në ministri dhe shtëpi, dhe pavarësisht njoftimit të qartë se po përgatitet një aktakuzë për korrupsion, ministri i transportit as nuk ka dhënë dorëheqjen, as nuk është larguar dhe as nuk është pezulluar nga puna. “Ne kemi një problem moral” e pranoi kreu i një institucioni mbikqyrës zyrtar.<sup>133</sup>

Zyrtari i lartë i PDK-së dhe ish komandanti i UÇK-së Rrustem (“Remi”) Mustafa u gjet fajtor në një rigjykim në tetor 2009 dhe u dënua me katër vjet burg për trajtimin çnjerëzor dhe torturën e civilëve të burgosur (akuzat për vrasje për të cilën ai ishte gjetur fajtor në një gjyq të mëparshëm në 2003, u rrëzuan nga prokurori) dhe janë të shumtë ata që e lidhin atë me kontroll nëntokësor mbi bizneset në Prishtinë në vitet e para të pasluftës.<sup>134</sup> Megjithatë ai vazhdon të jetë i lirë dhe të kryesojë Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme dhe Sigurinë, prej nga projektion pikëpamjet e tij për punën e policisë.<sup>135</sup> Kreu i LDD-së, partisë së dytë më të madhe opozitare, Nexhat Daci ka qenë i ekspozuar për një rast përvetësimi fondesh publike kur ishte kryetar i kuvendit nga 2002 në 2006, por nuk është gjykuar kurrë, dhe tani kritikon korrupsionin e qeverisë. Jahja Lluka i AAK-së prezantoi një nismë politike të partisë së tij vetëm dy muaj pasi kishte marrë

një dënim me burg, të pezulluar, për pastrim parash në janar të 2010.<sup>136</sup> As kryetarët e komunave të Skënderajit dhe Kaçanikut nuk dhanë dorëheqjen: i pari u burgos në 2008 sepse kishte sulmuar një gjykatës dhe i dyti u arrestua në nëntor 2008 dhe korrik 2009 i dyshuar për disa raste rrëmbimi, intimidimi dhe kërcënimi i një dëshmitari.<sup>137</sup> As këta dhe as kryetari i komunës së Ferizajt Bajrush Xhemajli, poashtu i PDK-së, që vrau një djalë të ri në një aksident me makinë në maj 2009, nuk u përballën me ndonjë pyetje në lidhje me këto çështje gjatë rizgjedhjes së tyre në fund të 2009. Pas kësaj, kryetari Xhemajli u zgjodh president i Asociacionit i Komunave të Kosovës nga homologët e tij.<sup>138</sup>

Pjesëtarët e qeverisë dhe të kuvendit i japin vetvetes rroga të larta ndërkohë që i mbajnë të ulëta rrogat e sektorit publik dhe kanë bërë shumë pak për të luftuar besimin e shumëpërhapur se futja në qeveri është një lloj lejeje për të vjedhur. Pas vitit të parë në pushtet, gjatë të cilit qeveria aktuale u përpoq të paraqitej si e ndryshme nga paraardhësja e saj duke kufizuar shpenzimet që bien në sy nga ana e zyrtarëve të lartë, kjo situatë tanimë ka tejkaluar të gjitha nivelet e mëparshme.<sup>139</sup>

Sistemi gjyqësor, cili duhet të jetë i pavarur dhe i vetësigurtë, është në përgjithësi i nënshtuar dhe pasiv, i frikësuar ose “i mbrojtur nga grupe kriminale”,<sup>140</sup> me reputacion të ulët,<sup>141</sup> rroga të ulëta, dhe shihen nga shumë njerëz si “një profesion për dështakë.”<sup>142</sup> Asnjë politikan apo zyrtar i rëndësishëm nuk është gjykuar për

<sup>130</sup> Intervistë, drejtor, organ zyrtar mbikqyrës, 16 prill 2010.

<sup>131</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar i ngarkuar me mbikëqyrjen, 19-20 prill 2010.

<sup>132</sup> Intervistë, jurist i shqar, 15 shkurt 2010.

<sup>133</sup> Intervistë, 15 dhjetor 2009

<sup>134</sup> Shih raportin për Ballkan të Grupit Ndërkombëtar i Krizave, “Çfarë ndodhi me UÇK?”

<sup>135</sup> Deputeti kontrovers dhe grindavec i LDD-së Gani Geci drejton po ashtu Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencionit Kosovar për Inteligjencë.

<sup>136</sup> Masa për diasporën e shqiptarëve të Kosovës, konferencë për shtyp e AAK-së, 26 mars 2010.

<sup>137</sup> Vehbi Kajtazi dhe Kastriot Jahaj, “Gjykata liron Xhabir Zharkun nga paraburgimi”, *Koha Ditore*, 9 korrik 2009

<sup>138</sup> Ndonëse e pranon se në lidhje me politikanë të tillë ka një dilemë morale, zëvendës-kryeministri Hajredin Kuçi tha se ligji u lejon atyre të mbajnë postin prandaj nuk mund të detyrohen që të japin dorëheqje. Intervistë, 20 maj 2010.

<sup>139</sup> Fatos Halili, raport mbi menaxhimin e shpenzimeve të buxhetit, *Jeta në Kosovë*, 11 shkurt 2010.

<sup>140</sup> Intervistë, Kujtim Kërveshi, analist ligjor, Instituti Kosovar për Drejtësinë, 25 shkurt 2010.

<sup>141</sup> Në një sondazh të janarit për Raportin e Parlajmërit të Hershëm të UNDP-së, vetëm 15% e të intervistuarve u shprehën se janë të kënaqur me punën e gjykatave. Shih: [http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/Fast\\_Facts\\_27\\_ENGEditedFinal-1.pdf](http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/Fast_Facts_27_ENGEditedFinal-1.pdf)

<sup>142</sup> Intervistë, jurist, 15 shkurt 2010.



korupsion në një dekadë.<sup>143</sup> Shumë gjykatës dhe prokurorë dyshohen për korupsion,<sup>144</sup> shumë janë të pazotë dhe të paaftë të absorbojnë ndryshimet ligjore masive që bëri UNMIK-u,<sup>145</sup> papërshtatshmëria e zyrtarëve të rehabilituar të epokës komuniste u pranua në 2004,<sup>146</sup> por një proces i shumëvonoruar i përzgjedhjes dhe riemërimit që po zhvillohet tani nuk po shoqërohet me rritje rrogash dhe është kritikuar sepse po përjashton kandidatët më të rinj (“thjesht veq sa po përzihen letrat: se janë po ata të njëjtët njerëz”<sup>147</sup>), dhe se filtrimi ka qenë i mangët.<sup>148</sup> “Politika i do njerëzit që janë aktualisht në gjyqësor... ky është vendi kryesor ku i shkarkojnë problemet... ata kanë një interes në ndalimin e futjes së njerëzve të rinj në sistem: ata kanë dinjitet të tepërt. Është më mirë të kesh një klasë që ka ndërruar shumë padronë politikë”.<sup>149</sup>

Në kontrast me këtë, Policia e Kosovës që është e paguar akoma më keq, gëzon besimin e publikut<sup>150</sup> dhe perceptohet si profesioniste, koherente dhe mbi politikën. Sidoqoftë, morali dhe reputacioni i saj janë dëmtuar nga dështimi për të zgjidhur vjedhjen e heroinës nga dhoma e provave në selinë e saj në 2009, nga oreksi i qeverisë për ta kontrolluar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për

shkak të kësaj ka përçarje mes komandës së përgjithshme dhe disa komandave rajonale, si për shembull tensionet me njësinë në bastionin e AAK-së në Kosovën perëndimore.<sup>151</sup> Ministria e Brendshme është përfshirë në nivelin operacional dhe e ka marrë nën kontrollin e saj inspektoratin e policisë.<sup>152</sup> Presioni nga ana e ministrisë për të dobësuar statusin e pavarur buxhetor të policisë, nëse zbatohet, do të thotë që: “Ata do të dinë mbi mbrojtjen e dëshmitarëve... sa po shpenzojmë në raste individuale të krimit të organizuar... çdo lëvizje tonën”.<sup>153</sup> Efekti pozitiv që shkaktoi emërimi i papritur i një shefi të respektuar e profesional të policisë në prill 2010, është zbehur nga kontrolli që ka ushtruar ministria mbi emërimin dhe pushimin e zyrtarëve të lartë.<sup>154</sup> Megjithatë ky zhvillim i mirëpritur mund të jetë një tregues se qeveria po e kupton se promovimi i besnikëve politikë ka një kufi: emërimi i një kandidati alternativ që i ka ngjitur shpejt shkallët e hierarkisë mund të kishte shkakuar një përçarje katastrofike, veçanërisht me komandën në Kosovën perëndimore.

Kushtetuta e Kosovës përpiqet ta ruajë sektorin dhe sferën publike nga pushtimi dhe infektimi nga interesat politike duke i vënë institucionet në një karantinë me anë të bordeve të pavarura qeverisëse dhe mbikëqyrëse, me personel të paanshëm dhe profesional – ndërkohë ICR bën roje mbi procesin e emërimeve. Energjia, telekomi dhe disa shërbime të tjera më të vogla kanë borde, dhe po kështu ka edhe aeroporti, hekurudhat, agjencia e privatizimit, banka qendrore, trusti i pensioneve, Agjencia Rregullatore e Telekomunikimit dhe transmetuesi publik RTK.

Qeveria është bërë e shkathët në deformimin e objektit të punës së tyre dhe në manovrimin e ICR-së, ndërkohë që ruan fasadën zyrtare të pavarësisë së bordeve dhe pretendon se nuk po ndërhyt. “Ligjet janë super; por si mund t’i kapësh?” komentoi një zyrtar i OSBE.<sup>155</sup> Qeveria e vonoi tejet shumë formimin e bordeve të

<sup>143</sup> Intervistë, Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë Anti Korupsion, 15 dhjetor 2009.

<sup>144</sup> Disa prej tyre kanë shtëpi shumë të mëdha. Kryeprokurori i asaj kohe Hilmi Zhitia deklaroi se 50 gjykatës dhe prokurorë ishin nën hetim. Lajmet e RTK-së, 18 nëntor 2009. Publikimet në shtyp mbi korupsionin në gjyqësor janë të shumta. Seria e Jeton Musliut “Kush e vrau Mensurin?”, *Express*, 22-26 shtator 2009, përbën një ilustrim të kësaj. Megjithatë, nuk duhet të merren të gjitha raportet ashtu siç paraqiten. Në maj 2010, gazeta Kosova sot filloi një fushatë kundër një gjyqëtare e cila ka marrë vendim për kompensim të një punonjësi që ka humbur dorën në shtypshkronjën e gazetës. Në asnjë nga artikujt e gazetës ku e sulmonin nuk është përmendur ky fakt. Intervistë, gazetarë, maj 2010.

<sup>145</sup> Shih raportin e Human Rights Watch “Askund në agjendë: Dështimi i vazhdueshëm për të kërkuar përgjegjësi në Kosovë pas marsit 2004” [“Not on the Agenda: The Continuing Failure to Address Accountability in Kosovo Post-March 2004”], 29 maj 2006, kapitulli “Reagimi i Sistemit të drejtësisë penale ndaj marsit 2004” [“The criminal justice response to March 2004”], për një përshkrim të përgatitjeve të dobëta për zbatimin e kodit të ri të procedurës penale: <http://www.hrw.org/en/node/11308/section/6>

<sup>146</sup> Intervistë, jurist, 15 shkurt 2010.

<sup>147</sup> Intervistë, Jeton Musliu, gazetar i *Express*, 8 mars 2010.

<sup>148</sup> Intervistat: Betim Musliu, gazetar i *Lajm*, 18 nëntor 2009; Jurist, 15 shkurt 2010; Kujtim Kërveshi, analist ligjor, 25 shkurt 2010; Jeton Musliu, gazetar i *Express*, 8 mars 2010.

<sup>149</sup> Intervistë, jurist, 15 shkurt 2010. Si ilustrim shih Besnik Krasniqi, “Kryeministri fajëson gjyqësorin për korupsionin në Kosovë”, *Koha Ditore*, 5 mars 2010.

<sup>150</sup> Në sondazhin e UNDP-së të janarit 2010 76% e të intervistuarve u shprehën të kënaqur me punën e Policisë së Kosovës, op. cit.

<sup>151</sup> Intervistë, burim kompetent nga Policia e Kosovës, 3 dhjetor 2009.

<sup>152</sup> Shih Grupin Ndërkombëtar i Krizave “Sundimi i ligjit në Kosovën e pavarur”, op. cit.

<sup>153</sup> Intervistë, burim kompetent nga Policia e Kosovës, 3 dhjetor 2009.

<sup>154</sup> Intervistë e BIRN, vrojtues i kujdesshëm i Policisë së Kosovës, organizatë ndërkombëtare, prill 2010.

<sup>155</sup> Intervistë, 27 tetor 2009.

ndërmarrjeve publike dhe pastaj u mundua që t'i kalonte të emëruarit politik dhe joprofesional përtej ICR-së dhe më në fund bëri një kompromis në fund të prillit 2009 duke hequr dorë nga emërimet më të këqija.<sup>156</sup> Por, ajo arriti të sigurote emërimin e kandidatëve të pakualifikuar në bordin e hekurudhave, duke injoruar paralajmërimet se kjo rrezikonte asistencën e BE-së për ringritjen e hekurudhës kosovare;<sup>157</sup> një student i juridikut që ende nuk ka diplomuar kryeson bordin e aeroportit. Transferimi i shqyrtimit të prokurimit publik në 2008 tek një organ i ri e i pavarur nga Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik e përkeqësoi situatën sepse institucioni i ri ishte “plot me tipa të dyshimtë me lidhje politike.”<sup>158</sup>

Në një numër të rëndësishëm rastesh në ministri apo në organe rregullatore janë emëruar teknokratë që në të kaluarën e tyre kanë elemente që mund të dobësojnë pavarësinë e tyre, duke i bërë kështu viktima të shantazheve.<sup>159</sup>

Gruaja e guvernatorit të bankës u kap duke i dhënë substanca narkotike dy djemve të tyre të cilët ishin në burg të arrestuar nën akuzat për vrasje.<sup>160</sup> Ai është sulmuar nga media dhe në kuvend.<sup>161</sup> Megjithatë, të paktën në pamje të parë, duket sikur guvernatori e ka drejtuar mirë sektorin bankar gjatë recesionit të dy viteve të fundit, duke u rezistuar presioneve dhe duke i aplikuar rregullat me rigorozitet.

Konsensusi ndërpartiak mbi emërimin e rregullatorëve nga Kuvendi priret të prodhojë figura të dobëta, duke anashkaluar kandidatët më të fortë. Gjatë tri vjetëve kuvendi ka filtruar tre

<sup>156</sup> Lavdim Hamidi, “Qeveria zgjedh anëtarët e bordeve, por nuk tregon emrat”, *Zëri*, 24 prill 2009. Zëvendës Kryeministri Hajredin Kuçi tha që edhe pse qeveria zgjedh anëtarë të bordit të cilët janë mbështetës të saj, profesionalizmi është kriteri kryesor gjatë përzgjedhjes. Intervistë, 20 maj 2010.

<sup>157</sup> Parim Olluri, “Qeveria planifikon t’ua lere në dorë ‘Hekurudhën’ ish-liderëve studentorë”, *Koha Ditore*, 11 mars 2010. Arbana Xharra, “Kandidatet e Qeverisë rrezikojnë 200 milionë euro”, *Zëri*, 3 prill 2010.

<sup>158</sup> Intervistë, Hasan Preteni, Drejtor, Agjencia për Anti Korrupsion, 15 dhjetor 2009.

<sup>159</sup> Ka raste të ndryshme. Për disa thuhet se kanë pasur marrëdhënie me UDBA, shërbimet sekrete të ish Jugosllavisë, gjatë viteve 1980 dhe 1990.

<sup>160</sup> “Nëna kosovare kontrabandon drogë djemve të burgosur”, [“Kosovo Mother Smuggled Drugs to Detained Sons”], *Balkan Insight*, 13 mars 2009.

<sup>161</sup> Në 2010 nga gazeta *Express* dhe deputeti i PDK-së Nait Hasani.

lista të njëpasnjëshme kandidatësh për bordin e RTK-së, më e fundit ndër të cilat ishte një proces i beftë i kryesuar nga zëvendës kryeministri Kuçi. Përpara se ICR të mund të bënte ndonjë gjë për ta parandaluar,<sup>162</sup> në janar 2010 ky bord emëroi me tetë nga nëntë vota si Drejtor të Përgjithshëm të RTK-së një kandidat të pakualifikuar, i cili ishte futur në listë me vonesë.<sup>163</sup> Disa orë përpara votimit, kryetari i këtij bordi, që supozohet të jetë i pavarur, tha se vetëm ndërhyrja e kryeministrit do të mund ta ndryshonte vendimin që kishte ndërmend të merrte bordi.<sup>164</sup>

Ligji mbi qasjen në dokumente zyrtare ende nuk është operacional: gazetarët dhe personat e tjerë të interesuar aktualisht nuk mund të marrin informacion mbi një gamë gjithnjë e më të madhe vendimesh të qeverisë qendrore dhe lokale.<sup>165</sup> Kërkesat dhe emailt hasin në një mur heshtjeje.<sup>166</sup> Zyrtarët e qeverisë “do të pushoheshin” nëse zbulohet se i kanë dhënë kryetarit të një komisioni parlamentar kopje të udhëzimeve administrative.<sup>167</sup> Në qeveritë lokale, nenet mbi decentralizimin që janë pjesë e planit të Ahtisaarit i japin më shumë pushtet kryetarëve të komunave, duke bërë që nëpunësit civilë të ndihen më pak të sigurt për vendin e tyre të punës, të kenë më pak

<sup>162</sup> I befasuar nga shpejtësia e këtij emërimi, ICR aranzhoi një takim me kryeministrin Thaçi për të shprehur shqetësimet e tij, por në kohën kur takimi ndodhi ICR u përball me një fakt të kryer. Thaçi pretendoi se kishte mbështetur një kandidat tjetër, shefin e televizionit Liridon Cahani, i cili nuk arriti të përfshihej në listën e shkurtër. Kjo u pranua me rezervë. Në ditën kur bordi mori vendimin, 26 janar 2010, kërkesa e ICR që ai të mos publikohej, me shpresë se ende mund të kthehej mbrapsht, u rrëzua nga pozicioni i kandidatit fitues si mbikëqyrës menaxherial i lajmeve të RTK: ditari i orës 19:30 e bëri emërimin e tij lajmin kryesor. Intervista, BIRN, janar-shkurt 2010.

<sup>163</sup> Një ndër kriteret e rekrutimit ishte që kandidati të fliste anglishten rrjedhshëm, çka Sylejman Shaqiri nuk e përmbushte. Raportohet se letra e aplikimit të tij u përpilua copy-paste nga udhëzimet e stafit të RTK-së, me përjashtim të një paragrafi që shprehte synimin e tij për të sjellë njerëz më të kualifikuar në RTK. Intervistë, burim nga RTK, shkurt 2010.

<sup>164</sup> Intervistë, burim kompetent, 26 janar 2010. Paçarizi, i cili u takua me zëvendës kryeministrin Hajredin Kuçi një ditë para vendimit, më vonë u tha mediave se vendimi i bordit nuk ishte ndikuar politikisht. Zëvendës kryeministri Hajredin Kuçi i cili mbikëqyri përzgjedhjen e bordit, nguli këmbë që ndonëse anëtarët e bordit nuk “janë engjëj” ata janë gjithsesi “njerëzit më të pavarur në këtë vend”. Organi që i zgjodhi ishte multipartiak dhe arriti një nivel të lartë konsensusi. Intervistë, 20 maj 2010.

<sup>165</sup> Intervista: Bekim Kupina, redaktor i rubrikës për komunat të *Koha Ditore*, 18 nëntor 2009; Afrim Demiri, korrespondenti për Ferizaj i *Kohës Ditore*, 12 dhjetor 2009; kreu i komisionit parlamentar, 26 shkurt 2010.

<sup>166</sup> Intervistë, Salie Gajtani-Osmankaq, gazetare, *Koha Ditore*, 22 dhjetor 2009.

<sup>167</sup> Intervistë, kryetar i komisionit parlamentar, 26 shkurt 2010.

autonomi në vendimmarrjen e tyre dhe të jenë më të shtrënguar në dhënien e informacionit.<sup>168</sup> Pikërisht ata që e zbatojnë ligjin në mënyrë të prerë mund të përfundojnë të pushuar nga puna, të gjobitur dhe të futen në listat e zeza.<sup>169</sup> Zyrtarët e prokurimit në të gjitha anët janë nën presion,<sup>170</sup> kontrollet dhe mbikëqyrjet normative anashkalohen<sup>171</sup> dhe vetë Organi Shqyrtues i Prokurimit është i uzurpuar.<sup>172</sup>

Zyrtarët e prokurimeve janë zëvendësuar<sup>173</sup> dhe e njëjta gjë ka ndodhur me disa nga drejtuesit lokalë të qendrave shëndetësore<sup>174</sup> apo zyrtarët e ministrive. E megjithatë nuk ka pasur ndonjë pushim masiv nga puna për arsye politike në administratën publike dhe as në ndërmarrjet publike. Aty ku ka pasur ndryshim të pushtetit në komuna, anëtarët e partisë dhe të afërmit janë marrë në punë me kontrata afatshkurtra ekstra-buxhetore (“mbi vepër”).<sup>175</sup> Në Kamenicë, pasi ish kryetari i komunës i LDK-së në dhjetor 2009 e rifitoi postin që i kishte humbur nga PDK-ja dy

<sup>168</sup> Intervistë, Agron Demi, Instituti GAP, 30 tetor 2009.

<sup>169</sup> Në një vendim të datës 14 dhjetor 2009, Organi i Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) “pushoi nga puna dhe gjobiti zyrtarin më të ndershëm të prokurimeve në Kosovë.” Ajo largoi menaxherin e prokurimeve të komunës së Rahovecit, Kamer Ukaj, duke e gjobitur me 1000 euro dhe duke e ndaluar nga mbajtja e ndonjë posti në shërbimin publik për tri vjet pasi ai në mënyrë korrekte vlerësoi tenderin për një sistem të ri të ujësjellësit për një numër të fshatrave, duke shpërfillur presionin e OSHP-së për një rezultat tjetër. Intervistë, zyrtarë, organ rregullator shtetëror, 18 dhjetor 2009.

<sup>170</sup> Në Kosovë ka 431 zyrtarë profesional të prokurimeve publike. Në debatin për zgjedhjet për kryetarin e komunës së Suha Rekës në *Jeta në Kosovë*, në RTK në nëntor 2009, kandidatët rivalë ia vunë fajin LDK për sulmet ndaj kreut të prokurimeve në komunë. Kreu i prokurimeve të Ferizajit dha dorëheqjen në 2009, duke u ankuar për presione. Intervista: Albulena Sadiku, INPO, 2009; Afrim Demiri, *Koha Ditore*, 12 dhjetor 2009. Kryetari i komunës së Gjilanit e zëvendësoi kreun e prokurimeve të komunës me një kandidat që nuk kishte as kualifikimet ligjore minimale. Intervistë, Agron Demi, Instituti GAP, 30 tetor 2009.

<sup>171</sup> Intervistë, këshilltar ndërkombëtar, organ rregullator shtetëror, 18 dhjetor 2009.

<sup>172</sup> As ai dhe as krerët aktualë të Agjencisë së Prokurimeve Publike nuk kanë arsimimin apo eksperiencën që kërkohet me ligj. Intervistë, rregullator shtetëror, 18 dhjetor 2009. OSHP është kritikuar ashpër nga Komisioni Evropian sepse ka shpërfillur këshillat e saj teknike, duke marrë vendime pa i argumentuar në mënyrë adekuate dhe sepse nuk i ka botuar ato. Komisioni Evropian kërkoi që disa vendime ilegale të OSHP të anuloheshin, duke përfshirë dhe tenderin për furnizimin me ujë të fshatrave të Rahovecit. Vatra Qehaja, “Komisioni Evropian kërkon borde të reja në institucionet e prokurimit”, *Koha Ditore*, 3 maj 2010.

<sup>173</sup> Si në nivelin qendror ashtu dhe në atë lokal, shumë prej tyre e zëvendësuan me emërime politike të pakualifikuara. Intervista: rregullatori i shtetit, 18 dhjetor 2009 dhe Agron Demi, Instituti GAP, 30 tetor 2009.

<sup>174</sup> Intervistë, Agron Demi, Ibid.

<sup>175</sup> Intervista: Ibid dhe Afrim Demiri, *Koha Ditore*, 12 dhjetor 2009.

vjet më parë, ai pushoi nga puna shtatëmbëdhjetë nëpunës të tillë që ishin punësuar në këtë periudhë të ndërmjetme – plus 27 të tjerë që ishin punësuar pa një procedurë konkurruese, ishte rast i rallë u raportua në gazeta.<sup>176</sup> PTK dhe aeroporti e shtuan edhe më tej personelin e tyre që tanimë ishte mjaft i madh.<sup>177</sup> Në raste të tjera, që prej zgjedhjeve lokale ka pasur pushime individuale nga puna për arsye politike: kryetari i komunës të Gjakovës i AAK-së pushoi nga puna drejtorin e planifikimit për emergjencat pasi ai kishte votuar për një kandidat rival për kryetar komune.<sup>178</sup>

Ka pasur një qarkullim të madh drejtorësh shkollash dhe në një shkallë më të vogël, një qarkullim mësuesish, me punësime dhe pushime nga puna në baza partiake, sidomos në periudhën që i parapriu fillimit të vitit shkollor në shtator 2009.<sup>179</sup> Reformat e decentralizimit janë përdorur nga kryetarët e komunave për të vënë nën kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë procesin e emërimeve.<sup>180</sup> Shpërblimi i militantëve partiakë me vende pune në shkolla është kthyer në një rregull dhe drejtorët e shkollave që nuk janë anëtarë partie po bëhen një specie gjithnjë e më e rrallë.<sup>181</sup> Kontratat e rinovueshme njëvjeçare që përdorte UNMIK-u e përforcojnë këtë dobësi; komisionet lokale të vlerësimit shpesh janë të pakualifikuara dhe nën diktatin e kryetarit të komunës.<sup>182</sup>

<sup>176</sup> Nexhat Buzuku, “43 punëtorë të pranuar pa konkurs largohen nga puna”, *Koha Ditore*, 31 janar 2010.

<sup>177</sup> Në mes të 2009, aeroporti bëri lajmërim për 120 vende të tjera pune. Burime nga aeroporti i thanë BIRN që në fakt u morën në punë 200 punonjës, intervistë, prill 2010. Në total atje punojnë tani 850 vetë. PTK duket sikur ka marrë në punë edhe disa qindra njerëz gjatë vitit të fundit. Shih për shembull, Lavdim Hamidi, “Për 3 muaj mbi 100 të punësuar në PTK”, *Zëri*, 15 prill 2009. Më 13 maj 2010 qeveria e ndaloi PTK të merrte më shumë njerëz në punë, në pritje të privatizimit të saj. Besnik Krasniqi, “Qeveria i ve kufizime PTK-së”, *Koha Ditore*, 14 maj 2010.

<sup>178</sup> Besiana Xharra: “U largua nga puna ‘sherri’ i votës për Mimosën”, *Zëri*, 8 mars 2010.

<sup>179</sup> Intervistë, Agron Demi, Instituti GAP, 30 tetor 2009.

<sup>180</sup> Intervistë, Afrim Demiri, *Koha Ditore*, 12 dhjetor 2009.

<sup>181</sup> E theksuar në debatin për zgjedhjet lokale në Kaçanik në *Jeta në Kosovë* të nëntorit 2009: i akuzuar se të gjithë drejtorët e shkollave ishin emërime politike, Xhabir Zharku u përgjigj duke identifikuar një drejtor shkollë në Kaçanik që “s” është i PDK-së”.

<sup>182</sup> Intervistë, Afrim Demiri, korrespondent për Ferizaj, *Koha Ditore*, 12 dhjetor 2009.

## Zgjedhje të cenuara

A mundet administrimi dhe rezultati i zgjedhjeve t'i mbijetojnë akumulimit të presioneve që sabotojnë një pjesë kaq të madhe të sferës publike? Pavarësisht rënies graduale të pjesëmarrjes në votime nga 79% në 2000 në diçka më tepër se 40% në 2007,<sup>183</sup> zgjedhjet në Kosovën e pas 1999 janë parë si shembullore, pasi i janë shmangur kontestimeve të ashpra të rezultateve dhe dhunës që janë parë, për shembull, në Shqipërinë dhe Maqedoninë fqinje gjatë zgjedhjeve të kohëve të fundit. Rregullat strikte të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme u garantojnë të gjithë kandidatëve pjesën e tyre të kohës televizive. Dekada që lamë pas, me një përvojë nën kujdestarinë dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare, ka krijuar një pritshmëri të shëndetshme në lidhje me zgjedhjet.

Sidoqoftë, shqetësimet e disa partive në lidhje me parregullsitë në rezultatet e zgjedhjeve të 2007 u bënë me gjysmë zëri për hir të procesit të pavarësisë së Kosovës që ishte iminent në atë kohë; abuzimet nuk u ndëshkuan.<sup>184</sup> Në 2009, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, KQZ, një produkt i negociatave mes partive dhe zyrtarët kryesorë të të cilës u zgjodhën në minutën e fundit,<sup>185</sup> mori rolin publik dominant që kishte pasur më parë OSBE (ndonëse kjo e fundit më vonë, në minutën e fundit, në mënyrë diskrete futi personelin e saj për të ndihmuar KQZ-në dhe komisionin zgjedhor për ankesa dhe parashtesa, KZAP).<sup>186</sup>

Transmetuesit televizivë u dhanë të gjithë kandidatëve që e donin një gjë të tillë një mbulim

<sup>183</sup> Shifrat thuajse me siguri e ekzagjerojnë rënien, duke qenë se lista zgjedhore ishte shumë më e vogël dhe shumë serbë votuan në zgjedhjet e vitit 2000 dhe 2001. Lista u zgjerua nga 1.25 milion votues në 2001 në 1.56 milion në 2009 dhe ende përfshin disa qindra mijëra votues që jetojnë jashtë shtetit dhe shumë nga ata që kanë vdekur gjatë dekadës së fundit.

<sup>184</sup> Shih Lawrence dhe Mia Marzouk: "Hija e mashtrimit varet mbi zgjedhjet vjeshtore të Kosovës", ["Shadow of Fraud Hangs over Kosovo Autumn Poll"], *Prishtina Insight*, 4-17 shtator 2009.

<sup>185</sup> Kreu i saj papritur dha dorëheqjen dhe u zëvendësua në maj 2009 nga gjykatësja Nesrin Lushta. Përplasjet mbi vendin e oficerit ekzekutiv vazhduan deri në maj 2009.

<sup>186</sup> Intervista: zyrtar ndërkombëtar, vëzhguesi i BIRN-it Mia Marzouk, tetor 2009.

të mjaftueshëm dhe çdo kanal televiziv transmetoi debate në pothuajse të 36 komunat: një përmirësim i madh në krahasim me zgjedhjet e shkuara. Në 2007 *Jeta në Kosovë* e RTK-së ishte një pishtarë e vetmuar e këtyre debateve; përpara kësaj zgjedhjet lokale ishin *terra incognita* për audiencat televizive kombëtare. Kandidatët ishin më të përgatitur se në 2007 dhe rezultatet në Prishtinë, Suharekë, Mitrovicë dhe Gjakovë dëshmuar se publiku vlerësonte kandidatët me një orientim profesional që vinin nga jashtë radhëve të partive. Megjithatë, axhenda e debateve nuk shkoi shumë më larg se furnizimi me ujë, energji elektrike dhe çështje të tjera të infrastrukturës të debatuar në 2007. Ato dështuan të hulumtonin cilësinë e qeverisjes dhe demokracisë lokale dhe nuk sollën diskutime mbi krimet e provuara apo të dyshuara të disa prej kryekomunarëve që garonin sërish.

Sidoqoftë, makineritë e partive qendrore, paratë dhe influenza ishin aq mbizotëruese në këto zgjedhje lokale sa t'i linin në hije preferencat lokale, pa ofruar megjithatë çfarëdo politikash të dallueshme partiake për qeverisjen lokale. Partitë investuan sasi të mëdha parash në reklama dhe një stacion televiziv gjeneroi kësajsoj një të tretën e buxhetit të tij vjetor.<sup>187</sup> Reklammat e PDK-së dhe AAK-së për kandidatët e tyre në Prizren dhe Suharekë ku gara ishte e fortë, theksonin patronazhin e kryetarëve të partive të tyre, duke treguar se kandidatët ishin nën varësinë e kërreve partiakë. Në fakt, kryeministri e përdori pozicionin e tij për të premtuar miliona euro investime publike shtesë në komunat që zgjidhnin kryetarë nga PDK-ja, duke ngritur pikëpyetje mbi ekuilibrat kushtetues mes të qeverisë qendrore dhe asaj lokale dhe duke iu afruar shumë korrupsionit apo shantazhimit të elektoratit.<sup>188</sup> PDK-ja kishte po ashtu një avantazh për sa i përket mbulimit televiziv, pasi kandidati i preferuar i kryeministrit ishte ricaktuar si drejtor i lajmeve në RTK dy muaj përpara zgjedhjeve. Ndonëse ndershmëria e mbulimit u respektua në aspektin sasior,<sup>189</sup> rendi i mbulimit, axhenda dhe përmbajtja e lajmeve ishin të anshme dhe madje redaktorët zbatuan

<sup>187</sup> Intervistë, redaktor, televizioni Klan Kosova, 7 dhjetor 2009.

<sup>188</sup> Shumat që u premtuan ishin të pabesueshme: të marra së bashku ishin shumë më tepër se ç'mund të përballojë buxheti i Kosovës. Ato përfshinin 170 milion euro për Prizrenin, 155 milion euro për Pejë, 120 milion euro për Ferizajin dhe 100 milion euro për Gjilanin.

<sup>189</sup> Demokracia në Veprim, "Monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore në Kosovë", mars 2010. Online në: [www.kipred.net](http://www.kipred.net).

sugjerimet e PDK-së për të prerë momente jo të mira të Thaçit dhe të kandidatit për Prishtinën nga mbulimi i përditshëm i fushatës.<sup>190</sup>

Në shumë vende – zona rurale dhe disa qytete provinciale – votuesit, personeli i qendrave të votimit dhe vëzhguesit u penguan nga grupe militantësh partiakë, disa prej të cilëve ishin të armatosur: këta mblidheshin jashtë, lëviznin nga një qendër në tjetrën në grupe (disa thuhet se votonin në të gjitha këto qendra) ose përfshiheshin në personelin e qendrave të votimit ku shumë prej tyre nuk e fshihnin përkatësinë e tyre partiake si dhe shoqëroheshin nga persona të paautorizuar. Dy prej dhjetë ekipeve të vëzhguesve të BIRN-it kërkuan mbrojtjen e policisë për tu rifitur në qendrat e votimit prej ku ishin përzënë nga njerëz të armatosur.<sup>191</sup> Në raundin e dytë të votimit, në dhjetor, partitë e akuzuan njëra tjetrën aty për aty për dislokimin e militantëve në vende të ndryshme dhe pranuan se po përdornin militantët e tyre për “mbrojtur” votat.<sup>192</sup> Pati disa raste rrahje.<sup>193</sup> “Na u desh të thërrasim huliganë” për të ndaluar manipulimin nga zyrtarët e shtetit, tha kreu i AAK-së Haradinaj.<sup>194</sup> Klina ishte “pranë luftës” me qendrat e saj të votimit të “mbrojtura me kallashnikovë”;<sup>195</sup> një grup i madh njerëzish të kryesuar nga Dauti, vëllai i Haradinajt u tërhoq që të mos përleshesh me armë me PDK-në.<sup>196</sup>

Në qendrat e votimit dhe në qendrat komunale të mbledhjes së rezultateve shpesh presioni mbi administratorët e zgjedhjeve, policinë, dhe vëzhguesit e OJQ-ve dhe të partive politike nuk ishin nën një presion të mjaftueshëm normativ për të kryer detyrën e tyre profesionale. Forcat që i shtynin të ndërronin krah apo të hiqnin dorë nga

<sup>190</sup> Lajmet e RTK-së i pranuan udhëzimet e PDK për prerjet ndonëse të njëjtat momente u transmetuan në kanalet e tjera të lajmeve: komentet e një gruaje në një serrë që i thoshte kandidatit për kryetar komune të Prishtinës Astrit Salihu se kandidati i mëparshëm, Fatmir Limaj ishte më i mirë; një përgjigje e hutuar që i dha Hashim Thaçi pyetjes së një gazetari gjatë fushatës në Prizren. Intervistë, burim kompetent i RTK-së, 4 dhjetor 2009.

<sup>191</sup> Në Gjakovë dhe Lipjan.

<sup>192</sup> Mbulimi gjatë ditës, televizioni Klan Kosova, 13 dhjetor 2009.

<sup>193</sup> Shih Kastriot Jahaj dhe Arian Duriqi, “Akuza për rrahje e vjedhje votash mes LDK-së e PDK-së”, *Koha Ditore*, 16 dhjetor 2009.

<sup>194</sup> Programet e lajmeve të mbrëmjes në televizion, 14 dhjetor 2009.

<sup>195</sup> Intervistë, kandidati për kryetar komune të Pejës, 15 dhjetor 2009. E konfirmuar nga një gazetar nga Klina, shkurt 2010, dhe nga koalicioni i OJQ-ve Demokracia në Veprim, 18 mars 2010.

<sup>196</sup> Shumë banorë nuk e donin praninë dhe sjelljen e këtij grupi.

Intervista: gazetar nga Klina dhe Demokracia në Veprim, Ibid.

puna e tyre ishin shpesh më të pranishme dhe më të forta. Ka shumë prova rrethore dhe në ndonjë rast fakte të regjistruara në kamerë, që flasin për pjesëmarrjen në apo lejimin e mbushjes së kutive të votimit. Shumë zyrtarëve dukej se u mungonte “identiteti, përgatitja,” dhe ishin të paqartë se kë përfaqësonin saktësisht.<sup>197</sup> Duke qenë se kishte monitorues në pothuajse çdo qendër votimi, organizata përfaqësuese e OJQ-ve kosovare, Demokracia në Veprim, ishte në një pozicion të mirë për të ushtruar një presion normativ dhe për të përfaqësuar interesat e publikut në terren – por në realitet shumë nga monitoruesit e saj u intimiduan, disa u përzunë dhe pati dhe raste kur persona të tjerë u hoqën si ata.<sup>198</sup> Kjo OJQ u duk pasive në zgjedhjet e nëntorit 2009, ndonëse reagoi më shumë në raundin e dytë në dhjetor.<sup>199</sup> Kryesia e kësaj OJQ-je kishte ndjesinë se ishte e padrejtë që vetëm vëzhguesit e tyre të mbanin peshën e kundërshtimeve nëse të gjithë të tjerët në qendrën e votimit ishin shitur, dhe firmosnin rezultatet e manipuluar. Megjithatë, kjo OJQ ishte e mendimit se në përgjithësi manipulimet nuk patën ndonjë ndikim kyç tek rezultatet – blerja e votave ishte një faktor më i rëndësishëm sesa vjedhja e votave dhe disa votues ishin të detyruar të bënin fotografi me telefonat e tyre, në kabinën e votimit për të provuar sesi kishin votuar.<sup>200</sup>

Për këto nuk ka pasur hetime dhe ndjekje penale, çka u jep zyrtarëve mesazhin se bashkëfajësia në

<sup>197</sup> Intervistë, Afrim Demiri, korrespondenti për Ferizaj, *Koha Ditore*, 12 dhjetor 2009. Pasi fshihën identitetet e tyre, kreu i komisionit zgjedhor të Shtërpçës, shqiptar, kërcënoi një kërkues të NDRNJ (që ishte akredituar si vëzhgues) ndërkohë që zëvendësi i tij serb e sulmoi atë pasi ai mbajti shënim numrin e një kutie votimi të pavulësuar që përmbante një numër zarfesh në ulësën e pasme të makinës së tyre, të parkuar në një rrugë pranë qendrës kryesore të numërimit në Fushë Kosovë, në mëngjesin pas raundit të parë të zgjedhjeve, 16 nëntor 2009.

<sup>198</sup> Në Ferizaj disa prej tyre u detyruan me forcë të largoheshin nga qendrat e votimit për disa orë, në Mitrovicë u panë njerëz të paakredituar që kishin veshur bluzat e Demokracisë në Veprim, ndërkohë që në fshatin e Shtërpçës me mazhorancë shqiptare një vëzhgues ndërkombëtar pyeti një person që kishte veshur një bluzë të Demokracisë në Veprim se për kë punonte dhe mori përgjigjen: “Për PDK-në”. Korrespondencë, vëzhguesja e BIRN Mia Marzouk, prill 2010. Shumë monitorues të Demokracisë në Veprim kishin frikë t’i raportonin problemet në kohë reale, sepse kjo bënte që ata të identifikoheshin dhe të intimidoheshin nga personeli i qendrave të votimit. Intervistë, Valmir Ismaili, Demokracia në Veprim, 18 mars 2010.

<sup>199</sup> OJQ-ja fitoi përvojë nga raundi i parë dhe bëri disa ndryshime në rrjetin e saj të monitorëve. Intervistë, Valmir Ismaili, Demokracia në Veprim, 18 mars 2010.

<sup>200</sup> Ibid.

abuzimet elektorale është më pak e rrezikshme sesa të sfidosh patronët e fuqishëm politikë, të cilët nga ana e tyre ndihen edhe më të inkurajuar për të përshkallëzuar abuzimet në balotazh.. Drejtorët e shkollave, shumë prej të cilëve u emëruan politikisht në shtator, përbënin një hallkë të dobët kyçe. Shumë prej tyre u bënë menaxherë të qendrave të votimit të vendosura në shkolla, secila prej të cilave përmbante disa stacione votimi. Në shumë qendra një ose më shumë vendvotime nxirrnin rezultate që ndryshonin shumë nga mesatarja e rezultateve të qendrave të votimit.<sup>201</sup> Ndonëse ligji parashikon vetëm një rol teknik mbështetës për zyrtarët e qendrave të votimit, në realitet ata i dominojnë vendvotimet.<sup>202</sup> Praktikisht, drejtorët e shkollave të emëruar politikisht kishin nevojë për fitoren e kryetarit të komunës në pushtet për të ruajtur postet e tyre.

Të gjitha partitë, përveç PDK-së u ankuan për anshmërinë në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Në rastin më të mirë, mosmarrëveshjet politike vononin përzgjedhjen e zyrtarit që do të shërbente si kryeshefi i saj ekzekutiv, kishte mungesë transparence në rekrutimin e personelit dhe shpesh preferoheshin kandidatë të papërvojë kundrejt atyre që kishin punuar në zgjedhjet e mëparshme.<sup>203</sup> Vendime të dyshimta të KQZ pati edhe në nivelin lokal: shumë votues në Mitrovicë zbuluan se i kishin zhvendosur nga qendrat e tyre të zakonshme të votimit,<sup>204</sup> në Pejë votuesit e dy qendrave të votimit që kishin një histori mbështetjeje të partisë së vogël opozitare Ora u kaluan në një qendër të largët votimi pa i paralajmëruar<sup>205</sup> ndërkohë që vëzhguesit e po të njëjtës parti u dërguan nga

vendvotimet në Prizren ku votonin votuesit e tyre të zonave urbane për në zonat rurale.<sup>206</sup>

Procesi i numërimit të rezultateve përfundimtare, i cili i përshtati rezultatet fillestare të votimeve (numërimet origjinale të vendvotimeve), i cili i përfshinte edhe votat me kusht, prirëj të favorizonte disa parti ndaj të tjerave.

Në komunën e Pejës së drejtuar nga AAK, rezultatet paraprake të partive të mëdha u rritën ndjeshëm nga votat me kusht: AAK-së iu shtuan 766 vota mbi 15,285 votat që kishte (në rritje me 5%), PDK-së iu shtuan 233 mbi 4,919 që kishte (një rritje me 4.7%), LDD-së iu shtuan 219 mbi 5,626 që kishte (rritje prej 3.9%) kurse LDK-së iu shtuan edhe 88 vota mbi 4,580 votat që kishte në rezultatet paraprake (rritje me 1.9%). Në krahasim me këto, vetëm 11 vota iu shtuan 3,617 votave të Orës (rritje me 0.3%). Në shkallë kombëtare, nga numërimi i votave me kusht përfitoi në mënyrë të shproporsionuar PDK-ja e cila pati një rritje prej 1.62% dhe 2.64% të totalit të votave në zgjedhjet lokale të mes rezultateve paraprake dhe atyre finale<sup>207</sup> - shumë më të lartë se të gjithë partitë e tjera, ndërkohë që LDK-ja e cila vinte e dyta, kishte një ndryshim prej vetëm 0.42% deri në 1.53% mes rezultateve paraprake dhe finale.<sup>208</sup>

Megjithatë në rastin e Prizrenit, kur votat me kusht premtinin se do të ishin në përfitimin e LDK-së, KQZ-në e pengoi numërimi i këtyre votave, çka në fakt nuk u bë kurrë. Në Prizren u urdhërua një rivotim, të cilën e fitoi PDK në janar 2010, pavarësisht shenjave se në fakt PDK kishte humbur në balotazh e dhjetorit 2009.<sup>209</sup> Në përgjithësi KQZ tregoi se nuk ishte e aftë të përcaktonte rezultatet në asnjë komunë ku ato ishin shumë të ngushta dhe e dëmtoi reputacionin

<sup>201</sup> Në shumë qendra votimi ka variacione dramatike mes rezultateve në vendvotimet e ndryshme. Për shembull, në zgjedhjet lokale të 15 nëntorit 2009 në qendrën e votimit 2015a në Prizren, LDK fitoi 46.4% në vendvotimin 01r por pësoi një rritje deri në 73.5% në vendvotimin 05d, ndërkohë që PDK fitoi 28.7% në 01r dhe vetëm 7.1 në 05d. Në qendrën e votimit 2113b në komunën e Skënderajt, 100% e votuesve votuan në vendvotimin 01r, 34.6% në 02r dhe 75.3% në 03d. Korrespondencë Mia Marzouk, vrojtuese BIRN, prill dhe maj 2010.

<sup>202</sup> Vrojtëm i dhjetë ekipeve monitoruese të BIRN, pjesë e të cilave ishte dhe një kërkues i NRDNI, 15 nëntor dhe 13 dhjetor 2009.

<sup>203</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, nëntor 2009.

<sup>204</sup> Intervistë, zyrtar i OJQ Community Building Mitrovica (CBM), në Mitrovicë, 17 mars 2010.

<sup>205</sup> Intervistë, Gazmend Muhaxheri, kandidat për kryetar komune për partinë ORA, 15 dhjetor 2009.

<sup>206</sup> Ibid.

<sup>207</sup> Rritjet minimale në përqindje përjashtojnë komunat ku rezultatet e disa vendvotimeve janë anuluar apo ku rezultatet e disa qendrave të votimit nuk janë përfshirë në totalin preliminar. Shifrat maksimale përfshijnë të gjitha rezultatet e kuvendeve komunale.

<sup>208</sup> Llogaritje nga Mia Marzouk, vrojtuese e BIRN, korrespondencë prill 2010.

<sup>209</sup> Në natën e zgjedhjeve, pasi kishte përfunduar numërimi në vendvotimet, koordinatori i fushatës së LDK i tha BIRN se ai kishte besim të plotë se partia e tij kishte fituar ndërkohë që rivalët e tij në PDK nuk e përfshinin Prizrenin ndër komunat që llogarisnin se kishin fituar. Më vonë, një burim kompetent i PDK-së në Prizren raportohet të ketë pranuar në mirëbesim se totali i votave të partisë së tij ishte 3000 vota më pak se ai i LDK. Intervistë, gazetar i Klan Kosova, 22 dhjetor 2009.

e saj me keqmenaxhimin e rezultateve dhe rezistencën ndaj rivotimit në Prizren dhe Lipjan, të cilat u mbajtën eventualisht në 31 janar 2010 dhe në Gjilan ku ato u mbajtën në 14 mars 2010.<sup>210</sup>

## Varësia nga të huajt

Prania e lartë, tanimë 11 vjeçare, e të huajve, ka imponuar konceptet evropiane dhe të OKB-së mbi të drejtat e njeriut, të drejtat e minoriteteve dhe të barazisë gjinore, demokracinë dhe liberalizimin e tregut. Përvetësimi dhe mësimi i tyre nuk ka qenë i njëtrajtshëm. Disa nga institucionet shtetërore që funksionojnë më mirë, si Dogana dhe Policia e Kosovës, u krijuan rishtazi dhe u kontrolluan nga UNMIK-u deri në 2008, ndërkohë që ato që janë administruar nga vetë Kosova që prej 2002, si ministritë e shëndetësisë, tregtisë dhe industrisë janë më pak të respektuara. Sidoqoftë, janë institucionet që u përmendën të parat ato që po vihen nën presion vendor për të ndryshuar.

Arkitektura e atyre institucioneve që pritet të ketë një shtet evropian modern është pothuajse e plotë, e megjithatë siç u përmend më lart, strukturat e saj po shtrembërohen nën presionin e brendshëm. Sidoqoftë, sfera publike kosovare është po ashtu e deformuar dhe ka mbetur prapa si pasojë e mangësive të mentorëve të saj ndërkombëtarë: falë grindjeve në lidhje me statusin e Kosovës, mungesës së vullnetit për të hequr dorë nga pushteti për të vendosur vetë, neglizhimit, interesave dhe kufizimeve të personelit ndërkombëtar, si dhe falë shqetësimeve në lidhje me sjelljen e papërshtatshme të institucioneve të Kosovës.

Sponsorët dhe mbikëqyrësit e Kosovës shpesh i kanë dhënë përparësi një stabiliteti afatshkurtër të tipit “mungesa e lajmeve është lajm i mirë” në

<sup>210</sup> Prapa skenës, Ambasada e SHBA i nxitë krerët e KQZ dhe të Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, KZAP, që të vepronin me profesionalizmin dhe paanshmërinë maksimale. Në 19 dhjetor 2009, KZAP vlerësoi se parregullsitë në tre komuna ishin mjaft të përhapura sa të kërkonin një rivotim. KQZ nuk reagoi njëherë; pak ditë më vonë ajo lejoi rivotimet por në rastin e Gjilanit lejoi vetëm rinumërimin. Ambasada e SHBA kërkoi që edhe në Gjilan të bëhej rivotimi, shih deklaratën për shtyp, 23 dhjetor 2009: [http://pristina.usembassy.gov/2009\\_press\\_releases/u.s.-embassy-press-statement-december-23-2009](http://pristina.usembassy.gov/2009_press_releases/u.s.-embassy-press-statement-december-23-2009). Vetëm disa javë më vonë, pasi dështoi në organizimin e rinumërimit, KQZ pranoi që në Gjilan të votohej sërish.

vend që të marrin hapa drejt zhvillimeve të shëndetshme, por që do të hasnin në përplasje. Stabiliteti i Kosovës përbën një “gjeandje të ngrirë”, pra jo një pasqyrim të realitetit në terren, por një investim të stërmadh vullneti politik për të ruajtur stabilitetin. Sponsorët, kryesisht SHBA-të dhe shtetet anëtare të BE-së, e shohin ngatërrimin me këtë investim me kujdes.<sup>211</sup> Në mesin e tyre ka përciptime për Kosovën si një vrimë e zezë e kimit. Në disa raste, mund të kuptohet se pse qytetarët e Kosovës besojnë që ata dojnë që Kosova të mbetet e tillë.

Kosova e ka përvetësuar kulturën UNMIK-ase të parandalimit të krizave<sup>212</sup> dhe agjencitë ndërkombëtare i kanë përshtatur instrumentet e tyre të zhvillimit për të përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike.<sup>213</sup> Në fakt, në vend që shoqëria kosovare të bëhej më perëndimore, mund të thuhet se “prania ndërkombëtare është kosovarizuar”<sup>214</sup> dhe vendimet e saj ishin të motivuara më pak nga parimet sesa nga shqetësimet për interesat e saj vetjake. Pavarësisht transplantimit të gjuhës së të drejtave, prania ndërkombëtare deri diku e ka kufizuar debatin duke ushtruar një lloj shtypjeje qytetëruese dhe duke u përpjekur të krijojë atë që filozofi Zizek e ka pagëzuar komb i “dekafeinuar”.<sup>215</sup>

Mes vetë kosovarëve diskutimet mbi identitetin e shtetit janë zhvilluar nën zë për të mos shqetësuar ndërkombëtarët. Pakoja e pavarësisë e propozuar nga Ahtisaari u prezantua si një dhuratë që duhet ta pranonin dhe ato dhjetëra ligje që përfshiheshin në të u kaluan pa shumë debate, ndërkohë që struktura e saj kushtetuese nuk ishte e rinegociueshme. Në njërin anë, ndonëse sponsorët e Kosovës nuk i kanë përmbushur të gjitha pikat e kësaj pakoje që kishin premtuar: me njohje apo me nënshtrimin ndaj Prishtinës të pjesës veriore të banuar nga serbët, debatet mbi kushtëzimin e zbatimit të saj me marrjen e krejt asaj që ishte

<sup>211</sup> Intervistë, Agron Bajrami, kryeredaktor, *Koha Ditore*, 13 maj 2010.

<sup>212</sup> Intervistë, Haki Abazi, Fondacioni i Vëllezërve Rockefeller, 28 tetor 2009

<sup>213</sup> Intervistë, Mark Poston, ish kreu i DFID për Kosovën, 11 shkurt 2010.

<sup>214</sup> Intervistë, Nexhmedin Spahiu, Drejtor, TV Mitrovica, 10 mars 2010.

<sup>215</sup> Balkan Insight, “Perëndimi preferon Kosovë të dekafeinuar [“The West Wants a Decaffeinated Kosovo”], 8 shtator 2009. Shih: <http://www.balkaninsight.com/en/main/interviews/22067/>

premtuar, ose me opsione të tjera kombëtare siç është shkrija me Shqipërinë apo zyrtarizmi i humbjes së veriut, janë ende tabu.<sup>216</sup> Në anën tjetër, ndonëse shteti multietnik i Ahtisaarit është projektuar për të ruajtur sa më shumë që të jetë e mundur në terma praktikë nga trashëgimia jugosllave e territorit, mjafton që ta gërvishtë pak sipërfaqen për të zbuluar se një gjë e tillë shihet me armiqësi nga grupet që janë të interesuar ta mbajnë një shtet paralel dhe padiskutueshëm të UÇK-së nën sipërfaqe, shtet ky që shërben si mekanizëm mbrojtës për anëtarët e establishmentit të UÇK-së.

Ky aparat paralel ka përkrahje mediale dhe mbështetje nga një formë e shërbimit të inteligjencës. *Infopress* sulmon ashpër çdokënd që perceptohet si kritik i reputacionit të UÇK-së, duke i damkosur si pro-jugosllavë apo pro-Beograd,<sup>217</sup> dhe ka filluar me sulmet ndaj EULEX-it që nga fillimi i hetimeve të ministrit për transport dhe ish-komandantit të UÇK-së Fatmir Limaj.<sup>218</sup>

*Epoka e Re* dhe gazeta *Express* u bashkangjiten, me artikuj të cilët sulmuan karakterin e prokurorit të EULEX-it.<sup>219</sup> Kryeministri Thaçi dhe Limaj kanë pohuar që kanë venë njerëz nën mbikqyrje edhe pse SHIK-u pohoi që është shpërbërë në qershor të vitit 2008<sup>220</sup> dhe Agjencia e Kosovës

<sup>216</sup> Edhe pse lëvizja radikale *Vetevendosje* është kundër kufizimeve të pakos së Ahtisaarit, mediat kryesore dhe politikanët nuk e ngrenë këtë shqetësim. Megjithatë qeveria e ka luajtur kartën e dështimeve të prezencës ndërkombëtare për të nënshtruar serbët në veri sa herë që kjo prezencë ka ushtruar presion mbi të në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Zëvendës kryeministri Hajredin Kuçi e ngriti këtë çështje pas kritikave që iu bënë qeverisë së tij nga Bashkësia Evropiane (BE) në Raportin e Progresit të tetorit 2009 (konferencë e Klubit për Politikën e Jashtme, 16 tetor 2009), dhe kryeministri Hashim Thaçi e ngriti atë sërish pas bastisjes së Ministrisë së Transportit dhe ministrit Limaj nga ana e EULEX-it (intervistë televizive, RTK, 5 maj 2010).

<sup>217</sup> Përgjigje ndaj hulumtimeve nga ana e BIRN mbi qendrat e supozuara të burgosjes së UÇK-së në 1999 në veri të Shqipërisë, prill 2009; *Jeta në Kosovë*, debati mbi lirinë e shprehjes dhe raporti nga terreni mbi punën e komunës Skënderaj, qershor 2009; mbulim nga media liberale e rrëfimit të Nazim Bllacës mbi vrasjet e SHIK-ut, dhjetor 2009.

<sup>218</sup> Kimete Berisha, "Sepata e Tenedit në dorë të Piter Fejtit!", *Infopress*, 11 maj 2010.

<sup>219</sup> Muhamet Mavraj, "Pishpiriku holandez ka gënjyer në 'Koha Ditore'", *Epoka e Re*, 13 maj 2010; artikull i panëshkruar, "Njolla e prokurorit", *Express*, 21 maj 2010.

<sup>220</sup> Kadri Veseli, drejtor i SHIK-ut njoftoi për shpërbërjen në një adresim të inçizuar dhe të transmetuar në lajmet e RTK-së, 14 qershor 2008.

për Inteligjencë ende nuk është funksionale.<sup>221</sup> Thaçi është mburrur me përgjimin e komunikimit të Grupit Ndërkombëtar i Krizave.<sup>222</sup> I pyetur pse ministria e tij i ka thënë gazetarëve të BIRN-it, të angazhuar në hulumtimin e tenderëve për rrugë, që është duke i regjistruar lëvizjet dhe takimet e tyre si dhe dokumentet të cilat i kanë mbledhur, Limaj në një konferencë për shtyp tha që është e drejtë e qeverisë të bën këtë, pasi "Ne jemi shtet".<sup>223</sup> Një formë e strukturës të inteligjencës lokale u shfaq duke e vendosur ndërtesën e EULEX-it nën mbikqyrje pas bastisjeve të misionit në ministrinë dhe shtëpitë e Limaj në fund të prillit 2010.<sup>224</sup>

Diskutimi mbi identitetin fetar të Kosovës i nënshtrohet po ashtu një lloj kufizimi. Identifikimi me botën islamike përbën burimin e një pasigurie dhe sikleti të pashprehur për shumë kosovarë të cilët duan të jenë tërësisht në kampin perëndimor dhe për të cilët SHBA-ja është patroni i domosdoshëm i vendit.<sup>225</sup> Përgjatë gjithë shekullit të njëzetë shqiptarët e Kosovës nuk i vinin shumë rëndësi fesë së tyre. Por, megjithatë, dekada e kontrollit ndërkombëtar ka shërbyer si inkubator i një respekti gjithnjë e më të madh për dimensionin islamik të identitetit të Kosovës dhe është lejuar futja e burimeve nga zonat arabe që shërbejnë për të përforcuar "vahabizmin". Kritikët pretendojnë se varfëria e Kosovës po shfrytëzohet për të blerë

<sup>221</sup> Lumturie Blakaj, "Në AKI, si në Postë, KEK e Aeroporti", *Zëri*, 26 prill 2010.

<sup>222</sup> Intervista, Kryeministri Hashim Thaçi, korrik 2008, tetor 2008.

<sup>223</sup> Konferencë për shtyp, 14 prill 2010.

<sup>224</sup> Një qytetar i Kosovës është ndaluar nga dy burra lokal duke dalur nga ndërtesa, të cilët kërkuan të dinë me kënd është takuar. Intervistë, qytetar, 11 maj 2010. I njoftuar me këtë, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi tha që ai shpesh shkon në ndërtesë të EULEX-it dhe që asnjëherë nuk ka përjetuar probleme të tilla. Intervistë, 20 maj 2010.

<sup>225</sup> Në prag të transmetimit të filmit e Michael Winterbottom "Rruga për Guantanamo" ["The Road to Guantanamo"] në emisionin *Jeta në Kosovë* në gusht 2009, RTK e tërhoqi atë duke iu paraprirë dëshirave të Ambasadës Amerikane. Kryeministri Thaçi ruajti distancën e tij nga konferenca e gushtit 2008 e organizuar nga OJQ-ja Forum 2015 ku do të prezantoheshin intelektualët arabë që ishin ftuar me argumentet në favor të pavarësisë së Kosovës, në mënyrë që të nxitte njohja e Kosovës nga bota arabe. Kryeministri deklaroi se kjo njohje duhej të arrihej "përmes Uashingtonit dhe Brukselit dhe jo përmes adresave të dyshimta". Raportohet se gjatë izolimit të rrezikshëm të viteve 1990 një mazhorancë e shqiptarëve të Kosovës ishte e mendimit se "nevojitet të hiqin dorë nga trashëgimia e tyre islamike, si një hap i parë drejt përfshirjes së tyre në qytetërimin perëndimor dhe drejt homogjenizimit kombëtar. Gjatë viteve 1990, kur situata në Kosovë po përkeqësohej nga dita në ditë, myslimanët shqiptarë po reflektonin në mënyrë të hapur mbi idenë e një konvertimi masiv në katolicizëm... feja e të parëve tanë!" Shkëlzen Maliqi, "Kosova: Botë të ndara", ["Kosova: Separate Worlds"], Dukagjini: Prishtinë, 1998, fq. 52.



të konvertuarit për këtë rrymë radikale.<sup>226</sup> Ekziston një polarizim mes besimtarëve dhe pjesës tjetër të shoqërisë. Janë të shumtë ata që besojnë se identiteti i tyre po kërcënohet nga “energja e errët” që emeton prezenca gjithnjë e më e madhe e burrave të rinj me mjekër dhe e grave të mbuluara,<sup>227</sup> të cilët pastaj nga ana e tyre ndihen të demonizuar prej kësaj.

Reagimet e forta, duke përfshirë kërcënimet nga besimtarët, kanë bërë që të mos ketë një mbulim mediatik apo diskutim adekuat të kësaj çështjeje.<sup>228</sup> Mund të ketë pasur edhe sulme fizike.<sup>229</sup> Nga ana tjetër, shumë kosovarë e mbështesin shtypjen e të drejtave të këtyre besimtarëve: mbylljen me forcë të xhamisë së Marinës në mars 2010 dhe dëbimin e imamit të saj nga vendi pa zhvilluar ndonjë gjyq; përjashtimin e vajzave nga shkollat sepse mbajnë perçe.<sup>230</sup> SHIK-u e ka shitur veten tek homologët e tij perëndimor si një monitorues i islamit radikal.<sup>231</sup> Në mënyrë private, autoritetet kosovare ankohen se interesi i agjencive perëndimore të inteligjencës për të

vëzhguar aktivitetet e islamikëve nuk u lejon atyre që ta zhdukin atë.<sup>232</sup>

Kontributi i prezencës ndërkombëtare ndaj ligjit në Kosovë është po ashtu thikë me dy teha. UNMIK-u krijoi një strukturë dhe procedurë të mirë të ligjit penal, por “bllokoi ligjet e pronësisë dhe ligjet administrative që nuk i interesonin”,<sup>233</sup> vonoi masat që supozoheshin të forconin sistemin e dobët gjyqësor të Kosovës dhe nuk ka njohur asnjë ligj që është kaluar në Kosovë që prej deklarimit të pavarësisë në shkurt 2008. Ekipi Përgatitor i ICR kontribuoi ndaj ligjeve të Ahtisaarit dhe kushtetutës me një ekspertizë shumë të rëndësishme në përpilimin e ligjeve, e megjithatë partneri i tij, EULEX-i i mandatuar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB, kufizohet nga pozicioni i UNMIK-ut, dhe ka një qasje fragmentare ndaj miratimit të ligjeve të kaluara pas shkurtit të 2008.

Ndonëse trupat gjyqësore të përbëra nga gjykatës të EULEX-it dhe gjykatës kosovarë ishin projektuar si një hap kalimtar, që kishte për synim t’ua kalonte eventualisht përgjegjësinë për rastet sensitive këtyre të fundit, një gjykatës kosovar për arsye sigurie e ka distancuar tanimë veten nga marrja e vendimit për një rast gjyqësor të rëndësishëm<sup>234</sup> dhe duket sikur përreth EULEX-it po krijohet një kulturë e varësisë gjyqësore. Padia e ngritur nga misioni kundër aktivitetit radikal Albin Kurti për udhëheqjen e demonstruesve në 2007, dy prej të cilëve u vranë nga forcat policore rumune të UNMIK-ut,<sup>235</sup> një njësi që prej asaj kohe është bërë pjesë e EULEX dhe pjesëtarët e së cilës nuk janë përballur me asnjë pasojë, përbën një ilustrim të pakëndshëm të enklavës ligjore ku ndodhet sot Kosova. Ajo është e izoluar nga sistemi ndërkombëtar i të drejtave të njeriut, duke përfshirë mungesën e të drejtës së ankimit tek Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe

<sup>226</sup> Ka një mendim të përhapur se të konvertuarit në vahabizëm marrin një pagesë mujore prej 300 eurosh. Intervistë, Ilir Deda, Drejtor, KIPRED, 16 prill. Shih Isa Blumi, “Politika islame ndër Shqiptarët: A janë duke ardhur talibanët në Ballkan? [“Political Islam Among the Albanians: Are the Taliban coming to the Balkans?”] KIPRED, botimi i dytë 2005:

[http://www.ssrnetwork.net/document\\_library/detail/3795/political-islam-among-the-albanians-are-the-taliban-coming-to-the-balkans-2nd-edition](http://www.ssrnetwork.net/document_library/detail/3795/political-islam-among-the-albanians-are-the-taliban-coming-to-the-balkans-2nd-edition).

<sup>227</sup> Intervistë, Ilir Deda, Ibid.

<sup>228</sup> RTK ka marrë kërcënime të tilla. Intervistë, menaxhmenti i RTK-së, 2004-5. Bashkësia Islame në Kosovë ka kërkuar që të mos transmetohet një debat i *Jeta në Kosovë*.

<sup>229</sup> Një email anonim dërguar mediave merrte përsipër përgjegjësinë për plagosjen me thikë në prill 2010 të komedianit Rasim Thaçi “Cima”, duke deklaruar se sulmi ishte motivuar nga talljet që i bënte ai fesë myslimane. Zëdhënësi i Bashkësisë Islame e dënoi sulmin por paralajmëroi se liria e fjalës nuk përfshinte lirinë për të fyer ndenjat e të tjerëve. Kastriot Jahaj, “Ekstremiste islamike marrin përsipër sulmin ndaj Cimës”, *Koha Ditore*, 16 prill 2010. Thuhet se një anëtar i qeverisë është sulmuar në rrugë, në Prishtinë, nga disa burra islamikë, por kjo nuk u raportua policisë. Intervista, BIRN, mars-prill 2010.

<sup>230</sup> Mediat i dhanë një mbulim të papërfillshëm një marshimi përmes Prishtinës në 7 maj 2010 nga disa qindra njerëz që po protestonin për dëbimin e vajzave nga shkollat sepse mbajnë shamija, dhe në mënyrë specifike për rastin e një vajze adoleshente që ishte përjashtuar nga shkolla teknike në Ferizaj. Në një rast në Viti, e drejta e një vajze për tu kthyer në shkollë u mbështet nga gjykata rajonale, por u bllokua nga drejtoria arsimore e komunës, duke cituar një urdhër administrativ të Ministrisë së Arsimit të 2009. Kastriot Jahaj, “MASHT-i konteston vendimin e Gjyqit të Qarkut”, *Koha Ditore*, 9 maj 2010.

<sup>231</sup> Intervistë, ish zyrtar amerikan, shkurt 2006.

<sup>232</sup> Intervista të BIRN, mars-prill 2010.

<sup>233</sup> Intervistë, Kujtim Kërveshi, ish këshilltar i Ministrisë së Drejtësisë, 25 shkurt 2010.

<sup>234</sup> Pasi u kërcënua, gjykatësi Retkoceri e denoncoi vendimin që ishte dhënë në gjyqin e dytë të “Grupit të Llapit” duke pretenduar se ai ishte rrëzuar me votë nga dy kolegët e tij të EULEX-it. Ai u pezullua.

Vehbi Kajtazi, “Gjykatësi Rrahman Retkoceri pohon të jetë kërcënuar”, *Koha Ditore*, 8 tetor 2009.

<sup>235</sup> Shih Krenar Gashi dhe Jeta Xharra, “Protesta në Prishtinë kundër planit të OKB-së bëhet e përgjakshme” [“Protest Against UN Plan Turns Bloody in Pristina”], *Balkan Insight*, 12 shkurt 2007.

<http://kosovo.birn.eu.com/en/1/70/2300/>

shqyrtimin nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut i OKB.<sup>236</sup>

EULEX-i me fuqitë e tij ekzekutive zyrtare dhe me frymën e dorëzimit të përgjegjësive që kjo simulon në policinë dhe sistemin gjyqësor të Kosovës, ka një monopol mbi organizimin e hetimeve mbi korrupsionin në nivelet e larta, mbi krimin e organizuar dhe krimet e luftës. Tani që edhe Brukseli në Raportin e Progresit të BE-së të tetorit 2009 alarmonte në lidhje me përfshirjen e qeverisë në afera korruptive dhe në krimin e organizuar, veprimet ose mungesa e veprimeve nga ana e EULEX-it do të jenë përcaktuesi kryesor i drejtimit që do të marrë Kosova.

Alarme të këtij lloji kanë rrënjësuar në shoqërinë kosovare konceptin e “mëkatit origjinal” dhe për këtë fakt, dështimi për të vepruar nga ana e EULEX-it në 2009 dhe në fillim të 2010 e bënë të pamundur shfaqjesimin. Misioni dukej shumë i përqendruar në proceset e tij të brendshme<sup>237</sup> dhe u tregua i ngathët për të kuptuar se vonesa e veprimit apo mungesa e veprimit, qoftë në rastin kur kjo vinte si pasojë e mungesës së kapaciteteve apo pengesave politike, automatikisht mbrojnë dhe ushqejnë korrupsionin.<sup>238</sup> Shoqërinë civile të Kosovës filloi ta kapte dëshpërimi: “Koha e UNMIK-ut krijoi korrupsion; koha e EULEX/ICO ka krijuar një mafi”.<sup>239</sup> Kalendarin dukej si i bllokuar nga ngjarjet dhe datat e rëndësishme (që lidhen me garantimin e statusit ndërkombëtar të Kosovës) të cilat shërbenin si argumente kundër ndërmarrjes së masave të vendosura.<sup>240</sup>

Disa prej diplomatëve të Kuintit i shihnin me bezdi storiet e botuara në shtypin kosovar mbi një

<sup>236</sup> Komiteti i të Drejtave të Njeriut ende i merr në konsideratë raportet që bënë UNMIK-u. Një sugjerim që u bë në takimin e Komitetit në 29 korrik 2009 për t’iu përgjigjur korrespondencës të marrë nga qeveria e Kosovës, nuk u mbështet dhe Komiteti vendosi të verifikonte pozicionin e OKB-së në lidhje me statusin e Kosovës dhe ta rishqyrtonte situatën në pjesën e dytë të 2010. Shih: [http://www.unog.ch/unog/website/news\\_media.nsf/\(httpNewsByYear\\_en\)/201DB71C1FFB8FB6C1257602003D5221?OpenDocument](http://www.unog.ch/unog/website/news_media.nsf/(httpNewsByYear_en)/201DB71C1FFB8FB6C1257602003D5221?OpenDocument).

<sup>237</sup> Në përvjetorin e saj të parë, ajo e quajti raportimin e saj mbi gjendjen e policisë dhe të sistemit gjyqësor në Kosovë si një arritje të shënuar.

<sup>238</sup> Në shkurt 2010 një takim në të cilin OJQ-të kosovare e nxitën menaxhmentin e EULEX-it për të vepruar kundër korrupsionit zyrtar, përfundoi me keqkuptime dhe frustrime reciproke.

<sup>239</sup> Intervistë, Safet Gërxhaliu, Nënkretar, Oda Ekonomike e Kosovës, 18 nëntor 2009.

<sup>240</sup> Intervistë, zyrtarë, Agjensioni Kundër Korrupsionit, 15 dhjetor 2009.

ministër që akuzohej për korrupsion (që tani është zbuluar se ishte Fatmir Limaj, ministri i transportit dhe telekomunikacionit) të cilin SHBA po mudohej ta bindte që të dorëhiqej pa shumë zhurmë dhe të largohej në ndonjë pozicion jashtë vendit: “Ky nuk është momenti për kryqëzata.”<sup>241</sup> Ndonëse storiet e botuara në shtyp raportonin se ICR Peter Feith po ngulte këmbë që ministri të largohej<sup>242</sup> dhe ndonëse burimet e këtyre shkrimeve ishin të mira,<sup>243</sup> SHBA lëshoi një deklaratë në emër të Kuintit që dukej sikur hidhte poshtë një pjesë të asaj çka ishte raportuar.<sup>244</sup> Kjo atmosferë, në të cilën edhe vetë zyrtarët e lartë ndërkombëtarë po përdornin kalimin anonim të informacionit tek mediat për të përçarur mesazhin e tyre, vetëm për të parë sesi ky mesazh hidhej poshtë nga homologët e tyre diplomatë, nuk favorizonte fare përfshirjen e qytetarëve të Kosovës në përpjekjet kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Mënyra e mbyllur dhe lakonike e EULEX-it, si dhe dëshira e etshme për ta projektuar veten si një mision “teknik” bëri që arena publike të mbetej nën kontrollin e “peshqëve të mëdhenj” të asaj qeverie që ishte duke u hetuar.<sup>245</sup> Në maj 2009, Limaj parandaloi raportimet në media mbi të afërmit e tij që ishin kapur në kufi duke u përpjekur të nxirrin miliona euro jashtë Kosovës.<sup>246</sup> Një vit më vonë, pasi rekomandimet e zyrtarëve ndërkombëtarë në prapaskenë për largimin e tij nga qeveria thuajse u hodhën poshtë

<sup>241</sup> Intervistë me dy ambasadorë të Kuintit, 12 mars 2010. Shih po ashtu Arben Ahmeti, “EULEX-i nuk u pajtua për ‘ekstradimin’ e Limajt”, *Koha Ditore*, 3 maj 2010.

<sup>242</sup> Arben Ahmeti, “Feith kërkoi largimin e ministrit të dyshuar për korrupsion”, *Koha Ditore*, 12 mars 2010.

<sup>243</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2010.

<sup>244</sup> Lawrence Marzouk, “Kuinti mohon të ketë kërkuar dorëheqjen e dikujt në qeverinë e Kosovës” [“Quint Denies it Demanded Kosovo Govt Sacking”], *Balkan Insight*, 12 mars 2010: <http://www.balkaninsight.com/en/main/news/26560/>.

<sup>245</sup> Ky term u fut në leksikonin e Kosovës pasi një gazetar e pyeti kryeprokurorin e asaj kohe të EULEX-it Theo Jacobs në 3 nëntor 2009 mbi përpjekjet e EULEX-it për të kapur “peshqit e mëdhenj”, të cilës ai iu përgjigj se brenda disa muajsh disa hetime interesante mbi korrupsionin do të jepnin rezultate. Si pasojë e humbjes së durimit, në mars 2010 OJQ-ja Klubi për Politikën e Jashtme porositi një ilustrim të ICR dhe të shefit të EULEX-it si të frikësuar nga peshqit e mëdhenj: <http://periskopi.com/en/3/>.

<sup>246</sup> Në një reagim mediatik emocional, në të cilën ai përmendi luftën e gruas së tij me kancerin, paralizën e të atit dhe shkrimin në spital të nënës së tij dhe ai ia vuri fajin Serbisë dhe atyre që janë xhelozë për sukseset e tij dhe të Kosovës për raportet. Ai kërkoi që familja e tij të mos prekej politikisht. Salie Gajtani-Osmankaq, “Ministri Limaj reagon në mbrojtje të familjes”, *Koha Ditore*, 14 maj 2009.

me rikompozimin e qeverisë në prill 2010, Limaj u angazhua në një sërë shfaqjesh televizive, firmosi një kontratë prej 700 milion eurosh me konsorciumin e udhëhequr prej kompanisë amerikane Bechtel për ndërtimin e një autostrade për në Shqipëri, duke e promovuar këtë si një kauzë patriotike me një fushatë me postera. Kryeministri e ka kthyer tanimë në një praktikë të tijën kërkesën që hetimet penale serioze që prekin aleatët e tij të mos politizohen, të mos paragjykojnë apo dhe të mos komentohen, ndërkohë që i njeh vetes dhe mbështetësve të tij të drejtën për të bërë pikërisht këtë gjë.<sup>247</sup> Ai e bëri këtë në rastin e Bllacës, teksa shefi i misionit EULEX rrinte pranë tij si në gjemba në dhjetor 2009 dhe provoi ta bënte sërish në një dalje televizive një javë pas bastisjeve të datës 28 prill 2010 nga ana e EULEX-i në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, në shtëpitë e Ministrit Limaj, të vëllait dhe disa të tjerëve.<sup>248</sup>

Pas këtyre bastisjeve dinamikat e arenës publike kanë ndryshuar radikalisht. E shokuar nga ajo që kishte ndodhur, fillimisht qeveria dha sinjale se do të bashkëpunonte me hetimet e EULEX-it. Pastaj kryeministri Thaçi dhe ministri Limaj e shmangën median për një javë të tërë, duke mos e kundërshtuar mbulimin dhe analizat e mëtejshme të kritikëve si *Koha Ditore*. Shfaqja televizive e kryeministrit ishte pjesë e një përpjekjeje nga ana e qeverisë dhe aleatëve të saj për të bashkuar forcat dhe për ta ndalur këtë tendencë, si dhe për t'i paraqitur bastisjet si të padrejta, një "linçim" i motivuar politikisht i një ministri dhe një "shou mediatic".<sup>249</sup> Të mësuar me heshtjen e EULEX-it

<sup>247</sup> Kur filloi rigjykimi i ish komandantit të UÇK-së "Remi" Mustafa dhe dy bashkëpunëtorëve të tij për krime lufte, kryeministri Thaçi deklaroi: "Ne besojmë plotësisht në pafajësinë e tyre dhe në luftën e drejtë që ka bërë UÇK-ja dhe populli i Kosovës. Qeveria e Kosovës ka besim të plotë tek autoritetet gjyqësore, ashtu siç ka besim në pafajësinë e bashkëluftëtarëve tanë. Ne si institucione të Kosovës kemi besim të plotë se ata do të lirohen si të pafajshëm që janë". Lajmet e RTK, 7 korrik 2009. Më vonë ai e quajti dënimin e tyre "një lajm të keq për Kosovën". Në dhjetor 2009, zëdhënësi i tij Memli Krasniqi lajmëroi se deklaratat e Bllacës ishin false, ndërkohë që Thaçi i quajti ato veprime mirë të koordinuara dhe që synojnë të dëmtojnë sigurinë e Kosovës.

<sup>248</sup> Intervistë televizive 30 minutëshe, RTK, 5 maj 2010. E disponueshme online në: <http://www.rtklive.com/>

<sup>249</sup> Një javë më pas ministri Limaj u rishfaq për të dhënë një intervistë të ngjashme në RTK. 13 maj 2010. Ai ishte më i sjellshëm me EULEX sesa kryeministri dhe u fokusua në përpjekjet për të bindur publikun për integritetin e tij. Megjithatë, në këtë kohë, dy gazetave mbështetëse të qeverisë iu dha drita jeshile për të ndër marrë sulme personale kundër ICR Peter Feith dhe Kryeprokurorit të EULEX

përballë taktikave të tilla, ata nuk mund ta kenë parashikuar se kryeprokurori i EULEX-it, Johannes van Vreeswijk do t'u jepte një përgjigje kaq të shpejtë dhe dërmuese. Kryeprokurori i hodhi poshtë publikisht komentet e kryeministrit si injorante dhe "fëmijore", tha se ishin keqpërdorur me miliona euro, paraqiti në vija të përgjithshme aktakuzat që do të ngriheshin dhe për të cilat ministri Limaj dhe shefi i tij i prokurimeve mund të dënohen deri me 55 vjet burg dhe tha se po hetoheshin edhe gjashtë zyrtarë të tjerë të lartë për korrupsion dhe lidhje me krimin e organizuar.<sup>250</sup>

Prononcimi i kryeprokurorit van Vreeswijk sinjalizoi një sfidë të mëtejshme ndaj status quo:

"Korrupsioni është krim sekret. Bëhet nga një grup i caktuar dhe është i vështirë të detektohet... Nga ky krim pastaj vijnë kërcënimet e njerëzve, frikësimi i tyre. Këta njerëz duhet ta kuptojnë se edhe vetë mënyra sesi i frikësojnë të tjerët është krim në vete..... Unë u bëj thirrje të gjithë atyre që kanë lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin se duhet të fillojnë të dënohen....Ne po punojmë për këtë vend. Po punojmë për të mbrojtur qytetarët, në mënyrë që gjetja e në vendi pune të mos varet më nga partitë politike, që qytetarët të mos ndihen të frikësuar dhe të kërcënuar në këtë vend. Kjo është e papranueshme për ne. Këtu do të respektohet qytetari. Shumë qytetarë këtu janë të frikësuar. Më ka ardhur në majë të hundës një situatë e tillë."<sup>251</sup>

Duket sikur veprimi i EULEX-it e ka prishur konsensusin që ekzistonte mes kujdestarëve ndërkombëtarë të Kosovës. Bastisjet ishin një tregim force nga ana e strukturës zyrtare të mbikëqyrjes evropiane dhe ka prerë strategjinë

Johannes van Vreeswijk. Pa dhënë asnjë lloj prove, *Infopress* tha se Feith dhe EULEX ishin të motivuar nga hakmarrja në emër të një kompanie evropiane që kishte humbur tenderin ndaj konsorciumit Bechtel të kryesuar nga amerikanët për ndërtimin e autostradës. Gazeta e krahasoi sjelljen e policisë së EULEX gjatë bastisjes së ministrisë me atë të nazistëve që mblidhnin hebrejtë për dhomat e gazit. Kimete Berisha, "Sepata e Tenedit në dorë të Piter Fejit!" *Infopress*, 11 maj 2010.

<sup>250</sup> Intervistë në gazetë, Arben Ahmeti, "EULEX: Kemi fakte për miliona të keqpërdorura", *Koha Ditore*, 7 maj 2010.

<sup>251</sup> Intervistë në gazetë, Arben Ahmeti, *Ibid*.

dalëse që SHBA ka hartuar për Limën.<sup>252</sup> SHBA kanë qenë të shtyrë nga shqetësimi për efektin që mund të ketë padia e një ministri të fuqishëm në stabilitetin politik të Kosovës.<sup>253</sup> Në mënyrë paradoksale, shqetësimi më i madh që po tregojnë evropianët për integritetin e institucioneve kosovare mund të rezultojë në turpërimin e shtetit të ri, pasi potencialisht mund të sjellë ngritjen e aktakuzave për korrupsion ndaj disa personave në nivelet e larta të qeverisjes.<sup>254</sup> Edhe pse mund të ketë hezitim në Bruksel, EULEX-i ka thënë që arrestimi do të bëhet shumë shpejt dhe ka ndërmarrë një kontrollim të valixheve të të kryeministrit Thaçi dhe të disa ministrave të tij para se të hipin në aeroplan për një vizitë në Turqi me 19 maj.<sup>255</sup> Është qartë që ambasada e SHBA-së nuk ndihet rahat me situatën në zhvillim. Me 14 maj, ambasadori Dell argumentoi që korrupsioni më së miri luftohet përmes reformës strukturore të ekonomisë në vend se sa me ndjekjen e individëve.<sup>256</sup>

Së bashku, ICR me fuqitë e saja zyrtare, por deri tash të papërdorura, për të larguar zyrtarët që shkelin planin e Ahtisaarit, dhe SHBA e ambasadat e tjera të Kuintit që ushtrojnë një pushtet jozyrtar, shërbejnë si zëvendësues të forcës korrigjuese të opinionit publik dhe shoqërisë civile mbi qeverinë: duke vënë veton në emërimet e papërshtatshme publike,<sup>257</sup> duke mbrojtur profesionistët në institucionet publike që tani gjenden në situatë të vështirë,<sup>258</sup> dhe duke reduktuar sjelljet e papranueshme. Nëse nuk do të

<sup>252</sup> Qasja e SHBA-ve të kujtonte një incident kriminal që ndodhi dhjetë vjetë më parë dhe ku ishte i përfshirë një tjetër ish udhëheqës politik i UÇK-së, në të cilën SHBA, dhe përfaqësia e saj diplomatike në Kosovë, e kryesuar asokohe dhe tash nga Christopher Dell, nuk e respektuan shumë sundimin e ligjit. Kreu i AAK-së Ramush Haradinaj u plagos në një përplasje me armë. Zyrtarët amerikanë e nxorën atë jashtë vendit dhe thuhet se zhdukën provat nga skena e krimit. Shih Nick Wood, "SHBA 'mbuloj' për aleat të Kosovës" ["US 'covered up' for Kosovo ally"], *The Observer*, 10 shtator 2000: <http://www.guardian.co.uk/world/2000/sep/10/balkans.internationalcr ime>

<sup>253</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2010.

<sup>254</sup> Mes zërave se shënjestra e këtij hetimi u kishte thënë kolegëve se ai nuk do të pranonte të rrëzohej i vetëm, komenti i ministrit Limaj mbi bastisjen e 28 prillit ishte se puna e ministrisë së tij "nuk ndryshonte" nga puna e çdo ministrie tjetër. Kohanet, 1 maj 2010.

<sup>255</sup> Lajmet Klan Kosova, 20 maj 2010.

<sup>256</sup> "Receta e Dellit", *Express*, 15 maj 2010.

<sup>257</sup> Këtë gjë e bëri me kreun e mëparshëm të Administratës Tatimore dhe me disa pjesëtarë të bordeve të ndërmarrjeve publike.

<sup>258</sup> Kreu i Doganave, Naim Huruglica është parë si i cenushtëm që prej 2008, kur ai u pezullua përkohësisht nga qeveria. Shih Arben Hyseni, "Dosti i Acdes", *Express*, 9 prill 2010.

kishte qenë kjo ndërhyrje, vetë shoqëria e dobët civile kosovare do të dështonte në mbrojtjen e ngrehinës së shtetit të ri.<sup>259</sup>

Sidoqoftë, ndërmjetësimi i diplomatëve ka bërë që shoqëria civile të vazhdojë të jetë e dobët dhe të vuajë nga kjo varësi; ndërhyrjet e diplomatëve janë më selektive se çdo të mund të ishin ato të aktorëve të brendshëm dhe në çdo rast diktohen nga prioritetet dhe interesat e tyre, që nuk përputhen gjithnjë me prioritetet dhe interesat e Kosovës. Deri sa ndodhën bastisjet e 28 prillit 2010 që e ndryshuan dinamikën, zgjidhja që kishin planifikuar Shtetet e Bashkuara për Fatmir Limajn (sa do dashamirëse motivet e saj) parashikonte shpërnguljen e tij në një shtet tjetër, ndalimin e mbulimit mediatic dhe mbajtjen e të gjithë çështjes brenda diskrecionit të diplomatëve.<sup>260</sup> Kjo përputhej po ashtu me interesin e SHBA-së në garantimin e nënshkrimit të Limajt për kontratën 700 milion eurosh me Bechtelin. Por, Kuinti e modifikon opinionin publik edhe në mënyrë më pak të rëndësishme: një deklaratë e shpejtë nga ambasada amerikane që lëvdoi zhvillimin e zgjedhjeve lokale të nëntorit 2009 ndikoi tek OJQ-ja Demokracia në Veprim që t'u jepte këtyre zgjedhjeve një notë më të lartë: "4 në vend të 3" (ose B në vend të C).<sup>261</sup>

Ndërmjetësimi i diplomatëve e filtron demokracinë në Kosovë edhe pse e bën këtë në një mënyrë më pak të ndjeshme sesa në kohën e UNMIK-ut: partitë që grindeshin me njëra tjetrën kishin nevojë për administratorin e OKB-së për të negociuar koalicionin e parë qeverisës në 2002 dhe pastaj SHBA dhe BE u përpoqën në mënyrë të pasuksesshme të detyrojnë LDK-në, e cila fitoi zgjedhjet e 2004, që t'ia jepte postin e kryeministrit PDK-së që i kishte humbur zgjedhjet. Që nga ajo kohë, partitë janë lënë që të vendosin vetë mbi koalicionet qeverisëse: në fakt kur PDK-ja i kërkoi ambasadës amerikane në nëntor 2009 që ta ndihmonte për të ndryshuar partnerët e saj të koalicionit, në mënyrë të arsyeshme kjo e fundit refuzoi të ndërmjetësonte. Sidoqoftë, ambasada duket se i bazon shumë prej

<sup>259</sup> "Sikur të mos ishin ambasadat e SHBA-ve dhe të Britanisë së Madhe do të kishte luftë civile brenda muajit." Intervistë, burim i Policisë së Kosovës, 3 dhjetor 2009.

<sup>260</sup> Intervista, vëzhguesë nga afër, mars dhe prill 2010.

<sup>261</sup> Intervistë, Valmir Ismaili, Demokracia në Veprim, 18 mars 2010.

vendimeve të saj tek pikëpamjet që ka në lidhje me atë se cilat forca politike janë të afta për të qeverisur me vendin. Manovrat e saj për të shmangur padinë e EULEX-it kundër një ministri të rëndësishëm të PDK-së reflektojnë skepticizmin e SHBA-ve se për momentin askush, përveç PDK-së, nuk është i aftë për të qeverisur, si dhe shqetësimin e saj për të ruajtur stabilitetin e kësaj partie. SHBA e ka zvogëluar kontributin e saj ndaj EULEX-it dhe ka nisur një mision të veçantë për sundimin e ligjit (ICITAP).<sup>262</sup>

Mozaiku i OJQ-ve urbane, që e quajnë veten shoqëria civile e Kosovës, varet nga financimet e donatorëve ndërkombëtarë, ka një orientim përëndimor liberal dhe gjithnjë e më shpesh po bën lobim me prezencën ndërkombëtare që të mos bën kompromise në hetime mbi korrupsionin.<sup>263</sup> Po ashtu, shoqëria civile e sheh veten në konkurrencë me qeverinë për mbrojtjen që ofron prania ndërkombëtare dhe s'ka rrugë tjetër po veç t'u drejtohet "ndërkombëtarëve" kur institucionet vendase dështojnë në ofrimin e mbrojtjes. Kur prokuroria e shtetit refuzoi të vepronte në lidhje me sulmet dhe atë që dukej si kërcënim me vdekje kundër prezantueses së *Jeta në Kosovë*, Jeta Xharrë nga ana e *Infopress*,<sup>264</sup> dhe kur një letër e dërguar nga 25 OJQ vendase dhe 80 individë që iu dërgua qeverisë dhe të gjithë deputetëve të kuvendit nuk pati ndonjë efekt, ajo dhe kolegët e saj të BIRN-it iu drejtuan ndërkombëtarëve. *Infopress* e quajti atë "ambasadë-horr".<sup>265</sup> ICR dhe Komisioni Evropian shprehën mbështetjen por jo edhe Ambasada Amerikane.<sup>266</sup> OJQ-të dërguan një letër të dytë të përbashkët proteste mbi pamjaftueshmërinë e deklaratës së qeverisë të datës 10 qershor, për të cilën një pjesëtar i qeverisë zbuloi se ishte përpiluar nga ambasada amerikane.<sup>267</sup>

<sup>262</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 19 prill 2010.

<sup>263</sup> Klubi për Politikë të Jashtme, letra të hapura për Zëvendës Sekretarin e Shtetit Steinberg dhe Përfaqësuesen e Lartë të BE, Catherine Ashton, op. cit.

<sup>264</sup> Kur takoi përfaqësuesit e *Jeta në Kosovë* prokurori përmendi frikën e tij se do të bëhej shënjestra e radhës e *Infopress-it* nëse e hetonate këtë rast. Intervistë, Jeta Xharrë, qershor 2009.

<sup>265</sup> Ramiz Shala, "Lufta për 'ambasadë-horr'", *Infopress*, 5 qershor 2009.

<sup>266</sup> Ambasada refuzoi të takohej me të dhe u duk sikur mbajti anën e qeverisë, më pas duke udhëzuar kundër *Jeta në Kosovë*. Burimet: telefonata me ambasadën të dëshmuara nga NDRNJ, emaili i parë nga NDRNJ.

<sup>267</sup> Deklarata fliste në mënyrë të përgjithshme për lirinë e shprehjes, ndërkohë që dështoi të përmendte rastin specifik apo të dënonte

Megjithatë, kjo ambasadë kyçe e ka nuancuar politikën e saj, që perceptohej nga disa si një ujdë e pashprehur që i lejonte qeverisë të kishte kontrollin mbi çështjet e brendshme në këmbim të kujdesit dhe fleksibilitetit në trajtimin e serbëve, të veriut gjysmë të ndarë të Kosovës dhe të Beogradit.<sup>268</sup> Potezat e kësaj ambasade në muajt e fundit përfshinin ndryshimin e qëndrimit të saj ndaj *Jeta në Kosovë*, duke e lëvdur prezantuesen e programit dhe duke i bindur menaxherët që i bënë lajka qeverisë në RTK që ta kthenin mbrapsht refuzimin e tyre për të transmetuar debatet e zgjedhjeve lokale të vjeshtës 2009 të këtij programi.<sup>269</sup> Ambasada i dënoi pa humbur kohë tabelat false të rrugëve (Rruga UDB – Veton dhe Flaka Surroi) të vendosura në muret e qendrës së Prishtinës që sugjeronin se pronarët e *Koha Ditore* dhe KTV ishin spiunë serbë.<sup>270</sup> Ajo gjithashtu kërkoi që Komisioni Qendror Zgjedhor t'i përsëriste zgjedhjet në të tre komunat ku numërimi shkoi keq, siç ishte propozuar nga organi i apelimit të çështjeve zgjedhore.<sup>271</sup> Në fillim të 2010 ajo sugjeroi se "pjekuria" e Kosovës do të ishte fjala e re kyçe, e cila e tejkalon rëndësinë e asaj që kishte qenë prioritet i dy viteve të fundit, "stabiliteti", dhe shprehën brengosje që qeveria po luante një rol shumë të madh se që dëshirohet në fushën e ekonomisë.<sup>272</sup>

Megjithatë, qeveria e Kosovës duket ende e paafte të negociojë me kujdestarët e saj ndërkombëtarë dhe të krijojë një partneritet të mirëfilltë. Ajo ose kërkon, ose pret apo pranon mikromenaxhim, pasi

*Infopress*-in. Komentet në lidhje me autorësinë e deklaratës për shtyp iu dhanë Jeta Xharrës nga një zyrtar i lartë i qeverisë, qershor 2009.

<sup>268</sup> Disa editoriale në *Koha Ditore* kanë shprehur këtë mendim gjatë 2009.

<sup>269</sup> Letra e ambasadës për RTK thoshte se ajo ishte "krejtësisht e zhgënjyer" me vendimin e RTK-së. Prandaj RTK e ndërroi atë. Intervista, BIRN, tetor 2009.

<sup>270</sup> Kështu bëri edhe qeveria. Shih prononcimin për shtypin të Ambasadës Amerikane.

[http://pristina.usembassy.gov/press\\_releases/2010-press-releases/statement-of-ambassador-christopher-dell-may-13-2010.html](http://pristina.usembassy.gov/press_releases/2010-press-releases/statement-of-ambassador-christopher-dell-may-13-2010.html). Kjo shënonte një ndryshim të madh në krahasim me heshtjen e ambasadës në lidhje me fushatën e sulmeve kundër Jeta Xharrës në qershor 2009. Një vit më parë Ambasada amerikane kishte dërguar një mesazh të qartë duke i lënë Surroin dhe Xharrën jashtë listës së të ftuarve për pritjen e 4 korrikut, e cila përbën një ngjarje të rëndësishme në kalendarin shoqëror të Kosovës.

<sup>271</sup> Prononcim për shtyp i Ambasadës së SHBA, 23 dhjetor 2009. [http://pristina.usembassy.gov/2009\\_press\\_releases/u.s.-embassy-press-statement-december-23-2009](http://pristina.usembassy.gov/2009_press_releases/u.s.-embassy-press-statement-december-23-2009).

<sup>272</sup> Ambasadori Christopher Dell, i intervistuar nga *Jeta në Kosovë*, 18 shkurt 2010.

i mungojnë kapacitetet për të vendosur prioritetet e veta apo merr një qëndrim refuzues që si pasojë mund të sjellë poshtërimin e saj: siç ka ndodhur me protokollin policor mes EULEX-it dhe Beogradit në shtator 2009 dhe me bastisjet në Ministrinë e Transportit në prill 2010.

## EKONOMIA POLITIKE DHE STANDARDI I JETESËS

Historikisht, sfera publike, kjo arenë ku qytetarët mund të angazhohen lirisht për të formësuar opinionin publik, duke ndikuar kështu veprimet e qeverisë, u bë e mundur falë shfaqjes së një morie faktorësh të pavarur ekonomikë, të cilët filluan të mos vareshin më nga ndonjë monark apo hierarki feudale.<sup>273</sup>

Vendet ish komuniste që kanë qenë më të suksesshme në tranzicionin nga ekonomitë e centralizuara e të komanduara kanë tërhequr shumë Investime të Huaja të Drejtpërdrejta (IHD) dhe kanë lejuar që të shfaqet një diversitet kompanish; presionet për reforma ligjore dhe administrative nga ana e tyre janë bërë të qëndrueshme falë këtij komponenti të diversifikuar dhe gjithnjë në rritje.<sup>274</sup> Një shoqëri e fortë civile zakonisht i ka rrënjët në një shoqëri komerciale, e cila ka interes në krijimin e ndryshimeve dhe në ruajtjen e një tensioni të butë me botën politike.<sup>275</sup>

Por, asgjë nga këto nuk po ndodh në Kosovë: Investimet e Huaja të Drejtpërdrejta janë të pakta dhe po vijnë duke u pakësuar edhe më tej,<sup>276</sup> ekonomia dominohet nga numër të vogël të kompanish private dhe publike, të cilat janë të lidhura me elitën politike dhe pronësia mbi asetet kyçe duket sikur po vjen duke u ngushtuar e jo duke u diversifikuar.<sup>277</sup> Gjatë përgatitjeve për

privatizimin e shërbimeve të telekomit, PTK-së, dhe të energjisë, KEK-ut, si dhe gjatë projekteve për autostradën Vermicë – Prishtinë – Merdare apo për termocentralin Kosova C dhe minierën e linjitet të lidhur me të, politikanët janë pozicionuar për të vjelë përfitimet dhe për të përforcuar ndikimin e tyre: përmes kontrollit të kompanive lokale partnere apo të nënkontraktuesve, të furnizuesve me materiale ndërtime, të tokës që duhet për autostradën, për termocentralin apo përdorimin e minierës.<sup>278</sup> Një zyrtar ndërkombëtar shikon një “ekspansion gradual të fuqisë politike në fushën e ekonomisë”<sup>279</sup> ndërkohë që komentatorët në Prishtinë gjithnjë e më shumë flasin për një “shtet të nxënë”.<sup>280</sup> Ata shohin sesi mënyra e papërgjegjshme, hierarkike me të cilën drejtohen partitë politike po transferohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në qeverisjen e vendit;<sup>281</sup> ata perceptojnë se burokratët po e uzurpojnë ekonominë në mungesën e një klase të mirëfilltë kapitaliste<sup>282</sup> dhe vënë re se: “Qeveria i ka njohur vetes të drejtën të shpërndajë para pa konkurrencë.”<sup>283</sup>

Përvetësimi dhe shpronësimet arbitrare që praktikohen në proceset e prokurimit dhe licencimit në nivelin qendror të qeverisjes pasqyrohen edhe në praktikën e qeverisë lokale. Për shembull, kryetari i komunës së Lipjanit, i PDK-së, urdhëroi shembjen e një rruge me dyqane private duke argumentuar se vota e shumicës që komandon në këshillin komunal ia lejon një gjë të tillë.<sup>284</sup> Po ashtu, ai u ndaloi nxënësve të shkollës së mesme që ta zhvillonin mbrëmjen e maturës në

<sup>273</sup> Studimi i Jurgen Habermas: “Transformimi struktural i sferës publike” [“The Structural Transformation of the Public Sphere”], 1989: Londër, krijoi konceptin e sferës publike.

<sup>274</sup> Intervistë, Shpend Ahmeti, drejtor i Institutit GAP, 11 dhjetor 2009.

<sup>275</sup> Intervistë, Mark Poston, ish drejtor i DFID për Kosovën, 11 shkurt 2010.

<sup>276</sup> Shih projekt-raportin e Klubit për Politikën e Jashtme: “Si po i largon korrupsioni investitorët nga Kosova”, prezantuar më 16 dhjetor 2009.

<sup>277</sup> Shih fjalimin e Ambasadorit Christopher Dell, dhënë me rastin e 15 vjetorit të Institutit Riinvest, 14 maj 2010. Ai paralajmëroi kundër një situatë ku “ekonomia është nën thumb të qeverisë ose përmes kontrollit të drejtpërdrejtë të saj, ose përmes të ashtuquajtura firma “private”. Nuk kam nevojë t’i tregoj audiencës pse ky model nuk funksionon. Ju tashmë e keni përjetuar atë. Ky model rrezikon zhvillimin demokratik dhe ekonomik. Kur e vetmja mënyrë që të pasurohesh është që të jesh i afërt me pushtetin ose të jesh në pushtet, nuk ka asnjë nxitje për të hequr dorë nga pushteti – është në fakt e kundërta – dhe ky është fundi i demokracisë në Kosovë. Shih:

[http://pristina.usembassy.gov/dell\\_statements/ambassador-christopher-dell-reinvest-institutes-15th-year-anniversary-speech-may-14-2010.html](http://pristina.usembassy.gov/dell_statements/ambassador-christopher-dell-reinvest-institutes-15th-year-anniversary-speech-may-14-2010.html)

<sup>278</sup> Intervistë, Agron Bajrami, kryeredaktor i *Koha Ditore*, 13 maj 2010.

<sup>279</sup> Intervistë, 19-20 prill 2010. Ai shtoi që pasi paratë e mbledhura nga praktikën korruptive janë të ri-investuara në Kosovë, kjo rrit instrumentet e kontrollit që i ka në dispozicion elita e korruptuar.

<sup>280</sup> Veton Surroi, fjalim në konferencën e Klubit për Politikën e Jashtme, mbi Raportin e Progresit të BE-së për Kosovën në 16 tetor 2009; disa folës në konferencën e KPJ “Pesha e Korrupsionit tek Investimet e Huaja të Drejtpërdrejta”, 16 dhjetor 2009.

<sup>281</sup> Haki Abazi, zyrtar i programit, Fondacioni i Vëllezërve Rockefeller, fjalim në konferencën e KPJ “Pesha e Korrupsionit” op. cit.

<sup>282</sup> Intervistë, Halil Matoshi, analist, *Koha Ditore*, 4 nëntor 2009.

<sup>283</sup> Veton Surroi, fjalim, Konferencë mbi Raportin e Progresit të BE-së op. cit.

<sup>284</sup> Raport nga Faton Ademi, *Jeta në Kosovë*, televizioni RTK, 13 maj 2010 dhe Jeton Llapashtica, “Organizohen kundër vendimit për rrënim”, *Zëri*, 13 maj 2010. Shembja u krye në 17 maj 2010.

një lokal ku donin ata, duke i urdhëruar që të përdornin një lokal ku PDK-ja zhvillonte aktivitetet e fushatës.<sup>285</sup>

Ekonomia e pazhvilluar e bën Kosovën vendin e dytë më të varfër në Europë, pas Moldavisë,<sup>286</sup> me një PBB për kokë banori prej 1731 eurosh,<sup>287</sup> me rroga mesatare për sektorin publik prej 230 eurosh në muaj dhe për sektorin privat me 280 euro në muaj, me 45% të popullsisë që jeton në varfëri dhe 15% që jeton në varfëri ekstreme,<sup>288</sup> me papunësinë që vlerësohet në 40-48% ndërsa për të rinjtë papunësia qëndron në 74%,<sup>289</sup> por është duke u rritur edhe më.<sup>290</sup> Çdo vit, në të gjitha sektorët e ekonomisë të marra së bashku gjenerohen 6000 vende pune, në një kohë që çdo vit hyjnë në tregun e punës 25 deri në 30000 të rinj.<sup>291</sup> Aktualisht meshkujve të rinj u duhen mesatarisht dhjetë vjet për të kaluar nga arsimi tek një punë e qëndrueshme (në vendet e zhvilluara ky tranzicion arrin mesatarisht në 1.4 vjet) dhe vetëm 11% e grave në moshë pune janë të punësuar (në Turqi për shembull, kjo shifër është 23%).<sup>292</sup>

Kjo situatë shkakton një varësi të theksuar ndaj atyre që kontrollojnë ato vende të pakta pune që hapen. Në disa ndërmarrje publike kërkohen

<sup>285</sup> Letër ankimore dërguar emisionit *Jeta në Kosovë* nga studentët e Lipjanit, 25 prill 2010.

<sup>286</sup> Kosova ishte njësi më e varfër përbërëse e Jugosllavisë dhe pësoi dëme edhe më të mëdha gjatë viteve 1990 kur Milosheviçi dëboi pjesën më të madhe të popullsisë shqiptare nga sektori shtetëror dhe publik, u mori asetet dhe u mohoi investimet, duke kulminuar me luftën e 1998-99 dhe shkatërrimet, plaçkitjet dhe zhvendosjet që prodhoi kjo luftë. Në administratën e OKB-së në vitet 2000, vonesat dhe kufizimet në procesin e privatizimeve sollën një mungesë të mëtejshme investimesh.

<sup>287</sup> Shih Gjergj Erebara, "Kosova ka rritjen më të madhe të PBB në Ballkan", *Balkan Insight*, 2 tetor 2009, <http://www.balkaninsight.com/en/main/news/22618/>.

<sup>288</sup> Raporti i Bankës Botërore mbi vlerësimin e varfërisë në Kosovë, maj 2008. Varfëria vlerësohet si të ardhura prej më pak se 45 eurosh në muaj, ndërsa varfëria e skajshme si hasja e vështirësive për të përmbushur nevojat bazë ushqimore.

<sup>289</sup> Kosovo Country Economic Memorandum, 29 prill 2010. Shih [www.worldbank.org/kosovo](http://www.worldbank.org/kosovo). Raporti i mëparshëm i Bankës Botërore: "Rinia kosovare në rrezik" ["Kosovo Youth in Jeopardy"], 2 shtator 2008, e vinte papunësinë e të rinjve në nivelin 65-75%. [http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/Kosovo\\_Youth\\_Employment.pdf](http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/Kosovo_Youth_Employment.pdf).

<sup>290</sup> Banka Botërore tani e vlerëson papunësinë në 48%, një rritje nga vlerësimet e mëparshme që sillleshin rreth 40%. Ajo arriti në këtë shifër më të lartë duke ndryshuar llogaritë e saj themelore dhe duke i konsideruar njerëzit që ushtrojnë bujqësinë për mbijetesë si të papunë. Kosovo Country Economic Memorandum, op. cit.

<sup>291</sup> Intervistë, Besim Beqaj, President, Oda Ekonomike e Kosovës, 19 shkurt 2010.

<sup>292</sup> World Bank Kosovo Country Economic Memorandum, op. cit.

ryshfete për vendet e punës.<sup>293</sup> Një kompani e madhe sigurie u kërkon aplikuesve para për trajnimin dhe uniformën e tyre, por pa u dhënë ndonjë garanci se do të punësohen.<sup>294</sup> Disa të rinj zgjedhin anëtarësimin në një parti politike si mënyrën më të mirë për të siguruar një vend pune.

Ata që kanë një vend pune, gjenden shpesh nën mëshirën e punëdhënësit të tyre. Një punëtor ndërtimi tha: "Nëse ankohe mi atëherë kanë për të na dëbuar – ka kaq shumë të papunë që rrinë në radhë për të na zëvendësuar."<sup>295</sup> Orët e punës shiteshin të papaguara, kushtet e pasigurta dhe të pashëndetshme të punës, mungesa e respektimit të fundjavave dhe festave publike si dhe mungesa e çdo lloji sigurimi të jetës apo shëndetësor janë shumë të përhapura.<sup>296</sup> Gratë janë të ekspozuara ndaj shfrytëzimit seksual.<sup>297</sup> Ligji i punës është ende i paplotë dhe shumë punëdhënës veprojnë jashtë sistemit të taksave dhe të pensioneve.<sup>298</sup> Megjithatë, edhe nëse kontrollohet rreptë, legjislativi i ri do të ketë vështirësi në ndryshimin e kësaj situatë, nëse shihet në kontekstin e një papunësie kaq të lartë.

E vetmja mënyrë e qëndrueshme për të ulur një nivel të tillë varfërie, varësie dhe ekspozimi gjendet në një reduktim masiv të papunësisë. Sfidat që kjo paraqet është e jashtëzakonshme. Do të duhet një rritje e qëndrueshme ekonomike prej së paku 7% përgjatë 10–15 viteve të ardhshme vetëm për ta përgjysmuar papunësinë deri në 20–25%. Aktualisht, rritja ekonomike prej 4–5% dhe niveli i papunësisë prej 40–48% do të mbeten të pandryshueshme, dhe madje mund të ketë një rritje të papunësisë.

Ndërkohë, shumë nga njerëzit me shpirt më të madh sipërmarrjeje kanë shkuar për të jetuar e

<sup>293</sup> Në 2004 një djalë i ri që merrej me punë të tilla në aeroportin e Prishtinës u vra. Shih Arbana Xharra, "Përjashtimet nga Aeroporti i Kosovës nxisin përplasje lidhur me fshehjen" ["Kosovo Airport Sackings Spark Cover-Up Row,"] *Balkan Insight*, 22 maj 2006. <http://kosovo.birn.eu.com/en/1/51/1784/>.

<sup>294</sup> Intervistë, Florian Qehaja, Qendra Kosovare për Studimet e Sigurisë, 4 mars 2010.

<sup>295</sup> Intervistë me Lulzim Demollin dhe Parim Ollurin, "Shumë punëtorë në sektorin privat trajtohen sikur 'skllëvër'", *Koha Ditore*, 12 maj 2010.

<sup>296</sup> Lulzim Demolli dhe Parim Olluri, *Ibid*.

<sup>297</sup> Një gazetar përmendi disa raste në sistemin gjyqësor. Intervistë, Selviqe Bajrami, *Zëri*, 11 dhjetor 2009.

<sup>298</sup> Lulzim Demolli dhe Parim Olluri, op. cit.



punuar jashtë shtetit. Sikur të mos kishte qenë kjo valvul sigurie, papunësia do të kishte qenë akoma më e lartë. Remitancat që ata u dërgojnë familjeve në Kosovë e kanë mbrojtur deri diku shoqërinë nga varfëria,<sup>299</sup> por gjithsesi mungesa e aftësive dhe e zërit të tyre, por në anën tjetër prezenca e parave të tyre, ka ndihmuar gjithashtu në ngurtësimin e një ekonomie politike të ngritur mbi importet dhe shërbimet, e cila kontribuon në rritjen e deficitit kolosal tregtar të Kosovës, duke e bërë atë të varur nga të ardhurat prej doganave për të financuar pjesën më të madhe të buxhetit të shtetit.<sup>300</sup>

## Pengje të sektorit publik

Qeveria ka një rol dominues në ekonomi, në formësimin e investimeve dhe punësimit kundrejt kontekstit të një sektori të dobët privat, dhe teksa vazhdon të ndërmarë një ekspansion masiv investimesh kapitale, të cilat janë trefishuar në dy vjet, ndërkohë që prokurimet publike tanimë janë rritur duke shkuar në 40% të buxhetit të shtetit<sup>301</sup> dhe 11% të PBB.<sup>302</sup> Mes tyre, dy ministri – ajo e arsimit dhe transportit - si dhe dy kompani publike, KEK-u i energjisë elektrike dhe PTK-ja e post-telekomunikacioneve, zënë 65% të prokurimeve shtetërore, ndërsa buxheti i tyre është dyfishuar nga 2007 në 2008 duke kapur 800 milion euro.<sup>303</sup> Rritja ekonomike e projektuar aktualisht, prej 4%, vjen si pasojë e kësaj rritjeje të paqëndrueshme të shpenzimeve kapitale të qeverisë dhe jo si pasojë e dinamizmit të sektorit privat.<sup>304</sup>

<sup>299</sup> Raporti i Bankës Botërore mbi Velrësimin e varfërisë në Kosovë

<sup>300</sup> Defiçiti tregtar i Kosovës arriti në 45% të PBB në 2009. Importet ishin dymbëdhjetë herë më të mëdha sesa eksportet të cilat ishin 18% më të vogla se eksportet e 2008. Shih World Bank Kosovo Country Economic Memorandum, op. cit. Të ardhurat doganore ende financojnë dy të tretat e buxhetit të Kosovës.

<sup>301</sup> Projekt-raport i Klubit për Politikën e Jashtme: “Si po i largon korrupsioni investitorët nga Kosova”.

<sup>302</sup> Banka Botërore Memorandum Ekonomik i Shtetit.

<sup>303</sup> Intervistë, Ilaz Duli, Kryetar, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, 18 dhjetor 2009.

<sup>304</sup> Intervistë, Besim Beqaj, kryetar, Oda Ekonomike e Kosovës, 19 shkurt 2010. Progres Raporti i BE i tetorit 2009 për Kosovën deklaronte se ndërkohë që investimet publike u rritën me 194% gjatë vitit, investimet në sektorin privat ranë me 10.2%.

Në një popullsi prej 2.1 milionësh,<sup>305</sup> gjysma e së cilës mendohet të jetë nën moshën 25 vjeçare dhe 40% nën 18 vjeç, 75000 janë të punësuar drejtpërdrejtë nga qeveria qendrore apo lokale, duke përfshirë 32000 në arsim, 13000 në shëndetësi dhe 8000 në polici. Afërsisht 15000 janë të punësuar nga kompanitë publike, duke përfshirë 7500 në kompaninë energjetike KEK, rreth 3000 në PTK-në e post telekomunikacioneve dhe 850 në aeroportin e Prishtinës. Partitë politike i shohin këto grupe dhe pjesëtarët e familjeve të tyre si një burim i mbështetjes elektorale, duke shkuar deri aty sa të llogarisin se për çdo 100 nëpunës civilë që punësohen apo pushohen nga puna, fitojnë ose humbasin 500 vota.<sup>306</sup> Kësisoj, shikuar nga prizmi i patronazhit, të punësuarit e sektorit publik dhe familjarët e tyre në moshë madhore arrijnë në rreth 450000 votues: një shumicë potenciale ndër ata 700000 që votuan në zgjedhjet e fundita në Kosovë.

Ndërkohë që ekspozimi gjithnjë e më i madh i nëpunësve civilë ndaj trajtimit arbitrar tashmë është diskutuar, drejtimi i kompanive publike, i cili ka qenë gjithnjë problematik, është bërë po ashtu ndjeshëm më arbitrar gjatë dy viteve të fundit. Rregullat dhe garancitë e brendshme duket se janë zhdukur, bordet e tyre janë mbushur me besnikë të partisë në pushtet që kanë kualifikime të dyshimta profesionale. “Ne nuk kemi kompani publike – ato janë private, por me një ndryshim: ato nuk kanë kaluar përmes procesit të privatizimit dhe zotërohen nga klane apo grupe politike që nuk i japin llogari askujt.”<sup>307</sup> Ka dyshime se inventarët e këtyre kompanive shiten me kushte jo-favorizuese ose shpërdorohen nga firma private.<sup>308</sup> Pagesat që ka bërë PTK, si për shembull, ajo e 45000 eurove për një garë me kuaj apo ndërtimi i banesave sociale për invalidë të caktuar të luftës i kanë bërë shumë për tu çuditur.

Disa akuzojnë se moria e kontratave të prokurimit të PTK-së, të cilat arrijnë në dhjetëra miliona euro,

<sup>305</sup> Kosova nuk ka pasur një regjistrim të besueshëm të popullsisë që prej 1981. Numri i banorëve që aktualisht jeton në vend mund të jetë mjaft më i ulët se 2.1 milion.

<sup>306</sup> Intervistë, Agron Demi, Instituti GAP, 30 tetor 2009.

<sup>307</sup> Intervistë, Safet Gerxhaliu, Nënkretar, Oda Ekonomike e Kosovës, 18 nëntor 2009.

<sup>308</sup> Intervista: Hasan Preteni, drejtor, Agjensioni Kundër Korrupsionit, 15 dhjetor 2009; drejtor, kompani inxhinierike, 18 dhjetor 2009.

përbëjnë shpenzime të panevojshme.<sup>309</sup> Në maj 2010 qeveria urdhëroi ndalimin e shpenzimeve kapitale që nuk parashikoheshin në planin e biznesit të PTK-së<sup>310</sup> dhe anuloi një kontratë €20 milionëshe për programe kompjuterike të faturimit që shumë e konsideronin të tepërt,<sup>311</sup> përderisa një tender për €11 milion për rrjet të fibrave optik është anuluar pas intervenimit të Komisionit Evropian.<sup>312</sup>

Drejtimesit e PTK-së kanë në dispozicion mjete të konsiderueshme financiare që mund t'i përdorin kundër atyre që e kundërshtojnë dhe kompania është e angazhuar në një betejë të vazhdueshme me mediat liberale. Këto të fundit e akuzojnë se po përdor një politikë të qëllimshme për të ulur vlerën e PTK-së, për të ndihmuar kështu në një privatizim nga i cili do të përfitonin njerëz të qeverisë. Nga ana tjetër, PTK e akuzon median se ajo po përpiqet të ulë vlerën e kompanisë me shpifjet e saj.<sup>313</sup> Kontrata e PTK-së me Dardafone, pjesën më të madhe të aksioneve të së cilës e zotëron një biznesmen që shihet si i afërt me PDK, është kontroverze – Dardafone përfiton, kështu, kapacitetet e telefonisë celulare të PTK-së me kushte që disa akuzojnë që janë të dëmshme për PTK-në dhe i lejojnë Dardafonit që të krijojë Z-Mobile, një operator rival “virtual” i telefonisë celulare. Raportohet se në shtator 2009 EULEX-i filloi hetimet për këtë kontratë,<sup>314</sup> ndërsa drejtimesit e PTK-së braktisën një takim me zyrën e ICR, duke refuzuar të marrin pjesë në atë që e quajtën një marrje në pyetje.<sup>315</sup> PTK hodhi në gjyq gazetën *Koha Ditore* dhe ndaloi reklamimet e saj fitimprurëse pasi gazeta përshkroi praktikën e saj të dyshimta; më pas reklamat u rikthyen. Në 2010, PTK kërcënoi gazetarët e gazetës *Zëri* se do të ndërmerre veprime ligjore kundër tyre.

<sup>309</sup> Shih Lavdim Hamidi, “PTK jep 25 milionë euro kontrata në prag të privatizimit”, *Zëri*, 8 prill 2010.

<sup>310</sup> Besnik Krasniqi, “Qeveria i vë kufizime PTK-së”, *Koha Ditore*, 14 maj 2010.

<sup>311</sup> Lavdim Hamidi, “PTK mbetet pa platformën 20-milionëshe” *Zëri*, 20 maj 2010.

<sup>312</sup> Parim Olluri, “PTK-së i anulohet tenderi 11-milionësh”, *Koha Ditore*, 6 maj 2010.

<sup>313</sup> Ky argument do të zgjidhet kur PTK të botojë rezultatet e saj në mes të vitit. Një zyrtar ndërkombëtar pret që ato të jenë disi më të ulëta se vitin që shkoi. Intervistë, zyrtar i mbikëqyrjes ndërkombëtare, 19-20 prill 2010.

<sup>314</sup> Lavdim Hamidi, “Policia Ndërkombëtare nis hetimet në PTK” *Zëri*, 18 shtator 2009.

<sup>315</sup> Arben Hyseni, “Arroganca e ICO-së”, *Express*, 29 tetor 2009.

Bujaria e sektorit publik përdoret për të rekrutuar dhe për të shpërblyer mbështetësit. Dhënia nga ana e qeverisë e një kontrate prej 15 milion eurosh kompanisë së ndërtimit Mabetex në pronësi të kreut të AKR-së Behxhet Pacolli, për të rindërtuar ish ndërtesën e shtypit në Kosovën qendrore, erdhi në momentin kur Haradinaj i AAK-së po përpiqej të mobilizonte të gjitha partitë opozitare për të formuar një front të përbashkët.<sup>316</sup> Edhe më shumë veteranë të luftës janë punësuar në KEK dhe në PTK gjatë muajve të fundit.<sup>317</sup> Nga të 80 vendet e punës që u hapën në PTK në komunën perëndimore të Pejës, që kontrollohet nga partia opozitare AAK, 72 iu dhanë kandidatëve nga Malisheva, bastioni i PDK në Kosovën qendrore.<sup>318</sup> Një politikan i opozitës tha se atij i ishte ofruar një post në PTK për të hequr dorë nga zgjedhjet e fundit lokale dhe se lista e kandidatëve për këshilltarë komunal të partisë së tij ishte përgjysmuar si pasojë e ofertave të ngjashme.<sup>319</sup> Në një qytet të madh, ku shërbimet kontrollohen nga një familje e lidhur me SHIK,<sup>320</sup> një kundërshtar politik ngriti akuzën se faturat e energjisë të mbështetësve të PDK-së nuk mblidhen, ndërkohë që të tjerët trajtohen në mënyrë të ashpër.<sup>321</sup>

Në sektorin publik rrogat janë të shtresëzuara ndjeshëm. Pjesëtarët e qeverisë dhe deputetët i kanë caktuar vetes rroga të larta, ndërsa disa

<sup>316</sup> Faik Hoti, “Tenderi 15-milionesh i Behgjet Pacollit ve ne dyshim krijimin e bllokut opozitar” *Zëri*, 15 shtator 2008.

<sup>317</sup> Intervistë, zyrtar, OJQ ndërkombëtare, nëntor 2009.

<sup>318</sup> Një akuzë e ngritur nga kandidati për kryetar komune i Orës, Gazmend Muhaxheri në një debat zgjedhor në nëntor 2009, i incizuar nga televizioni lokal TV Dukagjini. Kur u transmetua, këtij segmenti i ishte hequr zëri. Intervistë, Gazmend Muhaxheri, 15 dhjetor 2009. Malisheva është qyteti i lindjes i Ministrisë të Transportit dhe Postë Telekomunikacionit Fatmir Limaj. Deputetja e LDD-së Besa Gaxherri, që mban njëkohësisht një punë në PTK në Pejë, konfirmoi përmbajtjen e akuzës: “Është e vërtetë. Ka pasur një numër të madh punësimesh nga Malisheva dhe Skenderaj. Ka një numër të konsiderueshëm në rajonin e Pejës... Nuk është se jam kundër punësimit të njerëzve, por nuk mendoj se është korrekte që njerëzit që vijnë nga një rajon i caktuar marrin në punë njerëz nga i njëjti vend. Punët nuk kanë qenë ndonjëherë më keq se kaq.” Intervistë, 17 maj 2010.

<sup>319</sup> Intervistë, Gazmend Muhaxheri, Ibid.

<sup>320</sup> Intervistë, 10 mars 2010. E konfirmuar nga një zyrtar ndërkombëtar që shtoi se ndërkohë që të gjitha partitë përpiqen të vendosin njerëzit e tyre në poste të rëndësishme “SHIK është ndryshe sepse e bën këtë duke i frikësuar dhe shantazhuar njerëzit.” Intervistë, 18 maj 2010. Gjatë raundit të parë të zgjedhjeve lokale, 15 nëntor 2009, në disa qendra votimi në Mitrovicë u ndërpre energjia elektrike në orët e para të mbrëmjes teksa po errësohej dhe po vinte ora e mbylljes së votimit.

<sup>321</sup> Intervistë, 10 mars 2010.

marrin dhe rroga të dyfishta; deputetët shkaktuan zemërimin e niveleve të ulëta të sektorit publik duke e shpërblyer veten me një rrogë të “trembëdhjetë” për 2009 (madje policët që ishin në grevë morën në konsideratë edhe rrethimin e kuvendit<sup>322</sup>). Rroga për personelin e niveleve të mesme dhe të larta në ndërmarrjet publike si PTK, KEK dhe aeroporti e RTK janë po ashtu bujare. Megjithatë, shpërthimi i shpenzimeve publike i dy viteve të fundit në sektorin publik u kanalizua drejt shpenzimeve kapitale dhe jo drejt rritjes së rrogave minimale prej 220–260 eurosh në muaj për pjesën më të madhe të 75000 nëpunësve civilë: administratorët, punonjësit e shërbimit shëndetësor, arsimtarët dhe policët.

Ekzistenca në kufijtë e mbijetesës dhe pasiguria në lidhje me mbajtjen e vendit të punës në kontekstin e një niveli të lartë papunësie, e kanë dobësuar fuqinë negociuese të punonjësve të sektorit publik. Qeveria, kryesitë e komunave dhe menaxherët e ndërmarrjeve publike i kanë përdorur këto dobësi, krerët e ndikueshëm të sindikatave si dhe aftësinë e tyre për të përçarë e për të sunduar, për t'i shtypur këto kërkesa. Një koordinator i sindikatave u pezullua nga komuna e Prishtinës sepse kishte vepruar në mënyrë shumë energjike.<sup>323</sup> Dy punonjës të aeroportit të Prishtinës që u përpoqën të organizonin një sindikatë të pavarur humbën vendin e punës, ndërkohë që një i tretë tha se e kishin rrahur.<sup>324</sup>

Në fillim të shkurtit 2010 qeverisë iu desh të bënte përpjekje të mëdha për të ndaluar një protestë për rrogat nga ana e policisë, punonjësve të shëndetësisë, administratorëve të gjykatave dhe punonjësve të KEK-ut. Qindra policë u mblodhën në një qendër stërvitore jashtë Prishtinës për të kërkuar rroga më të larta të premtuara. Edhe në Klinikën Qendrore Universitare durimi sosi, teksa një personel militant dhe më përfaqësues filloi të nxirrte jashtë loje krerët e sindikatave që shiheshin

si marioneta të qeverisë.<sup>325</sup> Qeveria bëri disa lëshime të pjesshme, duke arritur marrëveshje të veçanta dhe e qetësoi situatën. Rrogat e policisë dhe punonjësve të shërbimit shëndetësor u rritën, ndonëse të paparashikuara në buxhet. Një nga krerët e policisë u suspendua nga puna një muaj pasi që dha një intervistë në gazetë; një paralajmërim për të tjerët. Nuk ka pasur protesta të mëtejshme në favor të tij.<sup>326</sup>

## Problemet me prokurimin publik

Menaxhimi i prokurimit publik është bërë po ashtu më arbitrar, duke qenë se ndërkohë që buxheti i prokurimeve është rritur, shumë nga profesionistët e prokurimeve janë zëvendësuar, sidomos në 2009, zakonisht me njerëz më pak të kualifikuar, në mos fare të pakualifikuar, por më të varur nga patronët e tyre politikë.<sup>327</sup> Pas disa viteve me një përmirësim të moderuar, integriteti i prokurimeve publike që prej 2008 ka pësuar rënie, duke u kthyer në një nga shqetësimet madhore të shprehura në Raportin e Progresit të tetorit 2009 të Komisionit Evropian. Qeveria ka premtuar se do të bëjë reforma.<sup>328</sup>

Shpenzimet aktuale janë dyfishuar (duke mos ecur me të njëjtin hap me trefishimin e planifikuar në buxhet), por cilësia e tyre ka ardhur duke rënë teksa shpenzimet përshpejtohen.<sup>329</sup> Tenderat me një burim të vetëm, që supozohen të kryhen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, janë trefishuar nga 50 milion euro në 164 milion euro në tri vjet, duke arritur kulmin pas largimit të profesionistes me karrierë të gjatë në këtë profesion, Vlora Kuçi, nga posti i drejtoreshës së Agjencisë së Prokurimit Publik, në tetor 2008.

Pas ardhjes në pushtet në janar 2008, PDK, partia dominuese në qeveri, siguroi për vete ministrinë të cilave u dedikuan buxhete të mëdha për investime kapitale: në 2009 kjo shifër arrinte në 300 milion euro krahasuar me vetëm 50 milion euro në

<sup>322</sup> Shih intervistën e Kastriot Jahaj me kreun e grevës së policëve Arbreresh Dalipi, “Nëse pagat e policëve nuk do të rriteshin, vendin e priste një kolaps”, *Koha Ditore*, 4 mars 2010.

<sup>323</sup> Lulzim Demolli, “Suspendohet nga puna kryesindikalisti i administratës komunale”, *Koha Ditore*, 20 qershor 2008.

<sup>324</sup> Intervista të BIRN, prill 2010, e kryer për programin e *Jeta në Kosovë* mbi privatizimin e aeroportit të Prishtinës, televizioni RTK, 29 prill 2010.

<sup>325</sup> Intervista BIRN, shkurt 2010, kryer për programin e *Jeta në Kosovë* mbi grevat në sektorin publik, televizioni RTK, 11 shkurt 2010.

<sup>326</sup> Jeton Llapashtica, “Polici i harruar”, *Zëri*, 11 mars 2010.

<sup>327</sup> Intervistë, Ilaz Duli, Kryetar, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, 18 dhjetor 2009.

<sup>328</sup> Intervistë, Zëvendës Kryeministri Hajredin Kuçi, 20 maj 2010.

<sup>329</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar i mbikëqyrjes, 19-20 prill 2010.

ministrinë e LDK-së<sup>330</sup> nga një buxhet total prej 1 bilion e 430 milion eurosh. Buxheti i Ministrisë së Transportit për ndërtimin e rrugëve u rrit nga 22 milion euro në 2007 për të arritur një mesatare prej 10% të gjithë buxhetit të qeverisë në të gjitha vitet që prej 2007: 139 milion euro në 2008 dhe 160 milion euro në 2009, përpara se të ulej sërish në 124 milion euro në 2010. Ministria do të shpenzojë edhe të paktën 700 milion euro të tjera gjatë tri viteve në vijim për marrëveshjen me Bechtel-Enka për ndërtimin e autostradës; një fond ky që supozohet të vijë nga privatizimi i PTK-së dhe ndërmarrjeve të tjera publike.

Ndonëse infrastruktura rrugore dhe shkollat, që kanë dominuar shpërthimin e shpenzimeve kapitale të qeverisë, janë të nevojshme, përqendrimi i tepruar në këto dy fusha i ka lënë në stagnim të gjithë sektorët tjerë. Për shembull, sistemi shëndetësor i Kosovës që ka një mungesë dëshpëruese fondesh (menaxhohet nga një ministri më pak e fuqishme e drejtuar nga LDK) nuk ka parë një rritje të tillë eksponenciale të buxhetit dhe po ashtu nuk u arrit të gjendeshin as 4 milion euro ekstra që nevojiten çdo vit për përmirësimin e sistemit gjyqësor.<sup>331</sup>

Ka shenja që flasin për një qasje klienteliste ndaj alokimit të investimeve kapitale. Rritjet masive të shpenzimeve që prej 2008 i kanë shtuar mundësitë për favoritizëm politik, si dhe efektet e kësaj dukurie. Komuna e Skenderajit, kryetari të komunës së PDK-së Sami Lushtaku, pretendon se ka siguruar 18 milion euro investime kapitale në 2008 – shpenzime këto që i kanë vlerësuar si të nevojshme vetë ministrinë, të cilat ia kanë rritur buxhetin e rregullt kapital të Skenderajit për 15 herë,<sup>332</sup> ndërkohë që paratë e qeverisë qendrore për financimin e banesave sociale në Pejë e kontrolluar nga AAK shteruan.<sup>333</sup> Brenda vetë

<sup>330</sup> Projekt-raporti i Klubit për Politikën e Jashtme: “Si po i largon korrupsioni investitorët nga Kosova”. Op. cit.

<sup>331</sup> Kostoja e rritjes së rrogave në një nivel të përshtatshëm. Intervistë, jurist i angazhuar në nisma të reformave që nga 2004, 15 shkurt 2010.

<sup>332</sup> Buxheti i rregullt i Skenderajit për investime kapitale në 2008 ishte 1.21 milion euro. Kryetari i komunës Lushtaku deklaroi se kësaj do t’i pasojë një shtojcë me 16.8 milion euro të tjera nga ministrinë e qeverisë qendrore. Shih Adem Meta, “Në Skenderaj 18 milionë euro investime, janë realizuar dhjetëra projekte”, *Koha Ditore*, 2 janar 2009.

<sup>333</sup> Intervistë, Gazmend Muhaxheri, 15 dhjetor 2009. Në mars 2010, AAK publikoi një analizë krahasuese të shpenzimeve të qeverisë në rrugë lokale në pesë komuna të udhëhequra nga PDK me popullsi të

Pejës, ndërtimi i shkollave dhe rrugëve nga ana e qeverisë qendrore dukej si i përqendruar në ato fshatra që kanë një histori mbështetjeje të PDK-së, ndërkohë që kryetari i komunës favorizonte fshatrat që mbështetnin AAK-në.<sup>334</sup> Në Ferizaj, fshatrat që mbështetën koalicionin qeverisës PDK – AKR marrin projekte. Ato që votuan për AAK apo partitë e vogla nuk marrin.<sup>335</sup>

Duket sikur përzgjedhja e projekteve nuk është bazuar mbi një analizë të kostove dhe përfitimeve. Qeveria i ka lënë peng financat e Kosovës për disa vjet tek kontrata e madhe e autostradës që do të ndërtohet nga Bechtel-Enka. Vende të tjera të rajonit kanë marrë fonde nga BE për ndërtimin e autostradave strategjike, kur avancuan në statusin e vendit kandidat të BE. Qeveria e Kosovës i ka kushtuar projektit të autostradës Vermicë – Prishtinë – Merdare një rëndësi të atillë sa të vazhdojë me zbatimin e këtij projekti duke e financuar atë tërësisht nga burimet e saj të pakta. E megjithatë, në aspektin ekonomik, “Nuk është e qartë nëse autostrada është prioriteti kryesor i Kosovës.”<sup>336</sup>

Projekti do ta shkurtojë udhëtimin nga Prishtina në Tiranë edhe me 30 minuta, pasi hapja e tunelit të Kalimashit në Shqipëri, që pritet të jetë operacional nga mesi i 2010, e uli këtë kohë nga 10 në 4 orë. Në skajin tjetër të projektit, Serbia ende nuk është duke bashkëpunuar me Kosovën dhe nuk ka plane konkrete për një autostradë lidhëse që të fillojë në Merdare. Sidoqoftë, krijimi i një lidhjeje fizike të përmirësuar me Shqipërinë do të zgjerojë opsionet e kufizuara gjeopolitike dhe tregtare të Kosovës.

Marrëveshja me Bechtel-Enka në mars 2010 ngjalli shqetësime se as planet, as financimi dhe as

përgjithshme prej 560,000 dhe pesë komuna të udhëhequra nga AAK me popullsi të përgjithshme prej 500,000. Sipas AAK-së, komunat e PDK-së kanë pranuar investime në shumë prej 25 milion euro ndërsa komunat e AAK-së në shumë prej 2.2 milion euro. Arsim Rashiti, “Favorizohen komunat e PDK-së”, *Zëri*, 2 mars 2010.

<sup>334</sup> Ministria e Arsimit ndërtoi një shkollë të madhe në fshatin e lindjes së Zëvendës Kryeministrit Hajredin Kuçi, Llutogllav, e cila thuhet se është pothuajse bosh. Ibid. Zëvendës Kryeministri Kuçi tha se qeveria aktuale e kryesuar nga PDK kishte investuar 7 milion euro në shpenzime kapitale në Lugun e Baranit, prej nga vjen Kryetari i Pejës i AAK, Ali Berisha: më shumë se ç’është investuar atje në “njëqind vjet”. Intervistë, 20 maj 2010.

<sup>335</sup> Intervistë, Albulena Sadiku, INPO, 30 tetor 2009.

<sup>336</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar i mbikëqyrjes, 19-20 prill 2010.

kosto finale nuk ishin përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme.<sup>337</sup> Duke qenë se kushtet e kontratës u elaboruan dhe u ripunuan kaq shumë gjatë negociatave që pasuan tenderin me konsorciumin turko-amerikan Bechtel-Enka, disa kritikë thonë se edhe marrëveshja prej 700 milion eurosh për autostradën është kthyer në një prokurim me burim të vetëm.<sup>338</sup> Kontrata nuk është bërë publike dhe mbetet e paqartë se çfarë mbulon saktësisht shumën e deklaruar nga qeveria.<sup>339</sup> Fatura që pagoi Shqipëria për një të tretën e autostradës që u ndërtua nga i njëjti konsorcium u bymje nga çmimi origjinal prej 416 milion eurosh në mbi 1000 milion euro.<sup>340</sup>

Intensifikimi i ndërtimit të rrugëve gjatë dy vjetëve të fundit në përgjithësi është mirëpritur, por megjithatë ka krijuar ngërçe anembanë Kosovës. Vendi nuk i ka kapacitetet rrugë-ndërtuese që nevojiten për të absorbuar me lehtësi rritjen e gjashtëfishit të shpenzimeve.<sup>341</sup> Ministria e Transportit kontraktoi një kompani nga një qytet tjetër për të tetë rrugët që do të ndërtoheshin në Ferizaj. Por, ajo nuk kishte kapacitetet për t'i përfunduar ato përnjëheri, kështu që qyteti mbeti i bllokuar për muaj të tërë.<sup>342</sup> Për më tepër, ka pasur shpërdorime, mospërputhje mes investimeve e nevojave dhe përjashtime të përfituesve nga përfshirja në projekte. Ministria i ndërtoi të tetë rrugët në Ferizaj pa zhvilluar konsultime lokale apo pa përfshirjen e autoriteteve lokale, çka rezultoi në planprojekte të papërshtatshme. Ajo po ashtu i mbajti për vete vlerësimet e cilësisë së punimeve.<sup>343</sup>

<sup>337</sup> Parim Olluri, "Qeveria e Kosovës kritikohet për 'gabime në hapa' në projektin e autostradës", *Koha Ditore*, 28 mars 2010.

<sup>338</sup> Ibid.

<sup>339</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 19-20 prill 2010.

<sup>340</sup> Shih Besar Likmeta, "Autostrada Shqipëri-Kosovë shënon moment historik" ["Albania-Kosovo Highway Marks Milestone"], *Balkan Insight*, 1 qershor 2009. Ministri përgjegjës u padit dhe prokurorët dhe audituesit pretenduan një shpërdorim prej 114 deri në 232 milion eurosh. Padia u rrezua për teknikalitete nga Gjykata e Lartë e Shqipërisë në prill 2009.

<sup>341</sup> Intervistë, Hasan Preteni, Drejtor i Agjencionit Kundër Korrupsionit, 15 dhjetor 2009. Shefi i Kabinetit i Ministrisë së Transportit Endrit Shala pranoi se: "Pjesa më e madhe syresh nuk kanë ndërtuar në Kosovë në 20 vjetët e fundit. Këto janë kompanitë që kemi në Kosovë." Lawrence Marzouk & Petrit Çollaku, "Shokët e Ministrisë së Kosovës përfitojnë prej bollëkshmerisë së rrugëve" ["Kosovo Minister's Friends Flourish from Road Bonanza"], *Balkan Insight*, 8 prill 2010, <http://www.balkaninsight.com/en/main/investigations/27171/>.

<sup>342</sup> Intervistë, Afrim Demiri, korrespondenti i *Koha Ditore*, 12 dhjetor 2009.

<sup>343</sup> Ibid.

Disa segmente të atyre 1000 kilometra rrugë që u ndërtuan në 2008-09 janë mbushur me gropa që tani, duke ngritur pikëpyetje mbi standardin e punimeve dhe cilësinë e materialeve.<sup>344</sup> Kryetari i komisionit parlamentar për ekonominë dhe transportin ngriti dyshimin se: "Kompanitë që po ndërtojnë rrugët nuk e kanë idenë sesi ndërtohen rrugët, ato thjesht kanë kontakte në Ministrinë e Transportit,"<sup>345</sup> ndërkohë që Nënkyetar i Odës Ekonomike arriti në përfundimin se: "Nëse na duhet t'i rikthehemi të njëjtës rrugë pas një viti, atëherë ne jemi duke dëmtuar ekonominë e Kosovës."<sup>346</sup>

Qysh në fillim të 2008, Ministri Limaj i mbledhi kompanitë e ndërtimit duke u thënë se "ka punë për të gjithë", prandaj asnjë prej tyre nuk duhet ta ngadalësonte procesin e tenderimit duke u ankuar tek Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (i cili që prej asaj kohe është zëvendësuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit).<sup>347</sup> Për dy vjet askush nuk u ankua,<sup>348</sup> ndërkohë që media raportonte mbi kostot çuditërisht të larta të rrugëve që ndërtonte ministria,<sup>349</sup> elaborimin e tepërt me disa prej tyre,<sup>350</sup> nxitimin me të cilin u shpenzuan paratë<sup>351</sup> dhe zërat e pakonfirmuar që qarkullonin, sipas të cilave, kontraktorët ftoheshin që t'i shtonin çmimit të tyre një përqindje për të paguar rryshfetet.<sup>352</sup> Asnjëherë nuk u protestua ndaj ndonjë rezultati të tenderimeve, ndonëse me kalimin e kohës pronarët e firmave me kapacitetet dhe përvojën më të madhe zbuluan se po humbnin

<sup>344</sup> Buletin lajmesh i RTK, 28 mars 2010.

<sup>345</sup> Myzejene Selmani, në shkrimin e Lawrence Marzouk dhe Petrit Çollaku, "Shokët e Ministrisë së Kosovës përfitojnë prej bollëkshmerisë së rrugëve" ["Kosovo Minister's Friends Flourish from Road Bonanza"] op. cit.

<sup>346</sup> Safet Gerxhalii, në Ibid.

<sup>347</sup> Salie Gajtani-Osmankaq, "Ministria e Transportit punëson të gjitha firmat ndërtimore", *Koha Ditore*, 18 shtator 2008.

<sup>348</sup> Për dy vjet Agjensioni Kundër Korrupsionit nuk mori ndonjë ankesë mbi ndërtimi e rrugëve. Por, në vend që ta shihte këtë si një lajm të mirë, një zyrtar e pa si një tregues se sektori ishte "i kopsitur" dhe puna e çmimet ishin të garantuara për të gjitha kompanitë e ndërtimit dhe të gjitha ishin të kënaqura me situatën. Intervistë, 15 dhjetor 2009.

<sup>349</sup> Shih për shembull raportin e Fatos Halilit, *Jeta në Kosovë*, televizioni RTK, 14 janar 2010. [www.jetanekosove.com](http://www.jetanekosove.com)

<sup>350</sup> Rruga e re mes Prishtinës dhe aeroportit ka tërhequr vëmendjen në mënyrë të veçantë për shkak të numrit të urave dhe mbikalimeve që përfshin dhe kostos së tyre.

<sup>351</sup> Shih Salie Gajtani-Osmankaq, "Ministria e Financave dhe e Transportit shkelën ligjin gjatë rishikimit të buxhetit", *Koha Ditore*, 31 gusht 2009.

<sup>352</sup> Intervistë, biznesmen i mirënjohur, 18 dhjetor 2009.

ndaj firmave të reja e të papërfillshme, duke fituar vetëm kontratat më të vogla.<sup>353</sup>

Në prill 2010 pronari i një prej firmave më të mëdha të ndërtimit të rrugëve i tha *Balkan Insight*: “Ne nuk mund të fitojmë tendera sepse ne nuk i japim para qeverisë...Ata vijnë tek unë dhe më kërkojnë para, por nëse unë pranoj, atëherë çmimi i punës do të bëhej më i lartë...Kompani të tjera e bëjnë këtë [pagojnë ryshfete] dhe pastaj nuk shtrojnë disa centimetra çakull dhe asfalt, çka shpjegon përse cilësia...është aq e dobët.”<sup>354</sup> Më vonë, po atë muaj, ministri foli sërish në asamblenë e pronarëve të kompanive të ndërtimit të rrugëve duke i nxitur ata që të tregohen besnikë ndaj njëri tjetrit, të mos bëjnë komente negative, sepse qeveria kishte edhe 300 milionë euro për punë për ta – mjaftueshëm për të gjithë – si nënkontraktorë në kontratën për ndërtimin e autostradës që është arritur me konsorciumin Bechtel-Enka.<sup>355</sup>

Hulumtimi i *Balkan Insight* i prillit 2010 zbuloi praktika të dyshimta në kontraktimet e ministrisë për ndërtimin e rrugëve. Tre kontrata, me një vlerë totale prej 22 milion eurosh iu dhanë firmave apo konsorciumeve të drejtuara nga dy miq të afërt të Ministrisë Limaj, pavarësisht se në çdo rast kishte pasur oferta më të ulëta nga kompani rivale, si dhe mungesë dokumentacioni, që duhet të kishte çuar në diskualifikimin nga dy prej tenderave të konsorciumeve ku bënë pjesë kompani të drejtuara nga një biznesmen, i cili e ka pranuar se është i afërt me ministrin. Një kompanie iu dha një kontratë prej 3 milion eurosh, një muaj përpara se të regjistrohej si biznes me dy të punësuar. Në total, më shumë se një e treta e tenderave të ministrisë u fituan nga firma që u krijuan gjatë dy vjetëve, që pasuan momentin kur Fatmir Limaj e mori këtë post.<sup>356</sup>

<sup>353</sup> Intervistë, Salie Gajtani-Osmankaq, gazetare, *Koha Ditore*, 22 dhjetor 2009.

<sup>354</sup> Lawrence Marzouk dhe Petrit Çollaku, “Shokët e Ministrisë të Kosovës përfitojnë prej bollëkshmerisë së rrugëve” [Kosovo Minister’s Friends Flourish from Road Bonanza], op. cit. Biznesmeni kërkoi që të mos përmendej me emër sepse kishte frikë se ministria “do të hakmerrej”.

<sup>355</sup> Parim Olluri, “Ministri Limaj ‘pranon’ se cilësia e punëve në rrugë nuk është e kënaqshme”, *Koha Ditore*, 14 prill 2010.

<sup>356</sup> Lawrence Marzouk and Petrit Çollaku, “Shokët e Ministrisë të Kosovës përfitojnë prej bollëkshmerisë së rrugëve” [Kosovo Minister’s Friends Flourish from Road Bonanza], op. cit.

EULEX-i deklaroi se bastisjet e ministrisë, të shtëpive të ministrit Limaj dhe shefit të prokurimeve të ministrisë, Nexhat Krasniqi, si dhe të pronarëve të disa kompanive të ndërtimit të rrugëve “janë pjesë e një hetimi për disa tendera që lidhen me ndërtimin e rrugëve në Kosovë në periudhën 2007-09.”<sup>357</sup> Kryeprokurori i EULEX-it konfirmoi se hetimet filluan në maj 2009, tregoi se telefoni i ministrit ishte vënë në përgjim, i përmendi Limajn dhe Krasniqin si të dyshuar në një litani krimesh serioze dhe deklaroi se vetëm në një rast të veçuar ishin përvetësuar 2 milion euro.<sup>358</sup> Një zyrtar i EULEX-it tha se ministria e kishte fshirë serverin e saj të kompjuterëve përpara bastisjes, në një përpjekje për të fshirë provat e krimit.<sup>359</sup>

Ministri Limaj iu është shmangur pyetjeve të vështira në lidhje me autostradën.<sup>360</sup> Fakti që javët e negociatave që i paraprinë përmbjlljes se kësaj kontrate të madhe me konsorciumin e drejtuar nga amerikanët, përkoi me përpjekjet e qeverisë amerikane për të rregulluar një rënie të butë për këtë ministër, në mënyrë që të shmangte pasojat që do të vinin nga ngritja e padisë kriminale nga ana e EULEX-it, përbën një arsye për t’u shqetësuar. Sa i përshtatshëm ishte një ministër me një rekord të dyshimtë prokurimesh, të cilit po i ofrohej një amnisti e tillë, për të përfaqësuar në mënyrën më të mirë interesat e Kosovës në negociata komplekse që përfshinin qindra miliona euro? “Pyetje me vend” tha një zyrtar evropian i mbikëqyrjes.<sup>361</sup>

<sup>357</sup> Deklaratë për shtyp e EULEX “Tenderat e ndërtimit po hetohen”, 29 prill 2010. Shih: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000220.php>.

<sup>358</sup> Intervistë për gazetë, Arben Ahmeti, op. cit.

<sup>359</sup> Vehbi Kajtazi dhe Arben Ahmeti, “Dyshohet për 80 milionë të keqpërdorura në MTPT”, *Koha Ditore*, 8 maj 2010. Ditën tjetër Ministria e Administrimit Publik Edita Tahiri bëri një mohim publik të faktit se serveri i ministrisë ishte fshirë. Diskutimet tona me burime të besueshme tregojnë se ajo është informuar gabimisht, Intervistë, 11 dhe 13 maj 2010.

<sup>360</sup> Kërkesa e një komisioni parlamentar që ai të shpjegonte përse rruga kishte ndryshuar kursin u hodh poshtë në mënyrë të ashpër. Intervistë, deputet, 26 shkurt 2010. Teksa përballëj me pyetje aspak të vështira në programin e RTV21 *Sy me Sy*, 31 mars 2010, ministri Limaj anashkaloi një pyetje në lidhje me mosparaqitjen përpara këtij komisioni duke theksuar sasinë e kontrolleve ndërmitore të cilave i ishte nënshtruar projekti. Ai e kushtëzoi daljen e tij në *Zona e Debatit*, të televizionit Klan Kosova ditën tjetër me heqjen nga paneli të analistit të pavarur ekonomik Shpend Ahmeti.

<sup>361</sup> Intervistë, 19-20 prill 2010.

Nëse shohim të tërë spektrin e prokurimeve publike, burimet e brendshme konfirmojnë se çdo gjë është e manipuluar, që nga përzgjedhja e fituesit, ndryshimi i kriterëve të kontratës e deri tek shtimi i anekseve të kontratës.<sup>362</sup> Kjo e përçudnon konkurrencën. Gama e manipulimeve është e njëjtë në nivelin e qeverisë qendrore dhe lokale si dhe atë të kompanive publike. Kompanitë e krijuara aty për aty, shpesh duke përdorur dokumente false e duke pretenduar se kanë një ekspertizë dhe personel që nuk ekziston, fitojnë në mënyrë rutinë përballë kompanive me një rekord të provuar dhe me oferta më të lira. Hilet e autoriteteve publike për të siguruar fitoren për kompaninë e tyre të preferuar përfshijnë ose specifikime të vagëta kontraktuale ose të kundërtën, pra specifikimin e pajisjeve nga një furnizues i vetëm, ku përfshiheshin produkte të cilat nuk do të figurojnë më në kontratën finale në mënyrë që kompanitë që ishin informuar, të mund të bënin oferta të ulëta mbi këto pajisje, për të krijuar një avantazh ndaj konkurrencës, në çmimin e përgjithshëm. Marifete të tjera përfshijnë telefonatat anonime dhe kërcënimet për të dekurajuar pjesëmarrjen, heqjen e faqeve apo dokumentacionit të regjistrimit nga ofertat e pavolitshme për t'i diskualifikuar ato, apo anulimin dhe ritenderimin deri sa të arrihet rezultati i dëshiruar (kjo ndihmohet nganjëherë duke u lejuar kompanive të favorizuara të kopjojnë dokumentacionin teknik të dorëzuar më parë nga konkurrentë më profesionistë). Përndryshe, kompanitë e favorizuara bëjnë oferta me çmime jo realiste për të fituar tenderin dhe më pas shpërblehen me klauzola bujare shtesë.<sup>363</sup>

Shumë shpesh ai që shpallet fituesi i tenderit është një nga kompanitë që ka bërë ofertën më të shtrenjtë. Autoritetet e justifikojnë këtë me argumente mbi cilësinë superiore, por kjo është hedhur poshtë si “gjepura” nga një rregullator duke qenë se përmbushja e specifikimeve të

<sup>362</sup> Një këshilltar ndërkombëtar për agjencinë qendrore rregullatore tha se çdo kontratë që kishte parë kishte nga një problem madhor dhe se çdo zyrtar i prokurimit lokal me të cilin ai kishte arritur të fliste privatisht kishte pranuar se të gjitha proceset e tenderimit ishin manipuluar. Intervistë, 18 dhjetor 2009.

<sup>363</sup> Intervista: drejtorët e dy kompanive inxhinierike, 10, 16, 18 dhjetor 2009; drejtorët e dy agjencive rregullatore, 15, 18 dhjetor 2009.

tenderit duhet të mbulojë edhe cilësinë.<sup>364</sup> Pas denoncimit nga një gazetë në dhjetor 2009, Ministria e Arsimit anuloi një tender që ia kishte dhënë një ofertuesi, që për sa i përket çmimit ishte renditur i nënti nga njëmbëdhjetë ofertues, për instalimin e kabineteve informatike dhe internetit në shkolla anembanë Kosovës: oferta prej 40 milion eurosh e kësaj kompanie ishte 24 milion euro më e shtrenjtë sesa oferta më e lirë.<sup>365</sup> Si informata e botuar në faqen online të Agjencisë së Prokurimeve Publike ashtu dhe përgjigja publike e ministrisë e fshihnin vlerën totale të kontratës, duke iu referuar vetëm çmimeve për njësi.<sup>366</sup> Po ashtu, kompanitë fillojnë punën, si për shembull, ndërtimin e rrugëve, përpara se të shpallet tenderi për të ndihmuar kryetarët e komunave, si në rastin e Isa Mustafës së LDK-së në Prishtinë<sup>367</sup> apo Sami Lushtakut të PDK-së në Skenderaj,<sup>368</sup> duke pritur që formalizimi dhe pagesa të bëhen më pas. Dënimet për afatet dhe cilësinë zakonisht nuk zbatohen<sup>369</sup> kurse ligji për prokurimin publik nuk mbulon zbatimin e kontratës.<sup>370</sup>

## Molepsja e ambientit të biznesit

Ekonomitë e zhvilluara të kohëve tona, janë të tilla sepse “qeveritë mësuuan ta trajtojnë ekonominë kombëtare si një burim ushtarak, që duhet ushqyer e ndihmuar në vend që të plaçkitesh.”<sup>371</sup> Në kontrast me këtë, formimi i vonuar dhe i “dekafeinuar” i shtetit të Kosovës ka qenë mjaftueshëm i mbrojtur dhe i subvencionuar nga sponsorët ndërkombëtarë, duke bërë që qeveria e saj të mos e shohë politikbërjen efikase në fushën e ekonomisë si një çështje mbijetese politike. Në Kosovë, tranzicioni

<sup>364</sup> Intervistë, Ilaz Duli, Kryetar, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, 18 dhjetor 2009

<sup>365</sup> Besnik Krasniqi, “Loja me milionat e shtetit”, *Koha Ditore*, 16 dhjetor 2009.

<sup>366</sup> Shih “Reagim i MASHT-it lidhur me shkrimin ‘Loja me milionat e shtetit’”, *Koha Ditore*, 17 dhjetor 2009. Kontrata që ishte publikuar në faqen online të Agjencisë së Prokurimit Publik u qas nga NDRNJ me 18 dhjetor 2009.

<sup>367</sup> Intervistë, zyrtar, Agjensioni Kundër Korrupsionit, 15 dhjetor 2009.

<sup>368</sup> Raporti i Jeta Abazit mbi qeverisjen vendore në Skenderaj, *Jeta në Kosovë*, televizioni RTK, 28 maj 2009.

<sup>369</sup> Intervistë, Hasan Preteni, Drejtor, Agjensioni Kundër Korrupsionit, 15 dhjetor 2009.

<sup>370</sup> Intervistë, Ilaz Duli, Kryetar, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, 18 dhjetor 2009.

<sup>371</sup> Robert H. Bates, “Prosperiteti dhe dhuna: ekonomia politike e zhvillimit” [“Prosperity and Violence: The Political Economy of Development”], New York: Norton, 2001, fq. 103.

nga ushtrimi i forcës nga ana e shtetit si një mënyrë për të grabitur pasurinë, drejt përdorjes produktive të mjeteve detyruese shtetërore që karakterizon ekonomitë e zhvilluara, është i paplotë dhe nuk ndihmohet me incentiva të njaftueshme. Përkushtimi i elitës politike ndaj promovimit të një konkurrence të plotë në treg është gjysmak. Kjo elitë nuk do që të humbasë kontrollin e saj mbi instrumentet e patronazhit që i vë në dispozicion një ekonomi më e manipuluar dhe duket besimplotë se metodat aktuale mund ta mbajnë atë në pushtet në zgjedhjet e ardhshme.<sup>372</sup>

Në vend që të eliminonte shpërdorimet që karakterizuan administratën e mëparshme të AAK-LDK, si për shembull, krijimin e sistemeve të licencimit të importeve që lejonin zhvatjen e bizneseve nga zyrtarët, qeveria aktuale duket se i ka rafinuar dhe përshkallëzuar më tej këto abuzime, duke krijuar një klimë frike dhe trembjeje, që mjafton për t'i mbajtur këto gjëra larg vëmendjes së publikut. Qeveria ka krijuar ligje dhe rregulla që pengojnë zhvillimin e sektorit privat, duke u rezervuar hapësirë bizneseve të favorizuara. Ky investim i penguar në sektorin privat në 2009, do të kufizojë rritjen ekonomike në 2010.<sup>373</sup>

Në vend që t'i kanalizojnë kohën dhe përpjekjet e tyre drejt zhvillimit, në 2009 shumë bizneseve dhe Odës Ekonomike iu desh t'i përdorin ato për të luftuar kundër nismave grabitqare të qeverisë e cila në emër të kontrollit të cilësisë synonte të krijonte monopole apo të vendoste filtra të rinj të cilët favorizonin kompani të caktuara ndërkohë që përjashtonin kompani të tjera: qoftë në rastin e monopolizimit të importeve farmaceutike, importeve të karburanteve, ri-regjistrimin e depove doganore apo krijimin e monopoleve për importin e të gjitha produkteve me origjinë shtazore.<sup>374</sup> Zëvendës kryeministri Hajredin Kuçi e pranoi se ka nevojë për një reformë totale të qasjes së

qeverisë ndaj licencimit: “Ne duhet të krijojmë mundësi, dhe jo pengesa për bizneset.”<sup>375</sup>

Spastrimi i paralajmëruar nga qeveria në mesin e 2008 për sektorin e parregulluar dhe fitimprurës të universiteteve private ishte i nevojshëm.<sup>376</sup> Megjithatë, dy vjet më pas disa institucione janë lënë në harresë. Pranimet në “kolegjin” AAB Riinvest (një kategori e përkohshme e paparashikuar në ligjin për arsimin e lartë, por që është aplikuar për disa institucione) është kufizuar në 700 në vitin 2009: të 2000 studentët që ka në total janë shumë të paktë për të mbuluar shpenzimet. “Mos vallë duan të na heqin qafe dhe të ngrenë universitetet e tyre private?” pyeste një palë e interesuar.<sup>377</sup> Muajt e fundit qeveria ka bërë progres me planet e saj për themelimin e Universitetit të Prizrenit, një partneritet publiko-privat, që ka si synim të pranojë 5000 studentë në 2010. Në një kohë që 15000 studentë kërkojnë vende në universitet çdo vit, dhe kur Universiteti i Prishtinës po zgjerohet duke e rritur numrin e pranimeve në 30% në 14000 në 2009,<sup>378</sup> dhe është duke hapur pesë degë të reja provinciale, universitetet private mund të mos kenë ndonjë treg të madh në momentin kur situata e tyre të zhbllkohet.<sup>379</sup>

Në fillim të 2008, qeveria aktuale pati një fillim të mbarë duke bërë konsultimet e nevojshme në lidhje me projektligjet mbi ekonominë, por kjo nuk vazhdoi. Cilësia e personelit të qeverisë nuk ishte e atillë sa ta bënte të aftë të përballonte dhe të zbatonte një gjë të tillë.<sup>380</sup> Ajo prodhoi një rrëmujë ligjesh publike të vagëta dhe të paqarta, të cilat kërkonin saktësi përmes udhëzimeve administrative që i liheshin në dorë qeverisë: “ai tip legjislacioni që sheh në diktatura moniste si Uzbekistani.”<sup>381</sup> Projektligji anti-dumping i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (e drejtuar nga LDK) injoron direktivat relevante të BE-së

<sup>372</sup> Shih librin e lartpërmendur të Bates për prapavijën e problemit, sidomos për shtet-ndërtimin e periudhës pas Luftës së Dytë Botërore.  
<sup>373</sup> Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës Besim Beqaj, komente në RTV 21, shkurt 2010.  
<sup>374</sup> Intervista: dy zyrtarë të lartë të Odës Ekonomike, 18 nëntor 2009 dhe 19 shkurt 2010; menaxherët e dy bizneseve që importojnë produkte ushqimore, 22 shkurt dhe 3 mars 2010.

<sup>375</sup> Intervistë, 20 maj 2010. Ai shpjegoi se ministritë dhe përfaqësuesit relevantë të Odës Ekonomike dhe Bankës Botërore u mblodhën për të diskutuar keto reforma në 18 maj 2010.  
<sup>376</sup> Shih raportin e Institutit GAP, “Një Shqyrtim i Arsimit të Lartë Privat në Kosovë”, 27 maj 2008. <http://www.gapinstitute.org/?cid=2,25>.  
<sup>377</sup> Intervistë, 4 dhjetor 2009.  
<sup>378</sup> Besa Bytyçi, “Rritet numri i studentëve në UP për 30 për qind,” *Zëri*, 5 shtator 2009.  
<sup>379</sup> Korrespondencë me zyrtarin e një “kolegji” privat, 17 maj 2010.  
<sup>380</sup> Intervistë, zyrtar, Oda Ekonomike e Kosovës, 19 shkurt 2010.  
<sup>381</sup> Intervistë, këshilltar ndërkombëtar i qeverisë, 26 mars 2010.



dhe i nje ministrit diskrecionin të deklarojë se në cilat raste bëhet fjalë për dumping si dhe të vendosë taksat doganore. Në duart e gabuara, kjo krijon një mekanizëm për të përfutuar ryshfete nga importuesit, por edhe nga prodhuesit vendas, të cilët kërkojnë mbrojtje; mbrojtje që vjen në kurriz të konsumatorëve të Kosovës.<sup>382</sup> Një projektligj mbi krijimin e rezervave shtetërore të produkteve strategjike nuk përcakton se ç'ndodh me to pas skadimit.<sup>383</sup> "Ata po përpiqen t'ia përshtatin ligjin praktikave të korruptuara."<sup>384</sup>

"Kompanitë politike" të favorizuara nga qeveria janë në rritje në disa sektorë – shumë prej tyre më parë ishin firma të vogla apo të sapo krijuara, të ardhurat e të cilave arritën në dhjetëra miliona euro si pasojë e kontratave nga sektori publik. Në përgjithësi, duke qenë se PDK ka një kohë më të shkurtër në qeverisje sesa partneri aktual i saj në koalicion, LDK, që deri pak kohë më parë ishte partia kryesore dhe më e madhe në Kosovë, rrethi i bizneseve që janë në terma miqësorë me PDK është shumë më i ngushtë, më i mbyllur, më i kujdesshëm dhe vuan nga një deficit ekspertize dhe kapacitetesh, kështu që rritja e tyre ngjason me atë të një skeme piramidale.

Njëri prej sektorëve të prekur është ai i energjisë elektrike dhe i minierave të qymyrit që janë të lidhura me të. KEK ka adoptuar një furnizim të "negociuar" nga një burim i vetëm për një pjesë të madhe të kontratave të saj me vlerë të lartë. Prokurimi menaxhohet nga njeriu me të njejtin mbiemër si kryeministri, nga i njejtë fshat.<sup>385</sup> Mehdi dhe Ilmi Zhugolli, vëllezër dhe pronarë të dy kompanive, Ecotrade dhe ACDC KOS, mohojnë afërsi me vëllezërit Thaçi,<sup>386</sup> fituan mbi 75 milion euro kontrata nga KEK në 2008 dhe 2009: një rritje eksponenciale në vitet e

<sup>382</sup> Ibid.

<sup>383</sup> Intervista: deputet i Kuvendit, 26 shkurt 2010 dhe një zyrtar ndërkombëtar, mars 2010.

<sup>384</sup> Intervistë, këshilltar ndërkombëtar, 26 mars 2010.

<sup>385</sup> Njazi Thaçi është emruar në pozitë në shtator 2007, disa muaj para marrjes së pushtetit nga qeveria Thaçi. Edhe pse disa media kanë raportuar që ai është kusheri i Kryeministrit kjo nuk është e saktë. Intervistë, Njazi Thaçi dhe zyrtarë të lartë në KEK, maj 2010.

<sup>386</sup> Burime nga Oda Ekonomike e Kosovës folën për lëvizje tentative nga Ilmi Zhugolli, pronar i AC/DC që të bëhej kryetar i Odës në 2009, por kjo nuk u përkthye në një kandidim zyrtar për zgjedhjen për këtë post. Intervista, 18 nëntor 2009 dhe 19 shkurt 2010.

mëparshme.<sup>387</sup> Pothuajse të gjitha kontratat që fituan këto dy kompani u "negociuan" sipas aranzhimeve me një burim të vetëm dhe ndër të përfshihej një kontratë prej 50 milion eurosh: 14 milionë euro më e shtrenjtë se një ofertë tjetër.<sup>388</sup> Mbështetja e KEK-ut në furnizimin një-burimor të këtyre kompanive është për tu dyshuar. Meqë ato vetë duket se kanë kapacitete të kufizuara edhe kur vjen puna për të vepruar si ndërmjetës tregtarë.<sup>389</sup>

Favorizimi nga ana e qeverisë e kompanive "politike" jo-serioze pengon rritjen e bizneseve profesionale e konkurruese, duke ulur aftësinë e tyre për të ndërtuar një punësim të qëndrueshëm. Drejtori i një kompanie inxhinierike kosovare, që është i përjashtuar nga ky rreth, argumentonte se kontraktimet e KEK-ut do të mund të përdroreshin më mirë për të mbajtur në këmbë një grup biznesesh mesatare, secili prej të cilëve ka të punësuar dhe përfiton pervojë, në vend që t'ia japë

<sup>387</sup> Kontrata e Ecotrade me KEK-un në 2009-0 ka arritur €63 million, në rritje nga €1.125 milion në 2007, €2 milion në 2006, €3.746 milion në 2005, dhe €1.77 milion në 2004. Dokumente të siguruar nga KEK, maj 2010.

<sup>388</sup> Informacion i marrë nga faqja e internetit e Agjencisë së Prokurimit Publik. Kontrata 50 milion eurosh e dha si më e madhja ndër dy pako pune që përfshinin riparimi komplet me çelës në dorë i sistemeve të shiritave transportues-palosëve dhe sistemeve shpërndarëse për largim të djerrinës në minierat e qymyrit e KEK-ut. Kontrata u dha si një kontratë e "negociuar" me një burim të vetëm pasi që komisioni i vlerësimit i KEK-ut diskualifikoi ofertat e dy ofertuesve më të lirë. Oferta më e lirë, prej 35.5 milion eurove, ishte nga kompania polake e inxhinieringut, Kopex S.A. Ajo bëri ankesë të detajuar te Organi i Shqyrtues i Prokurimit, i cili e mbështeti diskualifikimin, ndonëse vlerësimi i pikëve nga ana e KEK-ut ishte i çuditshëm: shumë artikujve në ofertën e Kopex-it iu dhanë pikë minimale teknike, pra 1 nga 9 pikë, ndonëse burimi i tyre ishte nga prodhues të njohur evropianë, ndërkohë që arsyet e diskualifikimit përfshinin ofertën e Kopex për të zëvendësuar mekanizmat 20 vjeçare të ingranazhit me mekanizma të reja në vend që t'ia riparonte ato. Shih procesverbalin e hapjes së tenderit, 15 shtator 2008. Njoftimi për Dhënie të Kontratës nga KEK, 7 nëntor 2008 (Menaxhmenti i KEK-ut në retrospektive ka argumentuar që ky njoftim i publikuar, gabimisht e ka definuar kontratën "e negociuar" një burimore e jo si tender të hapur. Korrespondencë, menaxhmenti i KEK, maj 2010) dhe ankesa e Kopex S.A. drejtuar Organit Shqyrtues të Prokurimit, 15 tetor 2008, KEK Vlerësimi Teknik i Dosjes të Tenderit (Pjesa mekanike) Prokurimi Nr: KCBC-653/2-08-511 dhe vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit, 6 nëntor 2008.

<sup>389</sup> Ecotrade është shndërruar në derë nëpër të cilën duhet të kalohet në Kosovë për një numër të madh të kompanive të mëdha dhe të huaja inxhinierike. Shih <http://www.ecotrade-co.net/?page=2.7> lista e atyre që tani i përfaqëson. Ka deleguar punën e 50 milion eurove, më të madhën që ka fituar, kompanisë serbe IMK 14 tetor. Shih, Njoftimi për Dhënie të Kontratës nga KEK, 7 nëntor 2008. Një kompani rivale inxhinierike thotë që ka dhënë ofertën për furnizim me pjesë të makinës 40% më lirë se kontrata 10.3 milion euro të fituar nga AC/DC si kontratë të "negociuar" një burimore në tetor 2009. Intervistë, drejtor i kompanisë, 10 dhjetor 2009.

ato dy kompanive të shprazëta që ia kalojnë më pas punën nënkontraktorëve serbë dhe boshnjakë.<sup>390</sup> Kompanitë e zakonshme kanë frikë të konkurrojnë me kompanitë e “përzgjedhura” dhe tërhiqen nga tendera premtues në mënyrë që të shmangin problemet.<sup>391</sup> Ato demoralizohen si pasojë e kohës dhe energjisë së humbur dhe të shpenzimeve që sjell përpjekja për të konkurruar në tendera që janë të manipuluar kundër tyre, por dhe nga mos-mundësia për të kërkuar ndihmë—Organi Shqyrtues i Prokurimit është i uzurpuardhe ligji i prokurimeve publike nuk parashikon dërgimin e këtyre rasteve në gjykatë.<sup>392</sup>

Dështimi për të siguruar tendera publikë nuk u lejon bizneseve familjare që të rriten për t’u bërë ndërmarrje me përmasa mesatare,<sup>393</sup> apo që të zhvillojnë kapacitetet që do t’u lejonin të zbusnin problemin e papunësisë në Kosovë dhe të forcojnë sektorin e saj të mjerueshëm të eksporteve. Disa prej tyre përfundojnë të falimentuar. Kjo është veçanërisht problematike duke qenë se pjesa më e madhe e kompanive kosovare janë “të vogla dhe në stagnim, çka rezultojnë në një kërkesë të ulët dhe të pandryshueshme për krah pune.”<sup>394</sup> Pjesa më e madhe syresh gjenerojnë të ardhura vjetore prej më pak se 25,000 eurosh dhe punësojnë deri në pesë punonjës. Shumë pak prej tyre i kanë rritur fitimet dhe punësojnë më shumë njerëz: disa po përjetojnë rënie.<sup>395</sup>

Infuzioni i grupeve jo-formale në aparatën e qeverisë që u diskutua më lart, ku përfshihet personeli i SHIK-ut, e mban gjallë këtë atmosferë. Kjo qeveri është “më kërcënuese” se paraardhësjat e saj, tha një biznesmen.<sup>396</sup> Nëse ish kryeministri i AAK-së Haradinaj kishte një vëllë të vogël që kujdesej për disa fusha të interesave të familjes, kryeministri aktual ka më shumë vëllëzër: njëri prej tyre ka marrë një rol drejtues në shoqatën e kompanive të sigurimit.<sup>397</sup> Në qershor 2009, ky i fundit raportohet të ketë rrahur ish drejtorit të

<sup>390</sup> Intervistë, drejtor, kompani inxhinierike, 10 dhjetor 2009.

<sup>391</sup> Intervistë, drejtor i marketingut i një kompanie, 18 dhjetor 2009.

<sup>392</sup> E njëjta dhe drejtor, kompani inxhinierike, 10 dhjetor 2009.

<sup>393</sup> Intervistë, drejtor i marketingut i një kompanie, 18 dhjetor 2009.

<sup>394</sup> Memorandum Ekonomik i Kosovës i Bankës Botërore [World Bank Kosovo Country Economic Memorandum], op.cit. fq. 63.

<sup>395</sup> Ibid.

<sup>396</sup> Intervistë, drejtor marketingu i një kompanie, 18 dhjetor 2009.

<sup>397</sup> Intervista: komentator, 4 nëntor 2009; zyrtarë të Odës Ekonomike të Kosovës, 18 nëntor 2009 dhe 19 shkurt 2010; biznesmen i njohur, 18 dhjetor 2009.

PTK-së Etrur Rrustemi.<sup>398</sup> Në Odën Ekonomike të Kosovës, bizneset anëtare e ngrënë “çdo ditë” shqetësimin mbi ndikimin e vëllezërve në ekonomi.<sup>399</sup>

Megjithatë, biznesmenët kanë frikë t’i bëjnë publike problemet e tyre apo të japin prova për zhatjet nga qarqet qeveritare sepse “Biznesi im do të zhdukej.”<sup>400</sup> Një deputet komentoi se edhe pse biznesmenët shpesh ankohen se iu duhet të paguajnë deri në 50% të vlerës së kontratës për të fituar një tender, “Kur iu kërkoj prova të dokumentuara ata thonë se kanë frikë për familjet e tyre.”<sup>401</sup> Ankesat që i bëhen Odës Ekonomike të Kosovës përfshijnë gjithfarë abuzimesh me proceset e licencimit, por frika dhe mungesa e dëshirës për t’u identifikuar nga ana e anëtarëve të saj,<sup>402</sup> si dhe akti i balancimit politik me qeverinë që i duhet të bëjë Oda Ekonomike kanë parandaluar deri më sot një përfaqësim më të fuqishëm të tyre.<sup>403</sup> Shpesh bizneset nuk ankohen në mënyrë që të shmangin përplasjet me qeverinë dhe që të mos identifikohen si kundërshtarë.<sup>404</sup>

Privatisht, biznesmenët ankohen se autoritetet qeveritare i shohin ata si të kishin qenë spekulantë kriminalë, i trajtojnë si të tillë dhe madje i shtyjnë drejt kriminalitetit.<sup>405</sup> “Ata përpiqen të të korruptojnë që të të lidhin duart.”<sup>406</sup> Administrata Tatimore përmendet për arritjen e marrëveshjeve me disa kompani dhe ndërmarrjen e inspektimeve ndëshkimore kundër kompanive të tjera.<sup>407</sup> FMN ka pyetur përse kompanitë depozitojnë kaq pak ankesa në lidhje me tatimin e tepruar; përgjigja që morën ishte se kishin frikë nga ndonjë hakmarrje

<sup>398</sup> Kastriot Jahaj, “Etrur Rrustemi akuzon vëllanë e kryeministrit për sulm fizik ndaj tij”, *Koha Ditore*, 12 qershor 2009. Vëllai i Rrustemit, Naimi, deputet e ngriti më vonë çështjen në parlament. Agron Halitaj, “Rrustemi: Kryeministër, pse ma sulmuat familjen?!” *Koha Ditore*, 26 qershor 2009.

<sup>399</sup> Intervistë, zyrtar i lartë, Oda Ekonomike e Kosovës, 19 shkurt 2010.

<sup>400</sup> Ibid.

<sup>401</sup> Intervistë, 26 shkurt 2010.

<sup>402</sup> Intervistë: zyrtar i lartë, Oda Ekonomike e Kosovës, 19 shkurt 2010.

<sup>403</sup> Intervistë, drejtor i marketingut, kompani e importimit të produkteve ushqimore, 3 mars 2010 dhe 19 maj 2010.

<sup>404</sup> Ibid, 3 mars 2010.

<sup>405</sup> Ibid.

<sup>406</sup> Intervistë, deputet i kuvendit dhe ish drejtor kompanie, shkurt 2010.

<sup>407</sup> Intervista: zyrtar i Odës Ekonomike të Kosovës, 18 nëntor; drejtor i marketingut, kompani e importimit të produkteve ushqimore, 3 mars 2010.

që do t'i rrënohte.<sup>408</sup> Vetëm shërbimi doganor i trajton biznesmenët si partnerë, duke organizuar takime mujore. Ky shërbim u ngrit nga UNMIK-u; agjencitë dhe ministratë e tjera e filluan jetën e tyre të menaxhuara nga autoritetet e Kosovës, me rroga të ulëta – me personel me cilësi të ulët, disa prej të cilëve të korruptuar, çka ndalonte instalimin e një profesionalizmi më të madh.<sup>409</sup> Të ardhurat nga shërbimet doganore janë rritur me të njëjtin ritëm që është rritur edhe PBB e Kosovës; të ardhurat nga Administrata Tatimore janë në stagnim. Ajo ka dështuar të zgjerojë bazën e tatimeve dhe të reduktojë ekonominë e madhe informale.<sup>410</sup>

Ndërkohë që disa biznese po arrijnë maturinë dhe gatishmëria e tyre për të adoptuar rregullat dhe pagesat tatimore rritet nga viti në vit, qeveria është e paafte të ecë me të njëjtin ritëm.<sup>411</sup> Ajo është treguar e ngadaltë në eliminimin e konkurrencës së pandershme nga tregtia informale si dhe të kontrabandës që dëmton tatimet apo bizneset që i përmbahen rregullave.<sup>412</sup> Në fakt, mund të thuhet se ajo po punon për të arritur të kundërtën: “Qeveria është operatori më i madh në tregun e zi dhe një kërcënim ndaj biznesit.”<sup>413</sup>

Importimi i mishit po rezulton të jetë një test jetik për marrëdhëniet mes qeverisë dhe biznesit. Zhvendosja e Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit (AVUK) nga Ministria e Bujqësisë në Zyrën e Kryeministrit i parapriu iniciativës së këtij të fundit të ndërmarrë në qershor 2009. Kjo nismë që u ndërmor në emër të sigurisë, mori formën e një Direktiva Administrative dhe të një njoftimi për tender, që do t'i lejonte një kompanie të huaj të kishte monopolin mbi importin e të gjithë produkteve me origjinë shtazore,<sup>414</sup> me një vlerë

<sup>408</sup> Intervistë, zyrtar i lartë, Oda Ekonomike e Kosovës, 19 shkurt 2010.

<sup>409</sup> Intervistë, drejtor i marketingut, kompani e importimit të produkteve ushqimore, 3 mars 2010.

<sup>410</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar i mbikëqyrjes, 19-20 prill 2010.

<sup>411</sup> Intervistë, drejtor i marketingut, kompani e importimit të produkteve ushqimore, 3 mars 2010.

<sup>412</sup> Ibid dhe intervistë, drejtor i marketingut, kompani e importimit të produkteve ushqimore, 22 shkurt 2010.

<sup>413</sup> Intervistë, drejtor i marketingut, kompani e importimit të produkteve ushqimore, Ibid.

<sup>414</sup> Direktiva Administrative 07/2009. Pas protestave të para qeveria ofroi si kompromis një tender që do t'u jepte licenca importi disa kompanie (jo detyrimisht ndërkombëtare). Shkelzen Dakaj, “Qeveria heq nenin 8, mishtarët prapë të pakënaqur”, *Zëri*, 7 korrik 2009. Analisti Shpend Ahmeti ngriti dyshimin nëse procesi që propozonte qeveria mund të quhej një tender i ligjshëm duke qenë se qeveria nuk po blinte as mallra e as shërbime. Shkelzen Dakaj et al, “Mishtarët

vjetore prej 600 milion eurosh.<sup>415</sup> Nisma u tërhoq pas protestave të shoqërive të biznesit dhe ndërhyrjes së Ambasadës Amerikane. Pasi dështoi me këtë nismë, raportohet se AVUK po eksperimenton me zgjerimin e kontrolleve joformale dhe tatimeve të jashtëligjshme mbi importet e ushqimeve, sektor pas sektori. Deri më sot kjo ka prekur filetot e pulave dhe bananet,<sup>416</sup> por ka shenja se do të shtrihet edhe në nënprodukte të tjera mishi.<sup>417</sup>

Disa parti të këtyre mallrave të disa prej importuesve të mëdhenj janë bllokuar prej AVUK që prej mesit të 2009, dhe janë lënë të kalben në kufi. Dy prej të intervistuarve kishin hequr dorë nga këto sektorë të importit për të shpëtuar pjesë të tjera të bizneseve të tyre: të detyruar t'i lëshojnë rrugë ekskluzivitetit që po krijojnë njerëzit e qeverisë për kompanitë e tyre të preferuara.<sup>418</sup> Ka të tjerë që kanë pranuar të bëhen pjesë e një skeme që i detyron ata të paguajnë 8000 euro për kamion tek një kompani e regjistruar në lagjen periferike të Prishtinës, Vranjevc, në mënyrë që të marrin lejen e kalimit kufitar nga AVUK, dhe t'i shesin e t'i blejnë partitë e tyre prej kësaj kompanie: duke lejuar kësajsoj pastrimin e parave, manipulimin e certifikatave të TVSH-së dhe konvertimin e atyre që ishin fillimisht importe zyrtare në importe të parregulluara.<sup>419</sup> Çmimet e shitjes me pakicë të pulës, për shembull, u rritën me 10-20% në muajt e fundit.<sup>420</sup>

Ka dyshime se njerëzit në qeveri i përdorin këto mekanizma për të shtënë nën kontroll kompanitë

---

porosisin qeverinë: Mos pritni që e tërë Kosova të dalë në rrugë!” *Zëri*, 11 July 2009. Edhe pas kompromisit të propozuar, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik arriti në përfundimin se “tenderi” i qeverisë binte ndesh me ligjet ekzistuese. Valon Maloku dhe Serbeze Haxhiqaj, “Tenderi për mish – i jashtëligjshëm” *Koha Ditore*, 13 korrik 2009.

<sup>415</sup> Vlerësime nga drejtori i një kompanie të importit të produkteve ushqimore, intervistë, 22 shkurt 2010.

<sup>416</sup> Intervista: zyrtarë të Odës Ekonomike të Kosovës, 18 nëntor 2009 dhe 19 shkurt 2010; Ibid dhe drejtor marketingu për një kompani të importit të produkteve ushqimore, 3 mars 2010.

<sup>417</sup> Intervistë, drejtori i një kompanie të importit të produkteve ushqimore 10 mars 2010.

<sup>418</sup> Intervista: drejtori i një kompanie të importit të produkteve ushqimore, 22 shkurt 2010 dhe drejtori i marketingut i një kompanie të importit të produkteve ushqimore, 3 mars 2010.

<sup>419</sup> Intervista: zyrtarë të lartë, Oda Ekonomike e Kosovës, 18 nëntor 2009 dhe 19 shkurt 2010; një biznesmen i prekur në mënyrë indirekte 18 dhjetor 2009, dhe tre biznesmenë të prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë, 22 shkurt, 3 mars, 10 mars 2010.

<sup>420</sup> Intervista, importues[plural] të produkteve ushqimore, 22 shkurt dhe 3 mars 2010.

dhe projektet e investimit të sektorit privat që dëshirojnë: duke kërkuar dhënien e aksioneve dhe një pjese të fitimeve apo punësimin e garantuar me rroga të mëdha për njerëz të caktuar. “Bizneset që bëhen më të mëdha dhe të suksesshme tërheqin vëmendjen e tyre”.<sup>421</sup> Një kompani që u intervistua ishte në një situatë veçanërisht të vështirë – AVUK kishte bllokuar pjesërisht importin e mishit që i nevojitej për të përpunuar në fabrikën që kishte ngritur, e cila punësonte 70 vetë, si dhe për të siguruar kapitalin që i nevojitej për të financuar një fabrikë bulmetesh që ishte planifikuar të fillonte punë me 50 punëtorë, për të punësuar më pas 150 të tillë nëse planet për furnizuar tregun e rajonit do të kishin sukses. Në pjesën e dytë të kësaj manovre, punonjës të AVUK kërkuan që të përfshiheshin si partnerë biznesi – dhe në rast se kjo nuk ndodhte kompania do të haste në probleme të mëtejshme me kontrollin kufitar dhe Administratën Tatimore.<sup>422</sup> Në prill 2010 kryeminsitri Thaçi e zëvendësoi kreun e AVUK,<sup>423</sup> por situata nuk ndryshoi.<sup>424</sup>

Qeveria duket e vendosur të imponojë kontrollin dhe jo rregullat; “Edhe tani, nuk mund të ekzistosh si kompani nëse nuk je në të njëjtën linjë me ta...nëse vazhdojmë si këtë vit do të na mbeten vetëm 20 kompani – të gjitha pranë qeverisë, të gjitha kriminale.”<sup>425</sup> Deri më sot Oda Ekonomike ka qenë e matur në rezistencën ndaj ngacmimit të bizneseve anëtare nga zyrtarët, duke u përkujdesur që mos t’i këpus marrëdhëniet me qeverinë. Që prej largimit të ish presidentit Besim Beqaj në prill 2010 për të marrë postin e Ministrit të Integritimit Europian, disa biznese anëtarë të Odës po konsiderojnë zgjedhjen e një zëvendësuesi që të jetë i gatshëm të mbajë në qëndrim kundërshtues

më të hapur, dhe ta bëjë Odën madje edhe mjet të opozitës politike.<sup>426</sup>

Nëse lëmë mënjanë retorikën mikëpritëse të tyre, zyrtarët qeveritarë nuk kanë qenë domosdoshmërisht akomodues ndaj investitorëve të huaj, të cilët refuzojnë të hyjnë në Kosovë duke iu përmbajtur kushteve të tyre. Disa kompani të mirënjohura anembanë botës shprehën interesin e tyre në marrjen e licencës së operatorit të dytë të telefonisë celulare përpara se të tërhiqeshin njëra pas tjetrës.<sup>427</sup> Ambasada e SHBA sugjeroi me këmbëngulje se dhënia e aeroportit të Prishtinës në 14 maj 2010 me një koncesion njëzet vjeçar konsorciumit franko-turk të Aeroport de Lyon dhe Limak Holdings “përfaqëson një ndryshim të paradigmave” çka provon se skeptikët që vinin në dyshim aftësitë institucionale të Kosovës për të tërhequr investitorë afatgjatë të respektueshëm, gabohen.<sup>428</sup>

Privatizimi i planifikuar i PTK-së do të tregojë nëse kjo është e vërtetë. Janë ngritur shqetësime nga shumë anë në lidhje me përzgjedhjen e këshilltarit të shitjes nga ana e qeverisë, firma e panjohur e regjistruar në Lihtenshtajn, Telco AG, e cila nuk duket sikur ka ndonjë përvojë në këtë fushë. Kur je duke shitur një kompani vlera e së cilës mund të jetë sa 12.5% e PBB të Kosovës, “duhet të tregohesh i kujdesshëm se ç’këshilltarë zgjedh.”<sup>429</sup> Një “këshilltar strategjik” tani është involvuar që të ndihmoj “këshilltarin për transakcion”.<sup>430</sup> Ka nga ata që e kanë vlerësuar vlerën e PTK në më shumë se 800 milion euro.<sup>431</sup> Zërat që janë më pranë procesit aktual sugjerojnë

<sup>421</sup> Intervistë, këshilltar ndërkombëtar, 26 mars 2010.

<sup>422</sup> Intervistë, drejtor, kompani e përpunimit të ushqimit, 10 mars 2010.

<sup>423</sup> Nebih Maxhuni, “Sharra e shëndëtshe”, *Express*, 8 prill 2010. Deklarata e kryeministrit përmendi abuzimet e listuara në një raport nga Auditori i Përgjithshëm, shumë ankesa mbi kontrollin e dobëta të cilësisë së ushqimeve të tregtuara si dhe menaxhimin e keq, si arsye për largimin e Qash Kabashit.

<sup>424</sup> Intervistë, drejtor marketingu, kompani e importit të produkteve ushqimore, 19 maj 2010. NDRNJ i ngriti dyshimet mbi sjelljen e AVUK me Zëvendës Kryeministrin Hajredin Kuçi. Ai sugjeroi se bizneset e prekura duket t’i dërgonin ankesat e tyre tek Policia e Kosovës apo tek EULEX për t’u hetuar. Intervistë, 20 maj 2010.

<sup>425</sup> Intervistë, zyrtar, Oda Ekonomike e Kosovës, 18 nëntor 2009.

<sup>426</sup> Intervistë, drejtor i marketingut, kompani e importit të produkteve ushqimore, 19 maj 2010. Në një situatë shumë të ngjashme me atë në 2009 për të promovuar kandidaturën e Hilmi Zhugollit, një biznesmeni i afërt me qeverinë, tani biznesmeni përkrahës i opozitës, AAK, Ramiz Kelmendi, pranoi kompanisë importuese ELKOS, po konsideron të kandidoj.

<sup>427</sup> Projekt-raporti i Klubit për Politikën e Jashtme: “Si po i largon korrupsioni investitorët nga Kosova.” Raporti detajon këtë dhe studimin e dy rasteve të privatizimeve që ndjekin të njëjtin model. Të tre këto raste datojnë nga periudha e qeverisjes së mëparshme të AAK-LDK mes 2004 - 2007.

<sup>428</sup> Christopher Dell, Ambasador i SHBA në Kosovo, “Koncesioni i Aeroportit”, 18 maj 2010. Shih: [http://pristina.usembassy.gov/dell\\_statements.html](http://pristina.usembassy.gov/dell_statements.html).

<sup>429</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar i mbikëqyrjes, 19-20 prill 2010.

<sup>430</sup> Parim Olluri, “Qeveria me dy kompani konsulente për shitjen e PTK-në”, *Koha Ditore*, 14 maj 2010.

<sup>431</sup> Lawrence Marzouk, “PTK të shitet deri në gusht” [“PTK to be Sold by August”], *Prishtina Insight*, 29 janar 2010.

300 milion euro.<sup>432</sup> Një zyrtar ndërkombëtar komentoi se investitorët e lidhur me qeverinë i vlerësojnë asetet e privatizuara me çmime më të ulëta se ç'do të bënte një investitor i huaj efikas, i cili është i aftë t'i bëjë ato të punojnë me maksimumin e kapaciteteve të tyre.<sup>433</sup>

Një sondazh i Bankës Botërore në 2009 zbuloi se investitorët po i qëndrojnë larg Kosovës sepse nuk mund të gjejnë ndonjë rrugë për të shmangur "xhunglën" e korrupsionit, ndërkohë që 80% përmendnin sjelljet penguese apo kërkimin e ryshfeteve nga ana e zyrtarëve publikë.<sup>434</sup> Interesimi i një prodhuesi automjetesh për të blerë një fabrikë pjesësh këmbimi u shua pasi kaloi në Zyrën e Kryeministrit dhe u ngarkua me kërkesa për disa poste me rroga të mëdha; përfaqësuesit e autoriteteve lokale i kanë kushtëzuar investimet e propozuara nga kompanitë e huaja me kërkesa për një pjesë prej 10-20% të fitimeve për të garantuar një funksionim të mirë; ka po ashtu raporte për zyrtarë të ministrive që kërkojnë pagesa prej 10000 eurosh për leje dhe qasje tek ministri.<sup>435</sup>

## Pasojat

Biznesmenët e kanë gjithnjë e më të vështirë të ushtrojnë dhe zhvillojnë profesionin e tyre siç do të dëshironin; atyre po u mbyllen dyert. Komuniteti i vogël dhe i dobët i biznesit në Kosovë është i trembur, një komunitet në presion dhe jo një komunitet në rritje e sipër.<sup>436</sup> Ndikimet normative janë duke u pakësuar, ndërkohë që presionet që nxisin kriminalitetin vijnë duke u përforcuar. Në vend që të vendosin rregull dhe të ofrojnë mbrojtje, organet shtetërore po kthehen në grabitqarë. "Çdo gjë po centralizohet, kështu që dikush mund të urdhërojë: 'nesër do të vjedhësh për mua.'" <sup>437</sup> Teksa qeveria e kufizon pronësinë, dhe krerët qeverisës marrin një pjesë gjithnjë e më të madhe nën kontrollin e tyre, decentralizimi dhe diversifikimi i fuqisë ekonomike nuk po lejohen të

<sup>432</sup> Intervistë, konsulent, 9 shkurt 2010.

<sup>433</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar i mbikëqyrjes, 19-20 prill 2010.

<sup>434</sup> Fjalë e mbajtur në konferencë nga Ranjit Nayak, përfaqësuesi i Bankës Botërore në Kosovë, Prishtinë, 16 dhjetor 2009.

<sup>435</sup> Intervista, përfaqësues të OJQ-ve ndërkombëtare, 28 tetor 2009 dhe 26 mars 2010

<sup>436</sup> "Nëse është e gjallërishtme, rreziqet do të ishin më të vogla" tha një zyrtar ndërkombëtar i mbikëqyrjes. Intervistë, 19-20 prill 2010.

<sup>437</sup> Intervistë, zyrtar i Policisë së Kosovës, 3 dhjetor 2009

hedhin rrënjë. Shoqëria e gjallërishtme komerciale, që shpesh shihet si një nxitëse e shoqërisë civile dhe katalizatore e reformave të mëtejshme, e ka të pamundur të shfaqet. "Në qoftë se kam frikë të të tregoj se ç'po ndodh me tregun, kjo nuk është më demokraci" tha një biznesmen.<sup>438</sup>

Duke e ngurtësuar status-kuonë ekonomike nën kontrollin e saj, elita ekonomike po e atrofizon ekonominë, duke krijuar një sistem që është thujtë feudal, me një hierarki të papërgjegjshme që e ka kthyer një pjesë të madhe të popullsisë në vartës së saj. Ata që mbajnë frerët e qeverisë dhe kësorisoj edhe të pronësisë, janë të izoluar nga kostot ekonomike të kësaj politike rrënuese dhe do t'i varin shpresat në fitoret e tyre të vazhdueshme elektorale tek blerja apo komandimi i fitores. Duke qenë se në realitet statusi i kandidatit në BE për Kosovën është një mundësi kaq e largët, qeveritarët besojnë se nuk do t'ju duhet të paguajnë ndonjë çmim për shkeljen e kushteve të BE-së gjatë viteve në vijim; në fakt, qeveria është mësuar që Kuinti ta mbrojë nga pasojat e shkeljeve të saj.

Dëmet materiale janë të mëdha: të lejosh që tatimet të mos hyjnë në buxhetin e shtetit, të marrësh para prej tij apo të caktosh një pjesë të madhe të tij për shpenzime kapitale prishanike, do të thotë të mos lejosh rritjen e pensioneve apo të pagesave të sigurimeve shoqërore as deri në nivelin e mbijetesës, si dhe të mos lejosh që rrogat për pjesën më të madhe të punonjësve të sektorit publik të rriten mbi nivelin e mbijetesës. Manipulimet me skemat e importit të karburanteve, sektorin e energjetikës, produktet ushqimore dhe prokurimet rrisin çmimet dhe ulin cilësinë, duke vendosur një taksë mbi këdo. Në një shoqëri aq të varfër sa ajo kosovare këto ndryshime nuk janë thjesht marginale: ato kanë një ndikim serioz mbi jetën e popullsisë duke e kufizuar atë, duke i mbajtur ata rob të një ekzistence të dëshpëruar dhe të shterur, që u lejon shumë pak prej tyre të çlirohen nga varfëria apo të kenë energjinë dhe burimet që nevojiten për lirinë e shprehjes dhe për përfshirjen në jetën publike të vendit të tyre.<sup>439</sup>

<sup>438</sup> Intervistë, drejtor, kompani e importit të produkteve ushqimore, 22 shkurt 2010.

<sup>439</sup> Një komentator nga komuniteti i biznesit mendohet se nëse ekstremistët serb ndonjëherë kanë ëndrruar të bëjnë politika aq të

në ekonomi të “kompanive politike” të ngjashme me skemat piramidale e përshkallëzojnë edhe më tej brishtësinë ekonomike të Kosovës.

Dëmi moral që po i bëhet shoqërisë kosovare si pasojë e këtyre proceseve në jetën e saj ekonomike është po ashtu i jashtëzakonshëm: “Në Bullgari grupet kriminale horizontale po lidhen me qeverinë; këtu qeveria është një grup kriminal – ajo porosit krimet.”<sup>440</sup> “Krimi i organizuar po ndryshon formë – sot të duhet të jesh i lidhur me dikë në qeveri ose nuk mbijeton dot.”<sup>441</sup> Shumë qytetarë të thjeshtë po hidhen në duart e kriminelëve, si për shembull në rrjetet që organizojnë emigrimin e paligjshëm për në BE. Kostoja e kësaj doli në dritë në një tragjedi të tetorit 2009 në të cilën 15 shqiptarë të Kosovës u mbytën në Lumin Tisza teksa po kalonin me barkë në mënyrë klandestine nga Serbia në Hungari.

Këto politika që kufizojnë rritjen ekonomike gjithashtu e rrisin edhe ndjeshmërinë e Kosovës ndaj trazirave sociale dhe shpërbërjes të institucioneve të shtetit të cilat sado problematike që mund të jenë, garantojnë paqen civile dhe kësisoj edhe të drejtën elementare të shprehjes. Disa nga të intervistuarit shprehën frikën se pakënaqësia në rritje, institucionet e brishta dhe “një shtëpi e vjedhur nga i zoti i saj” mund të shkaktojnë një kolaps të ngjashëm me atë që ndodhi në Shqipëri në 1997.<sup>442</sup> Gjysma e qytetarëve nuk i fitojnë vetë paratë e tyre, duke u mbështetur në mëshirën e të tjerëve.<sup>443</sup> Ata 40–48% që janë të papunë, në fakt 74% të atyre nën 25 vjeç, nuk kanë ndonjë interes të madh në ruajtjen e stabilitetit të sistemit që po krijohet. Dëmi që po i bëhet krijimit të vendeve të punës dhe investimeve që do të zëvendësonin importet, siç ishte rasti i kompanisë së përpunimit të mishit që po shantazhohej, si dhe rritja e rolit dominant

---

dëmshme për Kosovën siç ka bërë vet qeveria e saj. Intervistë, nëntor 2009. Një gazetare kishte një opinion më pozitiv: qeveria e di se veprimet e saj janë të dëmshme, por ajo “duhet ta bëjë këtë për të paguar borxhet që mori për t’u zgjedhur”. Intervistë, Salie Gajtani-Osmankaq, gazetare, *Koha Ditore*, 22 dhjetor 2009.

<sup>440</sup> Intervistë, zyrtar i lartë, Oda Ekonomike e Kosovës, 18 nëntor 2009.

<sup>441</sup> Intervistë, zyrtar i Policisë së Kosovës, 3 dhjetor 2009.

<sup>442</sup> Intervista: Shpend Ahmeti, drejtor i Institutit GAP, 11 dhjetor 2009; kryetare i komisionit i kuvendit, 26 shkurt 2010; drejtor marketingu i një kompanie importi të produkteve ushqimore, 3 mars 2010; Nexhmedin Spahiu, drejtor, TV Mitrovica, 10 mars 2010. Bujar Bukoshi, politikan i LDK-së, fjalim në konferencën e Klubit për Politikën e Jashtme, “Barra e Korrupsionit” [“The Burden of Corruption”] op. cit.

<sup>443</sup> Blerim Shala, “Fundosja e iluzioneve”, [Sinking of Illusions], *Express*, 2 nëntor 2009.

## PËRFUNDIMI

Praktikat e qeverisjes së përshkruara në këtë raport po e zbehin dinjitetin dhe shpresat që fituan qytetarët e Kosovës pas deklaratës së pavarësisë. Në vend që të arrijë një hapje më të madhe ndaj botës për qytetarët e saj, klasa politike kosovare duket sikur është përshtatur mirë ndaj gjendjes gjysmë të izoluar të shtetit të ri dhe jetesës nga përvetësimi i një pjesë të pasurisë së pakët të qytetarëve të saj të mbajtur rob. Trajektorja e shtet-formimit të Kosovës, në vijim, ka dukshëm nevojë për korrigjime.

Në vend që t'i zgjerojë liritë e qytetarëve të saj, klasa qeverisëse kosovare duket sikur po i kufizon ato dhe më tej. Si nëpunësit publik, ashtu dhe pjesëtarët e komunitetit të biznesit duken të trembur. Ata që raportojnë mbi shkeljet e ligjit nga ana e qeverisë vihen nën presion. Zgjedhjet e para në Kosovën e pavarur shënuan një përkeqësim të procesit.

Institucionet e pavarura që kërkohen për mbikëqyrjen e monitorimin e funksionimit të shtetit në shërbim të qytetarëve nuk kanë rezultuar të jenë mjaft të forta. Në vend që të lejojnë ushtrimin e një profesionalizmi me vetëbesim dhe të paanshëm në shërbim të publikut, shumë institucione janë rikonceptuar si përçues të vendimeve të udhëheqjes politike kosovare nga lartë poshtë. Koncepti i interesit publik nuk projektohet në një mënyrë aq të fortë sa duhet.

Për shkak të një sërë arsyesh, në Kosovë ka një krizë të profesionalizmit. Ekspertiza, identiteti dhe krenaria profesionale janë në nivele shumë të ulëta. Pavarësisht shumë përjashtimeve të nderuara, kjo prek nëpunësit civilë, rregullatorët, sistemin gjyqësor, administratorët e zgjedhjeve dhe zyrtarët e prokurimeve. Por, ajo shtrihet edhe në botën e biznesit. Përforcimi i profesionalizmit do të jetë me një rëndësi jetësore për suksesin e shtetit. Inkurajimi i qoftë edhe një grupi të vetëm profesional strategjik për të qëndruar i bashkuar dhe mos “u ndarë apo blerë”<sup>444</sup> mund të inkurajojë

zhvillime të ngjashme në pjesë të tjera të shoqërisë.

Një ndër aspektet e reja më tronditëse në intervistën që i dha gazetave kryeprokurori i EULEX-it Johannes van Vreeswijk për të hedhur poshtë komentet e bëra një ditë më parë nga kryeministri, që shfaqja e një profesionisti plot vetëbesim, i sigurt në rolin e tij dhe i vendosur të ruante hapësirën e tij kundër cenimit nga kushdo. Ky rast tregoi, sesa e huaj është një gjë e tillë në përvojën e Kosovës.

Partitë që janë aktualisht në qeveri mbajnë përgjegjësi për praktikatat që kanë dëmtuar sferën publike të shtetit të ri që prej fillimit. Ato janë përgjegjëse për praktikat grabitqare, si abuzimi me prokurimet, që i kanë kushtuar buxhetit të paktën dhjetëra miliona euro. Këto politika po i mohojnë vendit rritjen ekonomike që aq dëshpërimisht i duhet për të ruajtur kohezionin social dhe për të dalë nga ajo geto ku gjenden aktualisht qytetarët e Kosovës. Reformat mbi licencimin dhe prokurimin që ka premtuar qeveria duhet të japin frytet e tyre. Po ashtu, institucionet e Kosovës duhet ta kthejnë në realitet apelin e ambasadorit të SHBA-ve, që Kosova të konsolidojë një zhvendosje paradigme, në mënyrë që të tërheqë investime të huaja afatgjata dhe të respektueshme.

Përgjegjësia për keqqeverisjen nuk mbetet vetëm tek partitë që janë në qeveri. Shpërdorimet aktuale, si krijimi dhe abuzimi me skemat licencuese, janë në përgjithësi variacione të skemave, pionierët e të cilave janë paraardhësit e kësaj qeverie. Çdo qeveri ka treguar një talent për të çuar më tej ato që ishin praktikatat më të këqija të paraardhësve, por tani kërkohet që kjo të përmbysset për të ngritur një rreth virtuoz të praktikave më të mira. Në komunat ku është në pushtet opozita politike, modeli i sjelljes është i ngjashëm me atë të partive që janë në qeveri. Nuk ka ndonjë arsye për të besuar se zëvendësimi i disa partive në qeveri me disa të tjera, do të mjaftojë për të sjellë ndonjë përmirësim të qenësishëm. Aktualisht, asnjë forcë politike nuk duket e aftë që edhe të fitojë zgjedhjet, edhe të ndryshojë sistemin.

Sot, funksioni i partive politike kosovare është të kanalizojnë pushtetin dhe patronazhin mbi burimet

<sup>444</sup> Intervistë, ish drejtori për Kosovë, agjensi për ndihmë, shkurt 2010.

e shtetit drejt udhëheqjeve partiake që janë të vështira për t'u kontrolluar apo për t'u larguar. Ato i dominojnë institucionet shtetërore dhe publike. Institucionet e Kosovës duhet të çlirohen dhe të rimerren nën kontroll në emër të interesit publik. Ato duhet të rrisin identitetin e tyre profesional. Partitë politike duhet të hapen në mënyrë që brenda tyre të qarkullojnë parimi i llogaridhënies dhe idetë e reja. Klasa politike aktuale duket shumë e konsoliduar dhe keq e pajisur për ta udhëhequr Kosovën drejt një zhvillimi të kënaqshëm shoqëror, ekonomik dhe institucional.

Është e paqartë se deri në ç'nivel partitë politike janë shkaku apo simptoma e një sëmundjeje. Edhe vetë shoqëria është e dobët dhe e ndrojtur. Mungon një kulturë e gjallërishtme asociative, kurse ndjenja e qytetarisë, e gëzimit dhe ushtrimit të të drejtave dhe e pronësisë mbi sferën publike është pak e zhvilluar. Prezenca e mbikëqyrjes ndërkombëtare kompenson pjesërisht për aftësinë minimale të shoqërisë kosovare për të vënë përpara përgjegjësisë institucionet e saj. Por, shoqëria kosovare duhet të marrë përsipër një pjesë më të madhe të kësaj barre.

Shanset që ka Kosova për t'u çliruar nga trajektorja aktuale, për të arritur në një situatë ku shoqëria e saj nuk përballet me kufizime, por me mundësi, reduktohen si pasojë e hapësirës së ngushtë të manovrimit që ka ajo dhe sponsorët e saj ndërkombëtarë. Procesi i papërfunduar i njohjeve ndërkombëtare të shtetit të Kosovës vendos kufizime dhe një pjesë e madhe e investimit politik ndërkombëtar në Kosovë shkon për të garantuar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë. Reformat e qenësishme paramendojnë ndryshime rrënjësore të cilat shoqëria dhe institucionet e brishta kosovare ndoshta edhe nuk mundën t'i menaxhojnë pa trazira. Ndërkohë që kërkojnë që Kosova ta çlirojë veten nga krimi i organizuar dhe korrupsioni, sponsorëve ndërkombëtarë të Kosovës nuk u pëlqen të rrezikojnë. Ata kanë parasysh trashëgiminë e konfliktit të paradokshëm ndëretnik të territorit dhe i përmbahen një politike të tipit "vazhdo me avazin e vjetër."

Në mënyrë që për problemet e identifikuara në këtë raport të mos ketë një zgjidhje revolucionare,

por një zgjidhje evolucionare, ka nga ata që thonë se përgjigja më e mirë do të konsistonte në një sërë masash legislative dhe institucionale. Tashmë qeveria ka thënë se do të rishikojë licencimin, prokurimin si dhe ligjin elektorale. Prapëseprapë, nëse politikës kosovare i mungon vullneti për të ndërmarrë reforma të mirëfillta, ajo do të gjejë mënyra dhe rrugë për të anashkaluar dhe t'i neutralizuar këto masa.

Ka nga ata që kanë frikë se Kosova është shumë e vogël në mënyrë që ndarja e pushteteve të shtetit të funksionojë ndonjëherë.<sup>445</sup> Aranzhimi hibrid i momentit, që përfshin mbikëqyrjen e ICR dhe të prokurorëve e gjykatësve ndërkombëtarë të EULEX-it të cilët zëvendësojnë kuadrot kosovare në çështje të ndjeshme, është konceptuar për të adresuar këtë sfidë, por kjo nuk mund të jetë një zgjidhje e përhershme. Kur kanë kaluar vetëm dy vjet nga pavarësia, tensioni mes kësaj prezence dhe qeverisë është duke u rritur.

Realisht, çdo ndryshim ka më shumë gjasa të vijë si pasojë e nismave apo nxitjeve nga ana e sponsorëve dhe mbikëqyrësve ndërkombëtarë të Kosovës, sesa të gjenerohet tërësisht nga aktorë vendas. Nëse EULEX-i i kryen arrestimet e zyrtarëve të lartë për korrupsion, disa mund ta shohin këtë ndërhyrje "kirurgjikale" në trupën e politikës kosovare si një mundësi që do të krijojë hapësirë për rritjen e lëvizjeve të reja politike.

Ekziston një alternativë tjetër sipas së cilës prezencia ndërkombëtare duhet të reduktojë fuqitë e saj për ta lejuar politikën e kushtëzimit të shpalojë në formën e saj të plotë: në mënyrë që qytetarët e Kosovës ta konsiderojnë qeverinë e tyre qartazi si përgjegjëse për sukseset apo dështimet e saj në rrugën drejt liberalizimit të vizave dhe marrjes së statusit të kandidatit për BE, për marrjen apo refuzimin e fondeve të ndihmës strukturore të BE-së. Por, kjo ka më pak gjasa të ndodhë. Përçarja e BE-së mbi statusin e Kosovës do të thotë që BE-ja mund të mos jetë në gjendje t'ia ofrojë këto shpërblime.

<sup>445</sup> Është "vend me marrëdhënie të çuditshme në mes grupeve të vogla njerëzish." Ibid. Ish republika e Jugosllavisë Slovenia ka numër të popullsisë të ngjashëm me Kosovën, 2 milion dhe tani është anëtare e BE-së. Megjithatë, zhvillimi i saj institucional, ekonomik dhe shoqëror ndryshojnë dukshëm nga Kosova.



Frika se mos i lejojnë udhëheqjes kosovare dorë të lirë në lidhje me kriminalitetin dhe shqetësimi se Kosova mund t'i rikthehet mungesës së stabilitetit dhe dhunës ndëretnike, do të bëjë që sponsorët e Kosovës të mos e lënë atë në fatin e saj. Por, nëse qëndrojnë, ata duhet të ndihmojnë në realizimin e ndryshimit. Forma aktuale e stabilitetit të Kosovës është e një tipi të brishtë, ngulfatës dhe kufizues.

## **Lista e Akronimeve**

<b>AAK</b>	Aleanca për të Ardhmërinë e Kosovës
<b>AKR</b>	Aleanca Kosova e Re
<b>AVUK</b>	Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës
<b>BBC</b>	Shërbimi Transmetues Britanik
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BIRN</b>	Rrjeti Balkanik i Gazetarisë Hulumtuese
<b>DFID</b>	Departamenti i Britanisë së Madhe për Zhvillim Ndërkombëtar
<b>EBU</b>	Unioni Evropian i Transmetuesve
<b>ECLO</b>	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
<b>EULEX</b>	Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit
<b>EUSR</b>	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
<b>FMN</b>	Fondi Monetar Ndërkombëtar
<b>GAP</b>	Instituti për Zhvillime të Avancuara
<b>ICO</b>	Zyra Civile Ndërkombëtare
<b>ICR</b>	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, shefi i ICO-së
<b>INPO</b>	Iniciativa për Progres
<b>IHD</b>	Investimet e Huaja Direkte
<b>KCIC</b>	Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar
<b>KCSF</b>	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KFOR</b>	Forca udhëhequra nga NATO në Kosovë
<b>KIPRED</b>	Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave

<b>KPJ</b>	Klubi për Politikë të Jashtme
<b>KQZ</b>	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
<b>KTV</b>	Kohavision
<b>KZAP</b>	Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
<b>LDD</b>	Lidhja Demokratike e Dardanisë
<b>LDK</b>	Lidhja Demokratike e Kosovës
<b>LPK</b>	Lëvizja Popullore e Kosovës
<b>NATO</b>	Aleanca Veri Atlantike
<b>NRDNJ</b>	Nisma e të Rinjëve për të Drejta të Njeriut
<b>OJQ</b>	Organizata jo-qeveritare
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PDK</b>	Partia Demokratike e Kosovës
<b>PTK</b>	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
<b>RTK</b>	Radio Televizioni i Kosovës
<b>RTP</b>	Radio Televizion i Prishtinës
<b>RTV21</b>	Radio Televizioni 21
<b>SHIK</b>	Shërbimi Informativ i Kosovës
<b>SHPK</b>	Shërbimi Policor i Kosovës
<b>UÇK</b>	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
<b>UN</b>	Kombet e Bashkuara
<b>UNDP</b>	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
<b>UNHCR</b>	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
<b>UNMIK</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë